



Dr. Martin Schneider-Jacoby Association – MSJA

# Studim i peizazhit kulturor i Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanosit

**Expediatio**  
architects



Ovaj projekat finansira  
Evropska unija



Centar za građansko obrazovanje  
Centre for Civic Education



## Impresum

**Porositësi: Shoqata Dr. Martin Schneider-Jacoby Association – MSJA**

**Punuar nga: „Expediatio architects“ sh.p.k.,** Kotorr, Mali i Zi

### **Ekipi që morri pjesë në përgatitjen e Studimit:**

- Aleksandra Kapetanović, arkitekte konservatore, koordinatorë e hartimit të Studimit
- dr Goran Andlar, arkitekt peizazhi
- Gazmend Çitaku, shkrimtar, ekspert lokal për trashëgiminë kulturore jomateriale
- Korab Kraja, arhitekt
- mr Miloš B. Petričević, arkeolog - konservator

**Fotografitë:** Aleksandra Kapetanović, Goran Andlar, Korab Kraja, Gazmend Çitaku

**Vizatimet dhe skicat:** Korab Kraja, Aleksandra Kapetanović

**Koordinatorë:** Zenepa Lika, MSJA

**Bashkëpunëtorët:** Elodi Jakupi i Arslan Hajdinaga, MSJA

**Përkthimi dhe lektorimi i tekstit nga gjuha malazeze ne gjuhën shqipe:** Sabra Deçeвиq

**Dizajni dhe faqosja:** MM Digital doo

**Shtypi:** Golbi Doo, Podgoricë

**Tirazhi:** 90 copë

### **Jemi mirënjohës për ndihmën në hartimin e Studimit:**

- Agjencisë për Mbrojtjes e Mjedisit për dokumentacionin e dhënë,
- Sekretariatit për Planifikim Hapësinor dhe Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunës së Ulqinit për dokumentacionin e dhënë,
- Drejtorisë për Kadastër dhe Pronë Shtetërore për dhënien e shtresave (bazave) kadastrale për përgatitjen e Studimit,
- Drejtorisë për Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore për dhënien e Studimit për Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore që ka shërbyer për hartimin e Planit Hapësinor-Urbanistik të Komunës së Ulqinit,
- Princit Nikola Petrović Njegos për vizatimet nga Ullishta,
- Luka Đakonović për vozitjen përgjatë gjirit të Valdanos dhe të dhënat,
- Të gjithë qytetarët/qytetareve të Ulqinit për mikpritjen dhe informacionin e dhënë për Ullishtën,
- Të gjithë të tjerëve që na ndihmuan në procesin e hartimit të Studimit.

„Studimi i peizazhit kulturor të Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanosit“ është realizuar në kuadër të **projektit Identifikimi dhe analiza: “Ullishta e Ulqinit dhe Gjiri i Valdanos – mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore-peizazhit”** të implementuar nga organizata joqeveritare MSJA – Dr Martin Schneider-Jacoby Association / Shoqata Dr Martin Schneider-Jacoby, në periudhën nga maji deri në nëntor 2023. Projekti mbështetet në kuadër të projektit: OSHC-të në Mal të Zi - nga shërbimet bazë deri tek krijimi i politikave - M'BASE, i cili implementohet nga Qendra për Edukim Qytetar (CGO), në partneritet me Fondacionin Friedrich Ebert (FES), OJQ Qendra për Mbrojtjen dhe Studimin e Zogjve të Malit të Zi (CZIP) dhe rrjetin e OJQ-ve Politikon, në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Punëve Evropiane të Qeverisë të Malit të Zi. Projekti mbështetet financiarisht nga Komisioni Evropian, përmes Delegacionit të BE-së në Mal të Zi. \*Përmbajtja e studimit është përgjegjësi e vetme e Shoqatës Dr. Martin Schneider-Jacoby Assoc. – MSJA, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e CEQ, Bashkimit Evropian apo Ministrisë së Administratës Publike.

CIP - Каталогизација у публикацији  
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-9911-566-02-7

COBISS.CG-ID 28686852



Dr. Martin Schneider-Jacoby Association – MSJA

# Studim i peizazhit kulturor i Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanosit

**Expediatio**  
architects

Ulqin, 2024.

# PËRMBAJTJE

1. <u>Hyrje</u> .....	6
1.1. <u>Pikënisje</u> .....	6
1.2. <u>Shtrirja e zonës</u> .....	7
1.3. <u>Qëllimi i Studimit</u> .....	9
1.4. <u>Metodologjia e hartimit</u> .....	10
1.4.1. <u>Hulumtimi në distancë i peizazhit kulturor</u> .....	11
1.4.2. <u>Karakterizimi i peizazhit/modeli i vlerësimit të karakterit dhe cilësisë së peizazhit</u> .....	14
2. <u>Kuadri ligjor, pasuritë e njohura potenciale kulturore, hulumtime dhe studime të mëparshme</u> .....	16
2.1. <u>Kuadri ligjor</u> .....	16
2.2. <u>Trashëgimia natyrore</u> .....	18
2.3. <u>Pasuritë kulturore me potencial të dëshmuar</u> .....	20
2.4. <u>Hulumtime dhe studime të mëparshme</u> .....	20
3. <u>Kuadri ndërkombëtar – peizazhi kulturor, peizazhi bujqësor, peizazhet me tarraca</u> ...	25
4. <u>Karakteristikat themelore dhe zhvillimi i zonës së Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanosit</u> .....	26
4.1. <u>Karakteristikat natyrore</u> .....	26
5. <u>Zhvillimi historik</u> .....	30
5.1. <u>Rrjedhat historike në zonën e Ulqinit</u> .....	30
5.2. <u>Valdanosi dhe Ullishta në parahistori dhe antikitet</u> .....	31
5.3. <u>Valdanos dhe Ullishta nga mesjeta deri në shekullin e 20-të</u> .....	37
5.3.1. <u>Gjiri i Valdanosit</u> .....	37
5.3.2. <u>Ullishta</u> .....	46
6. <u>Trashëgimia natyrore dhe kulturore</u> .....	52
6.1. <u>Elemente të trashëgimisë arkitekturore dhe peizazhit kulturor</u> .....	52
6.1.1. <u>Peizazh me tarraca</u> .....	52
6.1.2. <u>Tarracat, nënmuret / kufijtë</u> .....	54
6.1.3. <u>Teknika e muraturës - mur i thatë</u> .....	57
6.1.4. <u>Shtigjet dhe rrugët</u> .....	59
6.1.5. <u>Shtigjet kryesore - karakteristikat arkitektonike</u> .....	63
6.1.6. <u>Rrugët dytësore</u> .....	69
6.1.7. <u>Kanalet e kullimit</u> .....	71
6.1.8. <u>Krojet</u> .....	73
6.1.9. <u>Pushimorja ushtarake "Valdanos" në vitet shtatëdhjetë të shekullit XX</u> ...	86
6.1.10. <u>Karantini (lazareti) i rrrënuar, ndërtesa e doganës dhe portit</u> .....	88
6.1.11. <u>Porti / mandraqi</u> .....	90
6.1.12. <u>Mbetjet e kishës në gjirin e Valdanosit</u> .....	91
6.1.13. <u>Fëneri në kapin Mendra</u> .....	91
6.2. <u>Trashëgimia kulturore jomateriale</u> .....	93
6.2.1. <u>Ullishtaria në traditën ulqinake</u> .....	93
6.2.2. <u>Praktikat e mbjelljes dhe mirëmbajtjes së ullirit</u> .....	94
6.2.3. <u>Pronësia e Ullishtës</u> .....	95
6.2.4. <u>Punët në Ullishtë</u> .....	96
6.2.5. <u>Praktika e ruajtjes së Ullishtës</u> .....	100
6.2.6. <u>Ullishta pa objekte</u> .....	101
6.2.7. <u>Mullinj jashtë Ullishtës</u> .....	101
6.2.8. <u>Produktet nga ullirit</u> .....	102
6.2.9. <u>Disa legjenda që lidhen me Ullishtën</u> .....	104
7. <u>Karakterizimi i peizazhit</u> .....	106
7.1. <u>Katalogu i zonave të peizazhit</u> .....	108
7.2. <u>Hartat e cilësisë dhe presionit të zonave të peizazhit</u> .....	160
8. <u>Vlerat</u> .....	165
9. <u>Vlerësimi i situatës, kërcënimeve dhe rreziqeve</u> .....	167
9.1. <u>Gjendja e peizazhit kulturor</u> .....	167
9.2. <u>Dokumentacioni ekzistues i planifikimit hapësinor</u> .....	173
9.3. <u>Kërcënimet dhe rreziqet</u> .....	179
10. <u>Propozim për mbrojtje</u> .....	181
11. <u>Udhëzimet, regjimi dhe masat mbrojtëse</u> .....	182
11.1. <u>Udhëzime të përgjithshme për ullishtën e Ulqinit dhe gjirin e Valdanosit në tërësi</u> .....	182
11.2. <u>Udhëzime, regjime dhe masa mbrojtëse për elementët e peizazhit kulturor</u> .....	183
12. <u>Burimet dhe literatura</u> .....	187
13. <u>Shtojcat grafike</u> .....	189



# 1. Hyrje

## 1.1. Pikënisje

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Neni. 37, Komuna e Ulqinit - Sekretariati për Veprimtari Komunale dhe Mbrojtjen e Mjedisit ka dorëzuar **Iniciativën** për mbrojtjen parandaluese të zonës «Ullishta e Ulqinit me Gjirin e Valdanos» (Akti Nr.: 01/a - D - 3010/1 datë 15.11.2021 ).

Në bazë të iniciativës së dorëzuar, në mars të vitit 2022, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit ka përgatitur **Analizën profesionale** për nevojën e mbrojtjes parandaluese të lokacionit “Ullishta e Ulqinit me gjirin e Valdanosit” në komunën e Ulqinit.

Në bazë të analizës profesionale, është përgatitur **Propozim Vendimi për vendosjen në mbrojtje parandaluese të “Ullishtës së Ulqinit me Gjirin e Valdanosit” në komunën e Ulqinit.**

Për shkak të vlerave të jashtëzakonshme kulturore-historike, peizazhore, estetike dhe ekologjike dhe diversitetit të konsiderueshëm biologjik, zona e Ullishtës së Ulqinit me Gjirin e Valdanosit është propozuar për mbrojtje parandaluese në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, si **zonë me karakteristika të jashtëzakonshme.**

*Zona me karakteristika të jashtëzakonshme “Ullishta e Ulqinit me gjirin e Valdanosit” në komunën e Ulqinit, të cilat janë vendosur në mbrojtje parandaluese, klasifikohen në kategorinë V të zonave të mbrojtura, ku përfshihen zonat ku ndërveprimi afatgjatë i njeriut dhe natyrës. ka prodhuar vlera ekologjike, biologjike, kulturore dhe estetike të dëshmuara dhe domethënëse dhe ku ruajtja e integritetit të asaj marrëdhënieje është e nevojshme për të mbrojtur dhe ruajtur atë zonë, për të ruajtur natyrën dhe vlerat e tjera. (Neni 2 i Propozim Vendimit)*

Projekti **Identifikimi dhe analiza: “Ullishta e Ulqinit dhe Gjiri i Valdanosit – mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore-peizazhit”** realizohet nga organizata joqeveritare **MSJA – Dr. Martin Schneider-Jacoby Association / Dr Martin Schneider-Jacoby**, në periudhën nga maji deri në nëntor 2023. Projekti mbështetet në kuadër të projektit: OSHC-të në Mal të Zi - nga shërbimet bazë deri tek krijimi i politikave - M'BASE, implementuar nga Qendra për Edukim Qytetar (CGO), në partneritet me Fondacionin Friedrich Ebert (FES), OJQ Qendra për Mbrojtjen dhe Studimin e Zogjve të Malit të Zi (CZIP) dhe rrjeti i OJQ-ve Politikon, në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike, Shoqërisë Dixhitale dhe Medie dhe Zyrën për Integritet Evropian të Qeverisë së Malit të Zi. Projekti mbështetet financiarisht nga Komisioni Evropian, përmes Delegacionit të BE-së në Mal të Zi.

Ky projekt synon të forcojë partneritetet ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe vetëqeverisjeve lokale në implementimin dhe promovimin e standardeve të BE-së në lidhje me mbrojtjen e ullishtës (Kapitulli 11), mbrojtjen e përkohshme dhe të përhershme të mjedisit (Kapitulli 27), mbrojtjen e pasurive kulturore dhe ruajtja e zonave autentike (Konventa Evropiane për peizazhet). Një nga rezultatet e projektit është rritja e ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë e ruajtjes së ullishtave si pasuri ekologjike, kulturore, bujqësore dhe pjesë e ofertës së rëndësishme rekreative dhe turistike.

Në kuadër të projektit, një nga aktivitetet e planifikuara është **Analiza dhe mapimin i peizazhit kulturor të Ullishtës dhe gjirit të Valdanos**, me qëllim të shpalljes zonë e mbrojtur natyrore dhe pasuri e rëndësishme kulturore - peizazh kulturor.

Neni 4 i Propozim Vendimit nxjerr në pah vlerat kulturore dhe historike të Ullishtës dhe Gjirit të Valdanos:

*Zona “Ullishta e Ulqinit me gjirin e Valdanosit” njihet prej shekujsh me kultivimin tradicional të ullirit. Ajo përfaqëson një trashëgimi jashtëzakonisht domethënëse dhe të vlefshme kulturo-historike dhe natyrore të qytetit të Ulqinit dhe Malit të Zi, që dëshmon për ndërveprimin e koordinuar dhe të ekuilibruar mes njerëzve dhe natyrës që ka mbijetuar ndër shekuj.*

*“Ullishta e Ulqinit me Gjirin e Valdanos” përfaqëson një kompleks unik më të madh nën ullinj në Mal të Zi me ndërtim tradicional shekullor me ullishtë që ka vlera të mëdha kulturore, historike dhe peizazhore.*

Duke pasur parasysh këtë, është e nevojshme të kryhen hulumtime dhe të hartohet **Studim i peizazhit kulturor të Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanos**, me fokus në **vlerat kulturore** të kësaj zone, duke u mbështetur në **Ligjin për Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore**. Hulumtimi duhet të përfshijë identifikimin, mapimin dhe analizën e elementeve të peizazhit kulturor, si **segment i trashëgimisë kulturore**, me qëllim të mbrojtjes dhe shpalljes së kësaj zone si zonë me karakteristika të jashtëzakonshme sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe Peizazhi Kulturor në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore.

## 1.2. Shtrirja e zonës


Fushëveprimi i Studimit të peizazhit kulturor të Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanosit, **bashkon zonën e mbrojtjes parandaluese: Zona me karakteristika të jashtëzakonshme “Ullishta e Ulqinit me gjirin e Valdanos” me brez mbrojtës, plazhin e Valdanosit**, i cili është mbrojtur në vitin 1968 si monument natyre, si dhe **pjesa nënujore e gjirit të Valdanosit**, e cila është **lokalitet potencial i trashëgimisë kulturore nënujore.**

Zona që përfshin **lokalitetin e propozuar për mbrojtje parandaluese Zona me karakteristika të jashtëzakonshme “Ullishta e Ulqinit me Gjirin e Valdanos” me brez mbrojtës**, e përcaktuar në Propozim Vendimin për vendosjen e «Ullishtës së Ulqinit me Gjirin e Valdanosit” në mbrojtje parandaluese në komunën e Ulqinit, e cila është përcaktuar në bazë të analizës profesionale për nevojën e mbrojtjes parandaluese dhe propozimit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit.

*Zona me karakteristika të jashtëzakonshme “Ullishta e Ulqinit me Gjirin e Valdanos” gjendet në KD (Komuna Kadastrale) Ulqin dhe shtrihet nga qyteti i Ulqinit deri në plazhin e Valdanosit, duke mbuluar pjesën më të madhe të gjirit të Valdanosit. Koordinata qendrore e zonës së mbrojtjes parandaluese është si më poshtë: X=6598551.75, Y=4644856.42. Sipërfaqja e zonës së mbrojtjes parandaluese është: 2377668,51m<sup>2</sup> (237,76ha). E gjithë sipërfaqja e zonës së mbrojtjes parandaluese përfshihet në zonën II të mbrojtjes - regjimi i mbrojtjes aktive. Sipërfaqja e zonës II të mbrojtjes është: 2377668,51m<sup>2</sup> (237,76ha).*

*Jashtë kufijve të zonës së mbrojtjes është përcaktuar brezi mbrojtës. Brezi mbrojtës përfshin kodrën e Mendrës dhe pjesë të kodrave të Mavrianit dhe Malit të Bardhë. Sipërfaqja e përgjithshme e brezit mbrojtës është 4353623,73 m<sup>2</sup> (435,36 ha)*






Paraqitja grafike e zonës së mbrojtjes parandaluese "Ullishta e Ulqinit me Gjirin e Valdanos" me kufirin e zonës së mbrojtjes dhe kufirin e të mirave detare (burimi: Propozim Vendimi për vendosjen nën mbrojtje parandaluese të lokacionit "Ullishta e Ulqinit me Gjirin e Valdanos" në Komunë të Ulqinit)

**Plazhi i Valdanosit** u mbrojt si monument natyre në vitin 1968. Plazhi i Valdanosit nuk ishte përfshirë në kufijtë e zonës së mbrojtjes parandaluese "Ullishta e Ulqinit me Gjirin e Valdanos", sepse për te nuk është zyrtarisht përcaktuar dhe dhënë kufiri. Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit aktualisht është duke udhëhequr procesin e hartimit të studimit revidues në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës. Mirëpo, në kuadër të studimit të peizazhit kulturor të Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanosit, kjo zonë u trajtue në mënyrë integrale si tërësi, që të përfshihej edhe plazhi tashmë i mbrojtur i Valdanosit. Dhe në Listën e Anketimit për trashëgiminë e mbrojtur natyrore të vitit 1977, thuhej se plazhi i Valdanosit "me ullishtat dhe agrumet përreth përbën një **tërësi unike**".

Nëpërmjet përgatitjes së Studimit të Peizazhit Kulturor është trajtuar edhe zona nënujore e Gjirit të Valdanosit si vend **potencial i trashëgimisë kulturore nënujore**.

Gjithashtu, **mjedisi rrethues, d.m.th. mjedisi rrethues potencialisht i mbrojtur – bafer zona**, përfshinte **zonën** më të gjerë se brezi mbrojtës i propozuar i zonës me karakteristika të jashtëzakonshme, për të mundësuar vlerësimin integral të peizazhit kulturor, duke përfshirë **shpatet jugore të Malit të Bardhë dhe Mavrianit në tërësi, deri në kepin Rep si dhe pjesë e zonës së Meterizit**.



Paraqitja grafike përfshin zonat në hartën topografike

### 1.3. Qëllimi i Studimit

Qëllimi kryesor i Studimit të Peizazhit Kulturor të Ullishtës së Ulqinit dhe Gjirit të Valdanos është që **nëpërmjet identifikimit, mapimit dhe analizës së vlerave dhe elementeve të peizazhit kulturor, si dhe përcaktimit të masave për ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerës natyrore dhe kulturore të Ullishtës së Ulqinit dhe Gjirit të Valdanos, me qëllim që të shpallet pasuri e mbrojtur natyrore - zona me karakteristika të jashtëzakonshme sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe Pasurive të Mbrojtura Kulturore - peizazhit kulturor sipas Ligji për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore**.

Nëpërmjet identifikimit të vlerës së peizazhit kulturor dhe përcaktimit të masave mbrojtëse, Studimi duhet të kontribuojë në proceset që do të mundësojnë vendosjen e ekuilibrit midis mbrojtjes dhe valorizimit të nevojshëm të vlerave natyrore dhe kulturore, respektivisht në ruajtjen e pasurive natyrore dhe kulturore në funksion të zhvillimit të ardhshëm të qëndrueshëm të gjithë zonës.

Hulumtimi dhe Studimi duhet të shërbejnë si bazë dhe shtesë për dy studime:

- *Studimi i mbrojtjes së pasurive natyrore (peizazhe me karakteristika të jashtëzakonshme), i cili është përgatitur nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës,*
- *si dhe Studimin e mundshëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (peizazhit kulturor), i cili sipas Ligjit për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore është hartuar dhe miratuar nga Drejtoria për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore.*

Rezultatet e hulumtimit, pasi të përgatiten, do të publikohen në formë të studimit dhe do të vihen në dispozicion të publikut. Studimi do t'i dorëzohet Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, Drejtorisë për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore, Komunës së Ulqinit dhe institucioneve tjera relevante.

## 1.4. Metodologjia e hartimit

Në Termat e Referencës, përcaktohet se Studimi duhet të **identifikojë, mapojë dhe analizojë elementet e peizazhit kulturor të ullishtës**, duke përfshirë: **organizimin hapësinor, nënmuret dhe muret e thatë, rrugët dhe kalldrëmet, krojet dhe elementë të tjerë të trashëgimia arkitekturore**, si dhe **elementë të trashëgimisë jomateriale**, .. Gjithashtu u saktësua se për përcaktim të plotë të vlerës së zonës, është e nevojshme për të parë zonat që janë pasuri natyrore të mbrojtura si dhe ato që posedojnë vlera të rëndësishme natyrore.

Metodologjia e hartimit të Studimit bazohet në parimet dhe doktrinat bashkëkohore të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe vlerave të saj. Ullishta e Ulqinit dhe gjiri i Valdanosit u hulumtuan dhe u panë si një hapësirë unike, si një segment i **trashëgimisë kulturore** që «*përfshin të gjitha llojet e mjedisit të krijuar nga ndërveprimi i njeriut dhe hapësirës gjatë kohës*», si një **peizazh kulturor** që përfaqet «*një vepër të kombinuar të natyrës dhe e njeriut*».

Në procesin e hulumtimit dhe analizës, që përfshinte studimin e dokumentacionit historik, vizitat në terren, **u përcaktuan karakteristikat dhe vlerat e peizazhit të përgjithshëm kulturor, me të gjitha shtresat dhe elementët e tij.**

Në pjesën e analizës së shtresave arkeologjike fokus i veçantë ishte në **hulumtimin në distancë i peizazhit kulturor**, ndërsa në pjesën e karakterizimit të peizazhit është aplikuar modeli i **vlerësimit të karakterit dhe cilësisë së peizazhit**.

Është analizuar **situata** dhe janë përcaktuan **vlerat**, si dhe **kërcënimet dhe rreziqet**. Në bazë të tyre u përcaktuan **udhëzimet dhe masat mbrojtëse**.

Për qëllime të hartimit të Studimit, u desh që të sigurohen **bazat (shtresat)** për zonën e Ullishtës së Ulqinit dhe gjirin e Valdanosit. Në fazën përgatitore të Studimit, u morën bazat e mëposhtme:

- **Drejtoria për Kadastër dhe Pronë Shtetërore ka:**
  - Hapur llogari në Gjeportalin e Drejtorisë për Kadastër dhe Pronë Shtetërore përmes së cilës kishim akses në të dhënat e mëposhtme
    - Hartat topografike 1 : 25 000
    - Ortofoto digjitale
    - Modelin digjital të terrenit
    - Komunat kadastrale
  - Ka dhënë në shfrytëzim të dhënat LiDAR për zonën e Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanosit.
- Nga **Instituti Ushtrako-gjeografik nga Firenca** (Istituto Geografico Militare) janë marrë fotot ajrore të zonës së Ullishtës dhe gjirit të Valdanos nga **tetori i vitit 1942**.
- Nga **Sekretariati për Planifikim Hapësinor dhe Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunës së Ulqinit** janë marrë bazat kadastrale AutoCAD të zonës.

Gjatë procesit të hartimit të Studimit janë realizuar **aktivitetet** e mëposhtme

- **Mbledhja dhe analiza e bibliografisë dhe burimeve historike**, duke përfshirë literaturën profesionale, studimet, hartografinë historike dhe fotografitë, etj.
- **Vizita në terren dhe hulumtimi** i zonës, ku përfshihej vizita në të gjitha zonat e Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanosit, identifikimi dhe analiza e elementeve të trashëgimisë kulturore, d.m.th. peizazhi kulturor.
- Krijimi i **fytyrës fotografike** të gjerë të të gjithë zonës.
- **Mapimi** i të gjithë elementëve të identifikuar të peizazhit kulturor në GIS.
- Krijimi i **skicave arkitektonike** të **segmenteve karakteristike të shtigjeve të këmbësorëve**, si dhe llojeve karakteristike të tarracave.
- **Regjistrimi i detajuar arkitektonik dhe skicimi për 5 kroje**. Për krojet tjera u bënë **skica** arkitekturore.

- Identifikimi dhe analiza e segmenteve të **trashëgimisë kulturore jomateriale**
- **Konsultimet me përfaqësues të komunitetit lokal** në kuadër të procesit të identifikimit të elementeve të trashëgimisë kulturore të paluajtshme dhe jomateriale.
- Është kryer **gjeoreferencimi i ullinjve** nga zona e Ullishtës dhe gjirit të Valdanos, moshë e të cilëve është identifikuar në vitin 2015 nga Laboratori për Anatominë e Drurit dhe Hulumtimin e Unazave të Pemëve, i cili është pjesë e Fakultetit të Pyllëtarisë në Universitetin e Stambollit.

Në pjesën e **analizës së shtresave arkeologjike**, fokus i veçantë ishte **hulumtimin në distancë i peizazhit kulturor**:

- Përpunimi dhe analiza e të dhënave nga LiDAR
- Interpretimi ajror i materialit të viteve 40 të shekullit të 20-të

Në pjesën e **karakterizimit të peizazhit**, u aplikua **modeli i vlerësimit të karakterit dhe cilësisë së peizazhit**, u përcaktuan llojet e peizazhit dhe u bë katalogu dhe vlerësim i cilësisë së zonave të peizazhit.

Pas hulumtimeve të kryera është realizuar si vijon:

- Analiza e **karakteristikave bazë dhe zhvillimi i zonës**
- Përcaktimi i **vlerës** së peizazhit kulturor
- Analiza e **situatës, kërcënimeve dhe rreziqeve**
- Përcaktimi i **udhëzimeve dhe masave për mbrojtjen e vlerave**

**Përmbajtja** e Studimit të Peizazhit Kulturor të Ullishtës së Ulqinit dhe Gjirit të Valdanos është bërë në bazë të **Termave të Referencës së Projektit** të dhëna nga organizata joqeveritare MSJA - Shoqata Dr. Martin Schneider-Jacoby, si dhe në bazë të **Ligjit për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore**. Ligji për Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore (neni 90) përcakton se Studimi për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore është "*dokument që siguron mbrojtjen, ruajtjen dhe integritetin e trashëgimisë kulturore në kuadër të planifikimit të zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor*."; dhe Studimi për mbrojtjen duhet të përmbajë: 1) *karakteristikat themelore dhe zhvillimin e zonës*; 2) *identifikimin dhe përshkrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore: pasurive kulturore, pasurive potenciale kulturore dhe të gjitha zonat që kanë vlera peizazhore kulturore*; 3) *vlerësimin e situatës*; 4) *analizën e rrezikut*; 5) *udhëzime dhe masa mbrojtëse*; 6) *bashkëngjitjet grafike mbi të cilat janë paraqitur domosdoshmërisht vlerat e trashëgimisë kulturore dhe masat mbrojtëse*.

### 1.4.1. Hulumtim në distancë i peizazhit kulturor

**Hulumtimi në distancë** është metodë e mbledhjes së të dhënave hapësinore përmes sistemeve që nuk janë në lidhje të drejtpërdrejtë fizike me hapësirën, objektin ose fenomenin që ekzaminohet. Kjo qasje përfshin teknika të ndryshme, ndër të tjera, fotografimin nga ajri, imazhet satelitore dhe radare, si dhe teknikën moderne të **skanimit me lazer LiDAR (Light Detection and Ranging)**.

Kjo teknikë paraqet matje e vazhdueshme e vlerës tredimensionale të pikave (sipërfaqeve), që është një lloj skanimi hapësinor i terrenit. Skanimi me lazer mund të ndahet në: skanim statik me lazer dhe skanim dinamik me lazer. Në kuadër të skanimit dinamik me lazer, rëndësi të veçantë për hulumtimin e zonës ka skanimi me lazer në ajër (eng. Airborne Laser Scanning – ALS). Termi ALS përdoret ekskluzivisht për platformat fluturuese si: aeroplanë, helikopterë dhe së fundmi mjete ajrore pa pilot.

Rezolucioni hapësinor i të dhënave të mbledhura varet nga numri i pikave të matura. Bazuar në




rezultatet e matjes së terrenit me laser, mund të krijohet model dixhital i sipërfaqes (MDS) ose model dixhital i terrenit (MDT) në rezolucion të caktuar. ALS po revolucionarizon fushën e hulumtimit në distancë dhe arkeologjisë. Aftësia e kësaj teknologjie për të depërtuar në mbulesën vegetative dhe për të regjistruar mbetjet në tokë do të ndryshojë plotësisht kuptimin tonë për aktivitetet njerëzore në hapësirë dhe kohë.


Zonat me formë të dukshme janë padyshim më të lehta për interpretim hapësinor, ndryshe nga zonat që janë nën bimësi të dendur. Pikërisht zonat pa shenja të dukshme të ndikimit antropogjen mund të fshehin mbetjet e aktiviteteve njerëzore që nuk mund të regjistrohen pa aplikimin e kësaj teknologjie.

Me ndihmën e algoritmeve kompjuterike është e mundur të kryhet klasifikim i saktë i impulseve laserike të transmetuara. Në këtë mënyrë, brenda resë së klasifikuar të pikave mund të dallojmë klasa të dhënash (p.sh. toka, ndërtesat, vegjetacioni, sipërfaqet ujore etj.) që së bashku përfaqësojnë të gjithë hapësirën. **Duke filtruar renë e klasifikuar të pikave, është e mundur të evidentohen variacionet e lartësisë në tokë, pra të hiqet bimësia, objektet, infrastruktura etj.** Procesi i filtrimit morfologjik ka rëndësi të madhe në detektim sepse mundëson analizën e mikrotopografisë së terrenit. Në këtë mënyrë **bëhet i mundur interpretimi i mbetjeve strukturore në tokë të mbuluara nga bimësia.**

Specifikimi i zonës mesdhetare, ku guri është materiali bazë ndërtimor, mundëson aplikimin e teknologjisë ALS në zbulimin e aktiviteteve antropogjene, identifikimi vizual i të cilave nuk është i mundur nga interpretimi i fotografive ajrore apo imazheve satelitore. **Të dhënat e ALS-së të Drejtorisë për Kadastër dhe Pronë Shtetërore të Malit të Zi vijnë nga viti 2011**, kur u krye inçizimi me laser i gjithë territorit shtetëror. Rezolucioni hapësinor i regjistrimit është min. 1 pikë për metër katror, që mundëson gjenerimin e DMP (hartë digjitale e hapësirës) dhe DMT (hartë digjitale e terrenit) me rezolucion të lartë. Përpunimi shtesë, duke **përdorur mjete të specializuara IT për vizualizimin e të dhënave ALS, vuri në pah variacionet e lartësisë së terrenit, gjë që rriti dukshmërinë e mbetjeve strukturore në tokë.** Domethënë, me aplikimin e kësaj teknologjie **përcaktohet saktësisht shtrirja hapësinore e tarracave në të cilat ndodhen ullishtat.**



Detajet e vizualizimit të të dhënave LiDAR të zonës së Ullishtës, Burimi: Drejtoria për Kadastrën dhe Pronën Shtetërore, 2011



Vizualizimi i të dhënave LiDAR të zonës së Ullishtës, Burimi: Administrata për Kadastër dhe Pronë Shtetërore, 2011.

**Kërkimi ajror** është forma më e vjetër e hulumtimit në distancë në përgjithësi. Shumë parime dhe postulate të hulumtimit ajror dhe interpretimit ajror do të shërbejnë si një bazë solide mbi të cilën do të zhvillohen më vonë teknika të tjera të hulumtimit në distancë. **Fotografia ajrore**, siç sugjeron edhe emri, përfshin përdorimin e platformave fluturuese për regjistrim, d.m.th., fotografimin e tokës.

Arkivat e shumta të fotografimit ajror, të cilat sot ruajnë dhjetëra miliona fotografi ajrore, dëshmojnë për përparimin e dikurshëm teknologjik dhe ndikimin e pamohueshëm të tij në zhvillimin e mëtejshëm të interpretimit ajror në kuadrin e disiplinave të ndryshme shkencore. Në botë ka koleksione të shumta dhe shumë të rëndësishme të fotografive ajrore. **Për zonën tonë, rëndësi të veçantë ka arkivi i zbuluar së fundmi i Institutit Ushtarako-Gjeografik në Firence të Republikës së Italisë.**

Forcat Ajrore Italiane (Regia Aeronautica) kanë kryer fotografime të vazhdueshme ajrore të bregdetit malazez, si dhe të zonave fqinje, siç dëshmohet, ndër të tjera, nga arkivi i pasur i fotografive ajrore të Shqipërisë fqinje për periudhën 1927-1942. Administrata italiane në Mal të Zi, i ashtuqujturi *Komisioni Rajonal për Malin e Zi*, në vitin 1942 filloi punimin e hartës topografike të zonës së okupuar në shkallën 1:25 000. Harta topografike u punua në bazë të të ashtuquajturës matjet ushtarake austro-hungareze dhe harta topografike e Mbretërisë së Jugosllavisë në shkallën 1:100 000. Përmbajtja hartografike e matjeve topografik italiane, sipas informacioneve të disponueshme, u plotësua me përdorimin e **fotografive ajrore të bëra gjatë vitit 1942.**

Nëpërmjet kërkimeve arkivore u konstatua se Instituti Ushtarako-Gjeografik në Firence disponon **fotografi ajrore për zonën e Ulqinit dhe Valdanosit.** Për qëllime të këtij hulumtimi janë digjitalizuar gjithsej **3 fotograma** me qëllim të kontrollit të cilësisë së fotografive ajrore. Karakteristikat e fotografive ajrore tregojnë një cilësi të kënaqshme dhe ato janë bërë me një aparat fotografik ajror Zeiss RMK 20/3030 në tetor 1942, emërtime të shumta: 173, 175 dhe 177. Në këto fotografi ajrore, **janë të dukshme objekte, komunikime rrugore, një sërë lokalitetesh potenciale arkeologjike dhe, më e rëndësishmja, ishte e mundur të shihej shkalla e tarracimit të zonës së Ullishtës, e që ishte e pamundur të përcaktohet me interpretimin e fotografive ajrore të fundit.**



Duke marrë parasysh avantazhet teknologjike të përmendura, mund të konkludojmë se hulumtimi në distancë, veçanërisht përdorimi i teknologjisë si ALS, po bëhet një mjet i domosdoshëm në hulumtimin e peizazhit. Njohja e përbërësve më të vjetër të zonës dhe rindërtimi i saj përmirëson ndjeshëm aftësinë tonë për interpretim dhe analizë më objektive, duke hapur horizonte të reja në hulumtimin e së shkuarës së zonës.



Pamje ajrore e gjirit të Valdanos dhe zonës së Ullishtës, burimi: L'Istituto geografico militare (IGM) Firenze – Italia Regia Aeronautica Ottobre 1942

#### 1.4.2. Karakterizimi i peizazhit/karakteri i peizazhit dhe modeli i vlerësimit të cilësisë

Në pjesën e punimit të karakterizimit të peizazhit, është aplikuar modeli për vlerësimin e karakterit dhe cilësisë së peizazhit si një kornizë integrale që unifikon të gjitha njohuritë e mbledhura dhe analizuar më parë për faktorët natyrorë dhe antropogjenë të peizazhit. Duke qenë se karakterizimet e peizazhit mund të kryhen në nivele të ndryshme, nga ai shtetëror në atë lokal, këtu u aplikua niveli më i ulët lokal, në të cilin zonat e peizazhit dallohen në bazë të kriterëve të mëposhtme: (1) format mikroreliev (gjire, plazhe, shkëmbinj, anët bregdetarë, pjesët e luginës, shpatet e kodrave etj.), (2) veçoritë gjeologjike (gëlqerore, flishore), (3) mënyra e përdorimit dhe mbulimit (ullishta aktive dhe të braktisura, mbulesa natyrore, lëndina, ndërtimi). Çdo zonë

e ndarë është emëruar përmes koncepteve të zonës së peizazhit dhe llojit të peizazhit. Zona e peizazhit është një zonë e përcaktuar gjeografikisht, kështu që emri i saj bazohet në një toponim, ndërsa lloji i peizazhit është i llojit të përgjithshëm dhe mund të shfaqet në disa vende, dhe emri i tij, ndryshe nga një zonë peizazhi, mbart informacion për karakterin e tij. Karakteri i secilës zonë peizazhi përshkruhet duke interpretuar sesi kombinimi i veçorive natyrore, kulturore dhe vizuale të eksperiencës formon një hapësirë me një identitet dhe veçori unike. Për më tepër, për secilën fushë janë vlerësuar: cilësitë natyrore, cilësitë kulturore, cilësitë vizuale dhe presionet. Gjithashtu, fotot dhe hartat janë bashkangjitur për çdo zonë. Së fundi, janë bashkangjitur gjashtë harta: (1) harta e zonave të peizazhit, (2) harta e cilësive natyrore, (3) harta e cilësive kulturore, (4) harta e cilësive vizuale, (5) harta kompozite e cilësive (6) harta e presioneve.

Parimi i vlerësimit të karakterit dhe cilësisë është njohja e fushave me karakter unik, tipare të përbashkëta, gjendje dhe cilësisë. Duke qenë se vlerësime të tilla zbatohen në të gjithë hapësirën dhe se hapësira vëzhgohet përmes kombinimit të faktorëve të ndryshëm, ato mundësojnë zhvendosjen e këndvështrimit nga një element/tipar/faktor individual në hapësirën në tërësi – pra bëhen më të plota njohjet e përgjithshme të karakteristikave, cilësive dhe kushteve. Në këtë kuptim, kjo bazë duhet të përdoret për të drejtuar ruajtjen e karakterit dhe cilësisë dhe uljen dhe heqjen e presioneve të çdo zone të regjistruar. Gjithashtu, një kornizë e tillë mund të jetë një bazë domethënëse për planifikimin e hapësirës dhe mundëson monitorimin e asaj që është arritur, p.sh. në periudha të caktuara.

## 2. Kuadri ligjor, pasuritë e dëshmuara potenciale kulturore, hulumtimet dhe studimet të mëparshme

### 2.1. Kuadri ligjor

Ligji bazë që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të mirave kulturore në Mal të Zi është **Ligji për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore**. Megjithatë, duke pasur parasysh specifikën e peizazhit kulturor zonaës bujqësore së Ullishtës së Ulqinit, të rëndësishme janë dhe **Ligji për Mbrojtjen e Natyrës** si dhe **Ligji për Ullitarinë dhe Vajin e Ullirit**.

#### Ligji për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore

Korniza bazë ligjore për përgatitjen e Studimit të peizazhit kulturor të Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanos është Ligji për **Mbrojtjen e Pasurive Kulturore** ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi", nr. 049/10, datë 13.08.2010. , 040/11 e 08/08/2011, 044/17 e 06/07 .2017, 018/19 nga 22.03.2019).

Sipas këtij ligji mbrohet "pasuria kulturore, si pjesë e valorizuar e trashëgimisë kulturore me interes të përgjithshëm", kurse pasuria kulturore përkufizohet si "çdo pasuri e paluajtshme, e luajtshme dhe jomateriale që është përcaktuar se është e përhershme historike, artistike, shkencore, arkeologjike, me rëndësi arkitekturore, antropologjike, teknike ose ndonjë rëndësi tjetër shoqërore".

Sipas ligjit, një nga llojet e **pasurisë kulturore të paluajtshme** është edhe lokaliteti apo zona si "vepër e përbashkët e njeriut dhe e natyrës, e cila është pjesërisht e ndërtuar, e dallueshme dhe homogjene mjaftueshëm për t'u përcaktuar topografikisht", ndër të cilat është edhe **peizazhi kulturor**.

Gjithashtu, i njëjti Ligj njeh **pasuri kulturore jomateriale**, që është "art, shprehje, aftësi apo performancë njerëzore, si dhe një objekt, artizanat, instrument apo hapësirë që lidhet me të, të cilat komunitetet, grupet dhe në disa raste individët e njohin si pjesë e trashëgimisë së vetë kulturore".

**Vlera kulturore** e pasurisë kulturore "përcaktohet në bazë të gjetjeve të hulumtimit dhe dëshmimeve të tjera relevante mbi tiparet, rëndësinë dhe veçoritë e pasurisë dhe valorizimin e tyre".

**Kriteret për përcaktimin e vlerës kulturore** të pasurisë janë :

- 1) autenticiteti dhe integriteti;
- 2) shkalla e ruajtjes;
- 3) unikësia dhe e rrallëshmëria në llojin e vet;
- 4) Rëndësi historike, artistike, shkencore, arkeologjike, arkitekturore, antropologjike, teknike ose të tjera shoqërore.

Neni 90 i Ligjit për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore përcakton se **Studimi për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore** është "dokument që siguron mbrojtjen, ruajtjen dhe integrimin e trashëgimisë kulturore në kuadër të planifikimit të zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor", dhe se Studimi i Mbrojtjes duhet të përmbajë:

- 1) karakteristikat bazë dhe zhvillimin e zonës;
- 2) identifikimi dhe përshkrimi i vlerave të trashëgimisë kulturore: pasurive kulturore, asetëve potenciale kulturore dhe të gjitha zonave që kanë vlera peizazhore kulturore;
- 3) vlerësimin e gjendjes;
- 4) analiza e riskut;
- 5) udhëzimet dhe masat mbrojtëse;
- 6) bashkëngjitjet grafike në të cilat duhet të paraqiten vlerat e trashëgimisë kulturore dhe masat mbrojtëse

Përmbajtja e Studimit të Peizazhit Kulturor të Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanosit bazohet në nenin 90 të Ligjit për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore. Qëllimi është që ai të shërbejë si bazë për një *studim të mundshëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore*, i cili, sipas ligjit, hartohet dhe miratohet nga Drejtoria e Mbrojtjes së Pasurive Kulturore.

#### Ligji për Mbrojtjen e Natyrës

Për shkak të vlerave të jashtëzakonshme kulturore-historike, peizazhore, estetike dhe ekologjike dhe diversitetit të konsiderueshëm biologjik, zona e Ullishtës së Ulqinit me gjirin e Valdanos është propozuar për mbrojtje parandaluese në përputhje me **Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës ("Fletorja Zyrtare e Mali i Zi" nr. 54/16)**.

Në nenin 37 të këtij ligji thuhet se:

- për një zonë për të cilën organi administrativ, në bazë të analizave të ekspertëve, **vlerëson se ka statusin e zonës së mbrojtur** ose është nisur procedura për vendosjen e asaj zone në mbrojtje, miratohet akti për mbrojtjen parandaluese të zonës;
- akti për mbrojtjen parandaluese të zonës përcakton menaxhuesin e zonës për të cilën është miratuar akti për mbrojtjen parandaluese të zonës, masat, kushtet e mbrojtjes dhe afati i mbrojtjes parandaluese;
- afati nga paragrafi 3 i këtij neni nuk mund të jetë më i gjatë se tre vjet nga data e miratimit të aktit për mbrojtjen parandaluese të zonës.
- zona për të cilën është **miratuar akti për mbrojtjen parandaluese të zonës ose është nisur procedura për vendosjen e saj në mbrojtje konsiderohet e mbrojtur në kuptim të këtij ligji**.

Zona e Ullishtës së Ulqinit me gjirin e Valdanosit është propozuar për mbrojtje parandaluese si **zonë me karakteristika të jashtëzakonshme**. Në nenin 26 të ligjit, thuhet se zonë me karakteristika të jashtëzakonshme është "lokaliteti tokësor ose detar, respektivisht tokësor dhe detar, ku ndikimi i ndërsjellë i njerëzve dhe natyrës me kalimin e kohës ka formuar tipare të dallueshme të lokalitetit. me vlera të rëndësishme estetike, ekologjike dhe kulturore, të shoqëruara me diversitet të lartë biologjik". Në zonën e karakteristikave të jashtëzakonshme, **ndalohej kryerja e veprimeve, aktivitetëve dhe veprimtarive që cenojnë veçoritë për të cilat zona është shpallur e mbrojtur**.

Në bazë të nenit 30 të këtij ligji, zona e Ullishtës së Ulqinit me gjirin e Valdanosit klasifikohet si **zonë e mbrojtur e kategorisë V**. Sipas ligjit, kategoria V "përfshin zonat ku ndërveprimi afatgjatë i njeriut dhe natyrës ka prodhuar vlera ekologjike, biologjike, kulturore dhe estetike të njohura dhe të rëndësishme dhe ku ruajtja e integritetit të kësaj marrëdhënieje është e nevojshme për të mbrojtur dhe mirëmbajtur atë zonë, ruajtur natyrën dhe vlerat e tjera".

#### Ligji për ullishtari dhe vajin e ullirit

Sipas **Ligjit për ullishtari dhe vajin e ullirit ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi", nr. 45/2014 dhe 39/2016)** rregullohet përpunimi dhe tregtimi i frutave të ullirit dhe vajit të ullirit, si dhe çështje të tjera me rëndësi për zhvillimin të ullishtarisë në Mal të Zi.

Në nenin 2 të këtij ligji thuhet:

**"Ullishtat, si pasuri me interes të përgjithshëm, gëzojnë mbrojtje të veçantë dhe shfrytëzohen në kushtet dhe në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj.**

**Ullishta "Ullishta e Valdanosit"** në komunën e Ulqinit, «Ulliri i Vjetër» në komunën e Tivarit dhe "Velja maslina" në komunën e Budvës kanë një nivel të caktuar **mbrojtjeje** në përputhje me Ligjin dhe Programin e lartpërmendur për Mbrojtjen të veçantë të ullinjve, i cili u miratua nga Ministria përgjegjëse për bujqësinë me propozimin e institucioneve shkencore."



Në nenin 14 të këtij ligji janë përcaktuar edhe **ndalesat në ullishtat**:

- **prerjen e ullinjve**, fidanëve, si dhe dëmtimin e tyre, me përjashtim të rastit të prerjes sanitare me pëlqimin e Ministrisë kompetente;
- **rimbjellja e pemëve të vjetra në një vend tjetër** pa miratimin e organit të qeverisjes lokale përgjegjëse për çështjet bujqësore, që lëshohet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbjellje në vend tjetër;
- **ndërtimi i objekteve të banimit, me përjashtim të rasteve të rindërtimit dhe përmirësimit të ndërtesave ekzistuese.**

Përjashtimisht nga ky nen, në ullishtë **mund të ndërtohen objekte që janë të nevojshme në procesin e prodhimit të ullirit**<sup>1</sup>.

## 2.2. Trashëgimia natyrore


### Plazhi i Valdanosit

Plazhi i Valdanosit, i vendosur në gjirin e Valdanosit, rreth 5 km në veriperëndim të Ulqinit, është mbrojtur si **monument i natyrës**<sup>1</sup> në **vitin 1968** nga Instituti Republikan për Mbrojtjen e Natyrës.

Sipërfaqja e zonës së mbrojtur është 3.00 ha, ndonëse nuk është vendosur ndonjë kufi zyrtar për të. Revizioni i mbrojtjes së tij aktualisht po kryhet si procedurë më vete në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit.

Plazhi i Valdanosit është rreth 1000 m i gjatë, i mbuluar me rërë të imët dhe ka një mjedis piktoresk me agrume të mëdha dhe **“nga Ulqini ndahet nga një mal i madh, i cili është padyshim një nga ullishtat më të bukura në vend”**.

Në fletën anketuese për trashëgiminë e mbrojtur natyrore (gjendja më 31.12.1976) thuhet: **“Plazhi është rreth 5 km nga Ulqini. Është e arritshme vetëm nga deti. Me ullishtat dhe agrumet përreth, ajo përbën një tërësi unike”**.



Fleta anketuese për trashëgiminë natyrore të mbrojtur (gjendja më 31 dhjetor 1976)

### Parku i Natyrës „Ulqini i Vjetër“

Si pjesë e Parkut të Natyrës „Ulqini i Vjetër“ mbrohet edhe segmenti i bregdetit dhe zonës ujore të gjirit të Valdanosit, nga Kepi i Mavrianit deri në skajin verior të plazhit të Valdanosit.

Zona e Parkut të Natyrës „Ulqini i Vjetër“ është një zonë e integruar e mbrojtur bregdetare dhe


<sup>1</sup> Web portali për zonat e mbrojtura nacionalne <http://www.prirodainfo.me/>

detare që shtrihet nga ana jugore e Kepit të Karastanovës në veri, deri në skajin verior të plazhit të Valdanosit në jug, në kuadër të cilën mbrohet habitatet e rëndësishme detare dhe bregdetare.<sup>2</sup>

Zona II (e dytë) e mbrojtjes së kësaj zone është “zona bregdetare e Mavrianit nga Kepi i Mavrianit deri në skajin verior të plazhit të Valdanosit, duke përfshirë Kepin e Repit, gjirin e Latova njiva, gjirin e Udovicës dhe gjirin e Shpella e Ujku”.

Zona III (e tretë) e mbrojtjes “në pjesën tokësore, ndjek vijën bregdetare duke përfshirë shkëmbinjtë e detit, shkëmbinjtë dhe shpatet e pjerrëta në shtrirjen nga kepi i Karastanit deri në plazhin e Valdanosit”

Brezi mbrojtës i zonës së mbrojtur “formohet në pjesën tokësore në shtrirjen që është 500 m linearisht në raport me kufirin administrativ të zonës së mbrojtur”.



Kufijtë dhe zonat e mbrojtjes të zonës së integruar të mbrojtur bregdetare dhe detare “Ulqini i Vjetër”

<sup>2</sup> Vendimi për shpalljen e zonës së mbrojtur Parku i Natyrës „Ulqini i Vjetër“, 2022.



### **Mbrojtja parandaluese - Zona me veçori të jashtëzakonshme "Ullishta e Ulqinit me Gjirin e Valdanosit" në komunën e Ulqinit.**

Për shkak të vlerave të jashtëzakonshme kulturo-historike, peizazhore, estetike dhe ekologjike, si dhe diversitetit të konsiderueshëm biologjik, e gjithë zona e Ullishtës së Ulqinit me Gjirin e Valdanos është propozuar për mbrojtje parandaluese në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës si **zonë me veçori të jashtëzakonshme "Ullishta e Ulqinit me Gjirin e Valdanosit"**, e cila klasifikohet në kategorinë V të zonave të mbrojtura "që përfshin zonat ku **ndërveprimi afatgjatë i njeriut dhe natyrës ka prodhuar vlera ekologjike, biologjike, kulturore dhe estetike të dëshmuara dhe të rëndësishme** dhe ku **ruajtja e integritetit të kësaj marrëdhënieje është e nevojshme për të mbrojtur dhe ruajtur atë zonë, natyrën e ruajtur dhe vlerat e tjera**".<sup>3</sup>

Analizën profesionale për nevojën e mbrojtjes parandaluese të lokalitetit "Ullishta e Ulqinit me Gjirin e Valdanosit" në komunën e Ulqinit e ka përgatitur Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në mars të vitit 2022 dhe në bazë të saj është bërë Propozim Vendimi për vendosjen e lokalitetit "Ullishta e Ulqinit me Gjirin e Valdanosit" nën mbrojtje parandaluese" në komunën e Ulqinit.

### **2.3. Pasuritë kulturore me potencial të dëshmuar**

Në zonën e Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanosit **nuk ka pasuri kulturore të paluajshme që janë formalisht të mbrojtura** me Ligjin për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore.

Megjithatë, si pjesë e Studimit të mbrojtjes së pasurive kulturore për qëllim të hartimit të Planit Hapësinor-Urbanistik të Komunës së Ulqinit nga viti 2016, janë njohur si **lokacione potenciale arkeologjike gjiri i Valdanosit dhe lokacioni i Crkvicës me mbetjet e kishës**, kurse **gjiri i Valdanosit si zonë me vlera të theksuara ambientale**. Po ashtu, **ndër objektet që supozohet se kanë vlera kulturore janë krojet e vjetra në Ulqin, gjashtë** prej të cilëve ndodhen në zonën e Ullishtës dhe gjirit të Valdanosit.<sup>4</sup>

Gjithashtu, në vitin 2020, Drejtoria për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore ka **pranuar iniciativat për vendosjen e mbrojtjes** së tre krojeve në territorin e komunës së Ulqinit, dy prej të cilave, **Kroni i Begut dhe Kroni i Çinarit** ndodhen në zonën e Ullishtës.<sup>5</sup>

Gjithashtu, si pjesë e kontributit të ekspertëve për trashëgiminë kulturore nënujore për qëllimet e përgatitjes së Studimit të mbrojtjes për zonën e mbrojtur detare Ulqini i Vjetër, **gjiri i Valdanosit** u njoh si **vend i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore nënujore**, duke pasur parasysh bollëkun e burimeve materiale arkeologjike dhe historike që tregojnë për rëndësinë e jashtëzakonshme të këtij lokaliteti.<sup>6</sup>

### **2.4. Hulumtime dhe studime të mëparshme**

Trashëgimia kulturore dhe peizazhi kulturor i Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanosit deri më tani nuk janë hulumtuar dhe përpunuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të plotë. Megjithatë, ka studime dhe hulumtime që në një masë merren me segmentet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Ullishtës dhe gjirit të Valdanosit.

3 Neni 2 i Propozim vendimit për vendosjen e mbrojtjes preventivne të lokalitetit „Ullishta e Ulqinit me Gjirin e Valdanosit“ në Komunë të Ulqinit.

4 Studimi për mbrojtjen e pasurive kulturore për nevojat e hartimit të Planit Hapësinor-Urbanistik të komunës së Ulqinit, Drejtoria për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore, Cetinë, maj 2016.

5 Iniciativë për vendosje nën mbrojtje të të mirave Kroni i Begut, Kroni i Çinarit dhe Kroni Ujk në Ulqin, Drejtoria për Mbrojtjeve e Pasurive Kulturore, UP/I 02-206/2020 datë 06.07.2020.

6 Raporti i ekspertëve për trashëgiminë kulturore nënujore për nevojat e hartimit të Studimit të për brezin e mbrojtur detar për zonën e Ulqinit të Vjetër, dr. Petra Zdravković, novembar 2020.

### **Studimi i mbrojtjes së pasurive kulturore për nevojat e Planit Hapësinor-Urbanistik të Komunës së Ulqinit, Drejtoria për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore, Cetinë, maj 2016.**

Edhe pse në zonën e Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanosit nuk ka pasuri të paluajshme kulturore që mbrohen formalisht, si pjesë e Studimit për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore janë trajtuar objekte të mundshme arkeologjike, zona me vlera të theksuara ambientale dhe objekte që në mënyrë të arsyeshme supozohet se kanë vlera kulturore.

Ndër **lokalitetet e mundshme arkeologjike** që ndodhen në zonën e Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanosit, veçohen: lokaliteti i Crkvicës me mbetjet e kishës dhe gjiri i Valdanosit.

#### **"Lokacioni Crkvice – me mbetjet e kishës, Valdanos"**

*Pranë fënerit në Kepin Mendra, në bregun të thepisur të detit, gjenden mbetjet arkitekturore të një kisha me përmasa të vogla. Lokaliteti njihet me emrin "Crkvice". Muri jugor i kishës, i ruajtur në një gjatësi rreth 4 m dhe lartësi rreth 1,2 m, duket lehtësisht (sidomos nga deti), ndërsa mbetjet e absidës dhe murit verior janë të fshehura, të tejmbushura me shkurre të trasha.*<sup>7</sup>

#### **Gjiri i Valdanosit**

*Gjetjet arkeologjike paraqiten në zonën e gjerë të pjesës jugore të gjirit, nga fëneri në drejtim të plazhit, duke filluar praktikisht nga bregu, sepse materiali ndodhet edhe në pjesën bregdetare të mbushur me bar deti, i cili për shkak të thellësive të jo të mëdha është i aksesueshëm edhe për zyrëtsve. Disa ekzemplarë, nga forma dhe faktura e tyre, tregojnë se mund t'i përkasin kohës së dominimit romak, por materiali është kryesisht i mesjetës së vonë. Materiali është heterogjen, por mbizotërojnë produktet qeramike.*

*Pavarësisht nxjerrjes aktive të paligjshme, ka një përqendrim të madh të materialit arkeologjik në gjirin. Gjiri është i paeksploruar. Të kryehen hulumtime, rezultatet e të cilave do të përcaktojnë trajtimin e mëtejshëm.*<sup>8</sup>

#### **Gjiri i Valdanosit është caktuar si lokalitet i trashëgimisë kulturore nënujore:**

*"Specifikë e veçantë në aspektin e vlerave kulturore përfaqet trashëgimia kulturore nënujore, e mbrojtur nga dispozitat e konventës së UNESCO-s për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, e cila përfshin këto zona: Gjiri i Valdanos, Gurin e Gjeranave, Lumin Buna, Varkë me avull Carola dhe varkë me avull Goritia.*

*Duhet veçuar Gjirin e Valdanosit, sepse përveç trashëgimisë kulturore nënujore që zotëron, e cila dëshmon për shfrytëzimin shekullor të gjirit për qëllime ankorimi, ai zotëron edhe vlera të jashtëzakonshme ambientale, duke pasur parasysh mbetjet e kishës në kepin e Mendrës dhe ullishtat, të cilat shtrihen thellë në brendësi të vendit".*<sup>9</sup>

Poashtu, gjiri i Valdanosit renditet si **zonë me vlera të konsiderueshme ambientale:**

*"Në zonat me vlera të theksuara ambientale, veçohen zona me vlera të njohura peizazhi që meritojnë vëmendje, ndër të cilat është **kompleksi i Valdanosit me ullishten "Olea Europea"**".*<sup>10</sup>

Studimi gjithashtu liston **objekte që në mënyrë të arsyeshme supozohet se kanë vlera kulturore**, ndër të cilat janë edhe **Krojet e Vjetra** në Ulqin. Nga 11 krojet e dalluara, 6 prej tyre ndodhen në zonën e Ullishtës dhe gjirit të Valdanosit.

*"Gjatë zhvillimit të qytetit të Ulqinit, veçanërisht në periudhën osmane, në qytet dhe rrethinë janë ndërtuar dhjetëra kroje. Duke pasur parasysh faktin se shtrirja territoriale e Ulqinit është përcaktuar dhe finalizuar gjatë shekujve XVII dhe XVIII, shumica e krojeve në Ulqin mund të ishte ndërtuar gjatë asaj periudhe kohore. Nga ato të ruajtura veçohen: **Kroni Ballos, Kroni Doçit, Kroni Shurdhujve, Kroni Malush Riza Resulit, Kroni Mustafait, Kroni Begut, Kroni Bashbylykut, Kroni Ujk, Kroni Pashes, Kroni Çnarit, Kroni Detarve, Kroni Kalase**".*<sup>11</sup>

7 Studimi i mbrojtjes të pasurive kulturore, f. 24


8 Studimi i mbrojtjes të pasurive kulturore, f. 34

9 Studimi i mbrojtjes i pasurive kulturore, f. 24

10 Studimi i mbrojtjes i pasurive kulturore, f. 37

11 Studimi i mbrojtjes i pasurive kulturore, f. 39





Trashëgimia kulturore dhe pasuritë kulturore në kuadër të PHU të komunës së Ulqinit, Studim i Mbrojtjes

### **Kontributi i ekspertit për trashëgiminë kulturore nënujore për qëllim të përgatitjes së Studimit të Mbrojtjes për zonën e mbrojtur detare Ulqini i Vjetër, dr Petra Zdravković, Nëntor 2020.**

Kontributi i ekspertit për trashëgiminë kulturore nënujore për qëllim të përgatitjes së Studimit të Mbrojtjes për zonën e mbrojtur detare Ulqini i Vjetër është dhënë në kuadër të projektit GEF "Promovimi i menaxhimit të zonave të mbrojtura përmes mbrojtjes së integruar të ekosistemeve detare dhe bregdetare në zonën bregdetare të Malit të Zi". Në kuadër të këtij kontributi, **gjiri i Valdanosit** është theksuar veçanërisht si **trashëgimi kulturore nënujore**.

"Gjiri i Valdanosit, me pozicionin dhe orientimin e tij, ofronte strehë të sigurt në rast të erës së fortë jugore apo stuhisë, edhe për anijet më të mëdha. Thellësia brenda gjirit arrin 21 m dhe është regjistruar prania e rrymave intensive detare. Shtrati i detit është kryesisht ranor, i mbuluar me posidoni (leshterik të detit) (Montenegrin Maritime Archaeology Rescue Project).

Megjithatë, **të dhëna të caktuara për këtë lokalitet ekzistojnë vetëm nga periudha mesjetare, kur Valdanosi ishte porti kryesor i piratëve ulqinak, edhe pse disa fragmente qeramike të zbuluara tregojnë ekzistencën e materialeve nga periudha romake.** Burimet historike na flasin edhe për një konflikt të madh detar, pra fundosjen e flotës pirate në spirancë në vitin 1760 nga veziri i Shkodrës Mehmet Bushatliu. Gjithashtu, në fund të shekullit të 19-të, në gjirin janë fundosur trabacula italiane Salamone, trabacula turke Azerti Alia dhe trabacula malazeze Bahrie dhe Corriere Skutarino. **Një sasi e madhe e materialit të lëvizshëm arkeologjik u gjet në shtresat sipërfaqësore të pjesës së poshtme ranore të gjirit.** Shembujt e materialeve që gjenden sot në koleksione private janë kryesisht të padëmtuara ose mungojnë vetëm pjesë të vogla. Gjetjet arkeologjike janë të përqendruara më së shumti në zonën e pjesës jugore të gjirit, nga fëneri drejt plazhit, por edhe në pjesën bregdetare të mbushur me bar deti (Karović, 2001: 67). Falë qasjes

së zellshme të Gordana Karović ndaj koleksioneve private, disa ekzemplarë janë në dispozicion të publikut përmes botimeve dhe dokumentacionit. Midis materialeve heterogjene mbizotërojnë **produktet qeramike - shtambat, vazot oïnohoe, tenxhere, pitosa, pjata dhe tasa të emaluara më të cekëta dhe më të thella të zbukuruara me zbukurime gjeometrike dhe bimore, të cilat mund të lidhen me prodhimin e punishteve të qeramikës italiane nga shekulli i 14-të deri në shekullin e 17-të, dhe llulla turke nga shek. XVIII.** Përveç atyre qeramike, ka **gjetje të shumta të shisheve të qelqit** të bëra nga qelqi jeshil i hapur, i bardhë dhe i errët".<sup>12</sup>

"Sigurisht që lokaliteti më i rëndësishëm në zonë dhe rrethinën e saj është **gjiri i Valdanosit.** Mali i Zi nuk numëron shumë vende të njohura nënujore nga mesjeta e vonë. Bollëku i burimeve materiale arkeologjike dhe historike tregojnë për rëndësinë e jashtëzakonshme të këtij lokaliteti, veçanërisht në periudhën nga shekulli i 14-të deri në shekullin e 17-të. Nga ana tjetër, mbetjet e periudhës antike brenda vilës romake në Kruçë, materiale të lëvizshme por të dëmtuara në afërsi të ishullit Ulqini i Vjetër, si dhe gjurmë strukturash dhe materialesh në vetë ishullin flasin për aktivitet intensiv që u zhvillua në këtë zonë që në shekujt e parë të epokës së re."<sup>13</sup>

Krahas sa më sipër, u theksua rëndësia e trashëgimisë kulturore të gjirit të Valdanosit në tokë: "Gjiri i Valdanosit, përveç trashëgimisë kulturore nënujore që zotëron, e cila dëshmon për përdorimin shekullor të gjirit për qëllime ankorimi, zotëron edhe vlera të jashtëzakonshme ambientale, duke marrë parasysh mbetjet e kishës në Kepin e Mendrës, por veçanërisht ullishtat, të cilat shtrihen thellë në brendësi. Kultivimi tradicional i ullirit ka qenë karakteristikë e kësaj zone prej shekujsh, siç dëshmohet nga ullinjët e Valdanosit, disa prej të cilëve janë qëndra vjeçare".<sup>14</sup>

### **Gjetjet e hulumtimit të Kronit të Begut, Kronit të Çinarit Begova dhe Kronit Ujk në Ulqin, Tanja Vujović, Nela Çvorović, Drejtorja për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore, Cetinë, Shtator 2020**

Në korrik 2020, z. Sami Flamuri nga Ulqini ka dorëzuar në Drejtorinë për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore **Iniciativën për vendosjen e mbrojtjes së pasurisë Kroni i Begut, Kroni Çinarit Kroni Ujk në Ulqin,** dhe ka dorëzuar foto dhe dokumentacion grafik.

Në bazë të **gjetjeve të hulumtimit** të bëra për nevojat e kësaj iniciative (UP/I 02-206/2020-1 datë 10.09.2020) u konstatua se **"të mirat materiale në fjalë paraqesin dëshmi autentike të historisë, kulturës dhe traditës së Ulqinit. Kroni i Begut, Kroni i Çinarit dhe Kroni Ujk janë pasuri arkitekturore për furnizim me ujë me rëndësi dhe veçori historike, arkitekturore, etnografike, ambientale, peizazhore dhe heraldike."**

Në bazë të sa më sipër, Drejtorja për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore **pranoi iniciativën për vendosjen e mbrojtjes.** "Në këtë mënyrë, janë krijuar kushtet për zbatimin e nenit 19 të lartpërmendur, si dhe të neneve 23 dhe 24 të Ligjit për mbrojtjen e pasurisë kulturore dhe Rregullores për kriteret dhe procedurën e detajuar për përcaktimin e vlerës kulturore të pasurisë kulturore (Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" Nr. 41/ 11)."<sup>15</sup>

### **Raporti përfundimtar "Identifikimi i moshës së mostrave të ullirit në Mal të Zi për regjistrim", Dr. Nesiba Köse dhe H. Tuncay Güner, mars 2015.**

Gjatë vitit 2015 është bërë analiza e vjetërsisë së mostrave të ullirit nga komunat e Ulqinit dhe Tivarit nga Laboratori për Anatominë e Drurit dhe Hulumtimin e Unazave të Pemëve, i cili është pjesë e Fakultetit të Pylltarisë në Universitetin e Stambollit. Rezultatet e këtij hulumtimi, të përgatitur nga Dr. Nesibe Köse dhe H. Tuncay Güner, janë paraqitur në Raportin Përfundimtar "Identifikimi i moshës së mostrave të ullirit në Mal të Zi për regjistrim".

Nga territori i komunës së Ulqinit janë analizuar 25 pemë ulliri, të cilat janë përzgjedhur nga

12 Raporti i ekspertëve për trashëgiminë kulturore nënujore, f.2

13 Raporti i ekspertëve për trashëgiminë kulturore nënujore, f. 3

14 Raporti i ekspertëve për trashëgiminë kulturore nënujore, f.2

15 Lënda: Iniciativa për vendosje nën mbrojtje të të mirave Kroni i Begut, Kroni i Çinarit dhe Kroni Ujk në Ulqin, UP/I 02-206/2020 datë 06.07.2020.

popullata lokale. Nga 25 ullinjë të analizuar, **15 ndodhen në zonën e ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanos**. Ulliri më i vjetër në këtë zonë ndodhet në zonën e Anamalit dhe është afërsisht 1892 vjeçare<sup>16</sup>, pra daton në vitin 123 të shekullit II të erës sonë. Në territorin e Bashbylykut gjenden dy pemë ulliri mbi 1000 vjeçare. Ulliri në pronësi të Edin Buzukut është afërsisht 1314 vjeç, pra daton në vitin 701, d.m.th. vetë fillimi i shekullit VIII, ndërsa tjetri që është në pronësi të Maskut-Fatmir Sadikut, është afërsisht 1124 vjet, pra daton në vitin 891, d.m.th. fundi i shekullit të 9-të. Shumica e ullinjve të tjerë të analizuar, të cilët ndodhen kryesisht në zonën qendrore të Ullishtës, rreth Kronit të Begut dhe përgjatë Rrugës për Bisht, janë mbi 600 vjeç deri në 900 vjet, pra nga periudha nga shekulli i 12-të deri në shekullin e 15-të.

### 3. Korniza ndërkombëtare – peizazhi kulturor, peizazhi bujqësor, peizazhet me tarraca

Duke u nisur nga fakti se **trashëgimia kulturore** “përfshin të gjitha llojet e mjediseve të krijuara nga ndërveprimi i njeriut dhe hapësirës në kohë”<sup>17</sup>, **peizazhi kulturor** paraqet kategorinë më të gjerë dhe më gjithëpërfshirëse të trashëgimisë kulturore. Peizazhet kulturore përfaqësojnë **“punë të kombinuara të natyrës dhe njeriut”**. Dokumenti i parë ndërkombëtar që njohu peizazhin kulturor si një lloj trashëgimie kulturore ishte Konventa e UNESCO-s për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore, Udhëzimet Operacionale të së cilës u plotësuan në vitin 1992, duke futur termin “peizazh kulturor”. Termi peizazh kulturor përfshin shumëllojshmërinë e manifestimeve të ndërveprimit midis njerëzve dhe mjedisit të tyre natyror.

Njihen tre kategori themelore të peizazhit kulturor: peizazh i formuar me qëllim, i zhvilluar organikisht dhe peizazh asociativ. **Peizazhi i zhvilluar organikisht** “është rezultat i kërkesave origjinale sociale, ekonomike, administrative dhe/ose fetare, dhe forma e tij aktuale është zhvilluar duke u lidhur me mjedisin e tij natyror dhe si përgjigje ndaj atij mjedisi. Këto peizazhe pasqyrojnë atë proces zhvillimi në formën e tyre dhe karakteristikat e përbërësve të tyre.” Mund të jetë relik (ose fosil) ose një **peizazh i vazhdueshëm** “që ende ka një rol aktiv shoqëror në shoqërinë moderne, i lidhur ngushtë me mënyrën tradicionale të jetesës dhe procesi i zhvillimit të të cilit është ende në vazhdim. Në të njëjtën kohë, ai tregon dëshmi të rëndësishme materiale të zhvillimit të tij me kalimin e kohës.”<sup>18</sup>

**Peizazhet bujqësore ose agrikulturore** bëjnë pjesë në kategorinë e peizazheve të zhvilluara organikisht, të cilat janë rezultat i veprimtarive ekonomike. Shumë prej tyre janë peizazhe të vazhdueshme, të cilat ende kanë një rol aktiv. “Peizazhet bujqësore janë një dëshmi e historisë së gjatë të ndërveprimit njeri-tokë; ata shpesh janë shembuj unik të njerëzve dhe natyrës që jetojnë së bashku dhe ndikimi i tyre reciprok. Ato tregojnë diversitetin e pasur të kulturës dhe peizazhit, sistemet e qëndrueshme të përdorimit të tokës dhe në disa raste luftën e përditshme të njerëzve për të mbijetuar në kushte ekstreme klimatike dhe të jetesës.”<sup>19</sup>

“Gdhendura në sipërfaqen e tokës gjatë mijëra viteve dhe shekujve, gjurmët e mbijetuara të fazave të ndryshme të aktivitetit bujqësor janë ndonjëherë mezi të dukshme dhe ndonjëherë me të vërtetë mahnitëse. **Më e dukshme nga këto zona janë ndoshta fushat me tarraca që mund të gjenden në të gjithë botën, në Lindjen e Largët, në Afrikë, në Ande dhe në të gjithë pellgun e Mesdheut, me fusha orizi dhe vreshta, disa prej të cilave janë të regjistruara në Listën e Peizazheve Kulturore. Muret mbajtëse klasike dhe të kudogjendura, të bëra në teknikën e murit të thatë, mund të duken modeste, por edhe jashtëzakonisht mbresëlënëse, veçanërisht kur formësoni peizazhe të tëra.**”<sup>20</sup>

**Peizazhet me tarraca**, të formuara si rezultat i aktiviteteve bujqësore në terrene të pjerrëta, përfaqësojnë një nga shembujt më karakteristike të peizazheve kulturore dhe rrjedhimisht të trashëgimisë kulturore. Peizazhet me tarraca janë një nga karakteristikat themelore të Mesdheut, të cilat janë ndërtuar në këtë zonë dhe kanë zgatur për shekuj e mijëvjeçarë. Gjetjet arkeologjike të peizazheve me tarraca me mure të thata në Mesdhe datojnë që nga epoka e bronzit.<sup>21</sup> Iniciativa më e rëndësishme qytetare për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e peizazheve me tarraca në mbarë botën është **Aleanca Ndërkombëtare e Peizazhit me Terracë (ITLA)**. ITLA u themelua në Mengzi, Provinca Junan në Prefekturën Red River (Honghe), Kinë, në nëntor 2010, nga entuziastë dhe vizionarë që u takuan atje në Konferencën e Parë Botërore mbi Peizazhet me Tarraca.<sup>22</sup>

17 Koventanta kornizë e Këshillit të Evropës për vlerat e trashëgimisë kulturore për shoqërinë – Faro konventa, 2005

18 UNESCO, Udhëzimet operative për aplikimin e Konventës për Trashëgiminë Botërore

19 World Heritage, numër 69, 2013, <https://whc.unesco.org/en/review/69/>

20 Kishore Rao, World Heritage, numër 69, 2013, <https://whc.unesco.org/en/review/69/>

21 Jacques du Guerny, Lee-Nah Hsu (2010) First Terraced Landscape Conference

22 International Terraced Landscapes Alliance (ITLA), <https://www.itla.si/>

16 Për vlerësimin e vjetërisës janë përdorur 2 metoda. Sipas njëri mosha ishte 1778 vite, kurse sipas tjetri 2005 vite, ashtu që mosha (vlëra) mesatare është 1892 vite.



## 4. Karakteristikat themelore dhe zhvillimi i zonës së Ullishtës së Ulqinit dhe gjirit të Valdanosit

### 4.1. Karakteristikat natyrore




Ekstrakt nga harta topografike, Gjeoportali i Drejtorisë për Kadastër dhe Pronë Shtetërore

**Ullishta e Ulqinit**, është **ullishtë, pyll ulliri** që shtrihet në veriperëndim të Ulqinit, në një gjatësi rreth 4 km, në gjerësi 400-1200m, deri në **gjirin e Valdanosit**. Gjiri i Valdanos është një gji që u krijua kur vija detare u ngrit pas akullnajave të fundit, kur pjesa e poshtme e gjirit u zhyt. Nga deti Gjiri ndodhet 4 milje detare në veriperëndim të Ulqinit.

I gjithë bregdeti i Ulqinit karakterizohet nga një varg kodrash (kodrinash) që gradualisht ngrihen drejt Rumisë, **drejtimi i të cilave është dinarik veriperëndim - juglindje**. Midis këtyre **kodrave, me** përbërje gëlqerorë të Kretakut, gjenden **lugina** dhe fusha, të krijuara me sedimente detare të eocenit dhe depozitime aluviale (ranorë me shtresa, konglomerate, merlë dhe argjila) – zona flishore.<sup>23</sup>

Në hartën gjeologjike të Malit të Zi, dallohet qartë zona e Ullishtës, e cila i përket **zonës së flishit** (E3 - flishi: konglomerate, ranorë dhe merla), ndërsa Mendra, Mali i Bardhë dhe Mavriani janë **zona gëlqerore** (K32 - Shtresore dhe gëlqerorët e brigjeve me radiolite dhe hipurite dhe gëlqerorët e kuq marmelorë me globotruncas, E2 – Gëlqerorë numulitikë).



Ekstrakt nga Harta Gjeologjike e Malit të Zi (1985)

Valdanosi është një gji i ngushtë dhe i thellë në fund të të cilit është një plazh zhurrore e përbërë nga guralecë të mëdhenj. Gjiri i Valdanos ka formën e një patkoi të ngushtë dhe mbrohet në skajet nga dy kepeve gëlqerore, në anën verilindore **Kepi Bishtit**, pra Mavrianit dhe **Kepi Mendra** në jugperëndim. Gjiri është i **rethuar nga të dyja anët nga shpatet e kreshtave gëlqerore**, në jug, drejt detit të hapur, nga **Mendra** (162 m) dhe në veri, drejt kontinentit, nga **Radoça** (378 m) dhe **Mavriani** (389 m)<sup>24</sup>, tek e cila vazhdon **Mali i Bardhë** (327 m).

Prandaj, zona e **Ullishtës** është një luginë flishore e vendosur midis kodrave gëlqerore të Mendres drejt detit, dhe Radoçit, Mavrianit dhe Malit të Bardhë në pjesën e brendshme. Theksojmë se Radoçi ndodhet në hartat topografike të gjysmës së parë të shekullit të 20-të, ndërsa në hartat topografike të viteve shtatëdhjetë të shekullit të 20-të dhe hartat më të reja, zona e Radoçit dhe Mavrianit gabimisht quhet me një emër të vetëm - Marian në vend të Mavriani.

23 Radojičić 2008, f. 75

24 Haxhibrahimović 1992, f. 56





Ekstrakt nga harta në të cilën dallohen qartë Radoçi dhe Mavriani, harta është bërë në bazë të hartës së Institutit Gjeografik Ushtarak të Mbretërisë S.K.S. nga viti 1928, dhe sipas hartës së vitit 1925.

Për shkak të vendndodhjes dhe orientimit të tij, gjiri i Valdanosit është i **mbrojtur mirë nga erërat e jugut** dhe për këtë arsye paraqet një **port natyror** shumë të përshtatshëm në afërsi të qytetit të Ulqinit.

Në vetë kontaktin e gurit gëlqeror me sedimentet e poshtme të flishit shfaqen **burime** të shumta, të cilat janë të pasura me ujë në periudhën e dimrit dhe prej tyre formohen lumenj dhe përranj të shumtë. Karakteri karstik i zonës kontribuon në faktin që përranjtë ekzistues thahen periodikisht, pra kthehen në përranj të rrëmujshëm gjatë reshjeve intensive. Pjesa më e madhe e rrjedhave ujore në territorin e komunës së Ulqinit klasifikohen si përranj, me efekt eroziv mjaft të theksuar. Ndër **përrojet e rrëmbyeshme dhe shpatet** në zonën e Ulqinit veçohet Valdanosi, sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës e të cilit është 2,89 km<sup>2</sup>, dhe sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës nën erozion është 0,27 ha, ndërsa sasia e sedimentit është 50 km<sup>2</sup>.<sup>25</sup> **Përroi i rrëmbyeshëm Valdanosit** shtrihet në mes të luginës në një gjatësi rreth 1600 m në drejtimin juglindor-veriperëndimor dhe derdhet në det afërsisht në mes të plazhit të Valdanos.

Përveç përroit kryesor të rrëmbyeshëm të Valdanosit, në Ullishtë ka **përranj të shumtë më të shkurtër**, të cilët rrjedhin nga shpatet e Malit të Bardhë dhe Mavriani, shtrihen në drejtimin verilindje-jugperëndim, pingul me drejtimin e luginës dhe vazhdojnë përmes përranjeve deri në det.

**Ullishta** shtrihet përgjatë luginës nga gjiri i Valdanosit deri në Ulqin. Lugina ka një pjesë të poshtme të ultë që vazhdon deri në plazhin e Valdanosit dhe ndjek përroit e rrëmbyeshëm të Valdanosit. Lugina ka një pjerrësi të lehtë drejt detit dhe në zonën e sipërme ku ndodhet burimi i rrjedhës së rrëmbyeshme arrin një lartësi prej rreth 60 m. Ullishta ngjitet në shpatet e kodrave që rrethojnë luginën në veri dhe në jug, deri në zonën ku takohen flishi dhe guri gëlqeror. Ullishta shtrihet përgjatë shpateve jugore të Mavriani, deri në lartësinë rreth 120 m dhe në një masë më të vogël edhe në shpatet veriore të Mendrës, deri në lartësinë rreth 60 m.

Mbi burimin e rrjedhës së rrëmbyeshme, lartësia e luginës ngrihet ndjeshëm, kështu që e gjithë pjesa lindore e luginës, në të cilën ndodhet pjesa qendrore e Ullishtës, është afërsisht 110 deri në 120 m lartësi. Edhe në këtë zonë, Ullishta ngjitet në shpatet e Malit të Bardhë në veri, në zonën ku takohen flishi dhe guri gëlqeror, në një lartësi maksimale rreth 180 m. Në këtë zonë, në anën jugore të Ullishtës, përfshin shpatet e Mendrës, Çivlakut, Bashbylykut dhe Gllavicës, deri në Meterizi mbi Ulqin, si dhe pjesërisht luginat ndërmjet tyre. Gjithashtu, në këtë zonë Ullishta përfshin plotësisht kodrën Bashbylyk, me dy maja 161 m dhe 130 m, dhe shtrihet deri në bregun e detit. Në të kaluarën, ullishtat përfshinin të gjithë kodrat e Gllavicës dhe Meterizit, por tani, për shkak të urbanizimit, sipërfaqja nën ullinj në këto zona është ruajtur vetëm në segmente.



Paraqitja tërthore përmes Ullishtës (Mavriani, lugina, Mendra), Mali i Bardhë dhe pjesa qendrore e Ullishtës, pamje nga lindja



## 5. Zhvillimi historik

“**Qyteti i Ulqinit** ndodhet përgjatë bregut të detit, në një vend shumë të bukur, me një sipërfaqe mjaft pjellore dhe të bollshme me **ullishtë** dhe shumë pemë të tjera me pemë frutore të ndryshme.” (Raport dhe përshkrim i Sanxhakatit të Shkodrës, Marian Bolica, 1614)

“Vend i preferuar për ankorim është **Valdanosi**. Çfarë është Gruzhi për Dubrovnikun, është Valdanos për Ulqin. Valdanos ofron siguri më të madhe sepse është i mbrojtur mirë nga era e jugut.” (Portet e Malit të Zi, Ernesto Tergesti, 1881)

Ullishta e Ulqinit dhe gjiri i Valdanosit janë të **lidhura në mënyrë hapësinore dhe funksionalisht me qytetin e Ulqinit**, prandaj zhvillimi historik i kësaj zone duhet parë në raport me zhvillimin historik të Ulqinit.

### 5.1. Rrjedhat historike në zonën e Ulqinit

Ulqini ndodhet në një pozitë natyrore të spikatur dhe me rëndësi strategjike. Ndonëse ka supozime se zona e Ulqinit ka qenë e banuar gjatë neolitit, vendbanimi origjinal, një polis ose emporion **iliro-grek** (vend më i vogël tregtar), ndoshta është krijuar **në fund të shekullit të 5-të ose në fillim të shekullit të IV-të para erës së re**. Këtë e vërtetojnë mbetjet arkeologjike të segmenteve të mureve të punuara në teknikën ciklopikë, si dhe altari prej guri i gjetur në Kalanë e Ulqinit, i cili iu kushtua perëndeshës Artemis nga komuniteti i gurgdhendësit. Në burimet antike thuhet se Ulqini fillimisht quhej **Colchinium**, sepse supozohet se ishte themeluar nga kolkët. Për shkak të pozitës që kishte në periudhën ilire, Ulqini ishte një nga vatrat më të mëdha të piratëve dhe kusarëve. Romakët ndërmorën luftën e parë kundër ilirëve, pikërisht me synimin për të parandaluar piraterinë ilire në portën e Otrantos.

Në periudhën **romake**, Ulqini ishte *oppidum* - qytet i fortifikuar i qytetarëve romakë. Përmendja e parë e tij në burimet e shkruara, si **Olcinium**, lidhet me vitin 168 p.e.s., kur u zhvillua lufta e fundit iliro-romake.

Në periudhën e krishterimit të hershëm, bazuar në mbetjet e një kisha më të vogël, mund të supozohet se është **rindërtuar në kohën e perandorit bizantin Justinianit**, kur ndoshta është bërë qytet peshkopal. Gjatë mesjetës Ulqini përmendej si *Helcynio*, *Ulcini* (1076), *Ulcignum* i *Dulcignum* (1089), *Лцинь* (1216) i *Оцинь*.

Në **shekullin XI** Ulqini i përkiste **sundimtarëve të Duklës nga dinastia e Vojislavleviqëve**. Që nga **viti 1183**, ishte **pjesë e shtetit të Nemanjiqëve**. Nga **gjysma e dytë e shekullit të 14-të** Ulqini sundoi familja e Balshajve. Pas vdekjes së Balshës III në **1421**, qyteti i përkiste Venedikut - **Republikës së Venedikut**. Që nga viti **1572**, Ulqini është pjesë e **Perandorisë Osmane**. Që nga viti **1880**, sipas Vendimeve të Kongresit të Berlinit, i përket **Malit të Zi**. Në fillim të shekullit të 20-të, nga viti **1918**, Ulqini ishte pjesë e **Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve**, respektivisht **Mbretërisë Jugosllave** që nga viti **1929**. Pas Luftës së Dytë Botërore, që nga viti **1945**, qyteti është pjesë e **Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë**, dhe që nga viti **2006**, me rivendosjen e pavarësisë, në kuadër të **Malit të Zi**.



Gravura e Ulqinit - Dulcigno, Giovanni Francesco Camocio, rreth vitit 1574.

### 5.2. Valdanosi dhe Ullishta në parahistori dhe antikitet

Në zonën e Valdanos, aktualisht nuk ka gjurmë të dokumentuara të epokës së vjetër ose të gurit, gjë që rezulton nga shtrirja e kufizuar e hulumtimeve arkeologjike në zonë. Pavarësisht mungesës së gjetjeve arkeologjike në kontekstin stratigrafik, ekziston një **supozim i justifikuar se zona më e gjerë e Valdanosit ka qenë e banuar gjatë neolitit**. Një nga gjetjet e rrallë të njohura që ngjall kuriozitet është një vegël e lëmuar me teh prej serpentinitit (?), e gjetur në vendbanimin e Krythës, paraprakisht e datuar nga neoliti (Çitaku 2023, 13). Është e rëndësishme të theksohet se datimi më i saktë i gjetjeve të tilla është një sfidë, sepse mjete të ngjashme mund të gjenden edhe në kontekste të periudhave të metalit. Sipas analizës funksionale dhe tipologjike, ky shembull i veçantë i një mjeti të lëmuar mund të identifikohet si një sëpatë çekiç me vrime në formë të gjetit. Fundi proksimal me kurorën është i rumbullakosur dhe veçoria që tërheq vëmendjen është foleja cilindrike e destinuar për dorezën prej druri.

Informacioni që tërheq vëmendje të veçantë i referohet ekzistencës së një shpelle pjesërisht të zhytur me paraqitje në shkëmb e njohur si Mjekra e Vezirit. Kjo shpellë ndodhet midis Kepit Mendra dhe shpellës Golubinjka në det të hapur. Edhe pse aktualisht nuk kemi konfirmim për ekzistencën e paraqitjeve në shkëmbinj, saktësia eventuale e këtij informacioni mund të sigurojë njohuri jashtëzakonisht të vlefshme për vetë natyrën e këtij lokaliteti. Megjithatë, duhet të merret parasysh edhe mundësia e gabimeve gjatë citimit të burimeve të që mbivendosn. Ekziston një probabilitet që Mjekra e Vezirit e përmendur në bibliografi i përket një zone tjetër gjeografike (Vujiçiq 1986; Haxhibrahimoviq 2013). Prandaj, do të nevojiteshin hulumtime dhe konfirmime shtesë për të përcaktuar saktësinë e këtij informacioni intrigues.


**Peizazi i parë kulturor i perceptuar më mirë në këto zona** shfaqet në **fillim të epokës së bronzit**, kur paraqiten ndërtimet e para monumentale (kryesisht tumat e varreve prej guri), të




cilat sugjerojnë praktika krejtësisht të ndryshme kulturore dhe funksionale të organizimit të jetës dhe shënjimit të hapësirës së në periudhat e mëparshme, sidomos neolitit. Megjithatë, **zona e gjerë e Valdanosit karakterizohet nga mungesa e tumave dhe fortifikimeve** në një masë që ngjall kureshtje dhe ngre pikëpyetje për specifikat e kësaj zone.

Lajmet e para për **bregun lindor të Adriatikut jugor në lashtësi** lidhen me traditën greke të gjeografisë mitike, e cila është një konstrukt i imagjinatës poetike dhe vëzhgimeve të drejtpërdrejta të marinarëve dhe tregtarëve grekë. Kështu, miti i Kadmit dhe Harmonisë paraqet një lidhje unike mes kësaj zone dhe botës antike, ndaj mund të thuhet se bregdeti malazez po merr rëndësi për mitologjinë greke në përgjithësi.

Në fillim të epokës së re të hekurit, në burimet antike u shfaqën të dhënat e para për **fiset ilire** që banonin në zonën e Adriatikut jugor. Lajmin më të vjetër për këtë pjesë të bregdetit të Adriatikut e jep **Pseudo - Scylax** në itinerarin detar, respektivisht **Periplun**. Ky traktat gjeografik nga **gjysma e dytë e shekullit IV p.e.s.** në të vërtetë përfaqëson një portolan, pra pilot (pëlar), i cili kishte shërbyer për lundrimin e marinarëve në Mesdhe (Martinović 1966, 107) por edhe në Detin e Zi. Ndonëse ky tekst na ka mbërritur shumë i korruptuar, përveç përshkrimeve bazë të lundrimit, ky udhëzues jep informacion të rëndësishëm për topografinë e fiseve të veçanta ilire dhe vendndodhjen e qendrave të tyre fisnore. Për ne është veçanërisht interesant përmendja e fisit ilir të Enheleja (Ἐνχελειοί), qendra e tyre fisnore Risani (Ῥιζοῦς), periferia e rëndësishme tregtare e Budvës (Βουθόνη), por edhe vendi i varrimit të figurave mitike Kadmusit dhe Harmonisë. Pseudo-Skylaks në kapitullin e 24-të të *Peripla-së* përmend gurët (λίθοι) të Kadmusit dhe Harmonisë dhe *shenjtororen* (ἱέρων) që nuk është shumë larg lumit Ἀρίων. Është interesant fakti se lumi me të njëjtin emër Ἀρίων ποταμός rrjedh edhe nëpër Kolkidë, nëpër tokën e Bizerës (Βύζηρος). Ky është përmendja e vetme e lumit Kolkis Ἀρίων në burimet e lashta, ashtu si emri i tij Adriatik. Rrjedha e lumit Kolchis të pidentifikuar Ἀρίων ποταμός, në kapitullin 82 të *Peripla-së*, duhet kërkuar në brezin e ngushtë midis deltat e lumenjve Apsaros (Ἀψαρος) dhe Arabis (Ἀραβίς) në Detin e Zi.



Fragment i Periplus i Pseudo-Scylax, faksimile e kopjes së ruajtur të tekstit origjinal grek nga shekulli i 13-të (1855) Universiteti i Leicesterit.



Marrë nga P. Counillon, *Le Périples du Pseudo-Skylax et l'Adriatique*, § 17-24, in S. Čače, A. Kurilić, F. Tassaux (ed.), *Les routes de l'Adriatique antique. Géographie et économie / Putovi antičkog Jadrana. Geografija i gospodarstvo, Bordeaux-Zadar, 2006 (Ausonius Éditions, Mémoires, 17).*

Kronikani më i rëndësishëm i së kaluarës romake të epokës së Augustit, **Tit Livi** (lat. Titus Livius), në veprën e tij **Ad urbe condita**, jep të dhëna lidhur me ndarjen e shtetit të Gentit. Pas shembjes së qendrës ilire, u krye riorganizimi administrativ i territorit të pushtuar të fiseve ilire. Kështu, ndër rrethet ilire në bregun lindor të Adriatikut jugor, ndër të tjera **përmendet edhe territori i banorëve të qytetit të Ulqinit** (Liv. XLV, 26).

Në gjurmën e lumit misterioz Kolkis Ἀρίων, rastësisht ose jo, qëndron regjistrimi i **Plinit Plakut** (lat. Gaius Plinius Secundus Maior), Në veprën e famshme **Naturalis historia** në kapitullin 28, që i referohet Liburnisë (Liburniae), pas Epidaurit renditen qytetet e qytetarëve romakë: Rhizinium, Acruium, Butuanum dhe **Olcinium (Colchinium)** i themeluar nga kolkët (Plin. III, 144). Nëse i njëjti emër hidronimesh të largëta vërteton lidhjen mitike midis Kolkidës së largët dhe Ilirisë së Jugut, mbetet e pakuptueshme në vetvete. Aspektet mitologjike dhe lidhjet midis këtyre zonave mund të mbeten vetëm çështje spekulimesh, pasi mungesa e dëshmive të drejtpërdrejta arkeologjike lë pak hapësirë për shqyrtim.

Këtë **përmbledhje të shkurtër të burimeve antike** që i referohen një pjese të zonës moderne të Malit të Zi e përfundojmë me të dhënat e **Klaud Ptolemeu** (gr. Κλαύδιος Πτολεμαῖος). **Gjeografia** e tij është një nga veprat më të rëndësishme për njohjen e gjeografisë së botës greko-romake. Vlera më e madhe e punës së Ptolemeut pasqyrohet në idenë e pozicionimit të saktë hapësinor, këtu nënkuptojmë gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike. Me caktimin e përcaktuesve hapësinorë, Ptolemeu u përpoq të përcaktojë pozicionet e saktë gjeografike të qyteteve të rëndësishme (Novaković 1974, 14). Me permutacione të caktuara, të dhënat gjeografike për zonën jugore të Adriatikut janë mjaft të përdorshme. Renditja e qyteteve dhe zonave gjeografike sipas Ptolemeut është si më poshtë: Ῥίσινον, Ἐπίδαυρος, Ἀ(σ)κρουιον, Ῥιζονόκος κόλπος, Βουλουα (ἡ Βουτουα) dhe Ουλκίνιον (Ptol. II, 16, 5).

**Tabula Peutingeriana** nga një autor anonim është një hartë rrugore romake, domethënë një përprjekje për të përshkruar grafikisht rrjetin e rrugëve në Perandori. Harta ka informacion të vlefshëm për rrugët, distancat e udhëtimit (largësia) dhe vendbanimet pranë tyre. Ajo u krijua si një manual udhëtimi për territorin e Perandorisë. Përdorimi i saj praktik ndikoi në deformimin e projeksionit gjeografik sepse përdorej si rrotull. Prandaj, hapësira e kufizuar në të cilën duhej të shfaqej grafikisht sistemi i komunikimit çoi domosdoshmërisht në një deformim të theksuar gjeografik të formës së tokës, ku hapësira: veri-jug jepet shumë e ngjeshurë dhe hapësira lind-



je-perëndim është shumë e zgatur. Elementet hartografike që lehtësojnë interpretimin janë: miljet, vinjetat e stacioneve rrugore dhe vendbanimeve, por edhe disa veçori topografike si rrjedhat e lumenjve, masivet malore dhe vijat bregdetare (Bojanovski 1974, 20). Harta e Peutinger-it mund të thuhet se përfaqëson riprodhim piktorial të një itinerari (itinerarium pictum), sepse në asnjë rast nuk ka vlerë hartografike.

Një pjesë e rrugëve të treguara të udhëtimit kalonin nëpër territorin e Malit të Zi të sotëm. Koncepti bazë i rrjetit rrugor u zhvillua në lidhje me një drejtim rrugor dominues Narona - Scodra. Kjo rrugë është ndërtuar për nevoja ushtarake (*viae militares*) dhe përfundimisht do të bëhet një rrugë publike (*viae publicae*). Stacionet e mëposhtme janë të listuara në itinerarin Epidaur - Scodra: Resinum (XX), Vicinium (XV), Batua (XX) dhe Scobre. Shumica e autorëve janë të mendimit se ka pasur një gabim në numërimin e vendeve në rrugën Epidaur - Scodra, sepse Vicinium, d.m.th. Ulqini, përmendet midis Risanit (?) të sotme dhe Budvës.



Tabula Peutingeriana, marrë nga: K. Miller, Die Peutingersche Tafel, 1962.

Në atlasin monumental të përgatitur nga gjeografi venecian Vincenzo Maria **Coronelli**, në seksionin e pestë të *Corso del Danubio da Vienna Sin a Nicopoli*, hasim në një sistemim mjaft interesant të toponimeve që është padyshim rezultat i kompilimit të disa burimeve historike dhe hartografike. Lokalizimi i toponimit Vicinium për këtë murg françeskan i përgjigjet Ulqinit (Dolcigno), ndërsa Olcinium lidhet me Ulqinin e Vjetër (Dolcino Vecchio) dhe gjirin e Valdanos (Valle di Noce).

Është evidente se **predispozitat natyrore të gjirit të Valdanosit**, në raport me pjesën më të madhe të bregdetit malazez, janë njohur sigurisht në të kaluarën. Nëse marrim parasysh se gjiri i Valdanosit, **pranë gjirit të Bigovës, përfaqëson një port të rrallë të sigurt përgjatë bregdetit malazez drejt detit të hapur**, lind supozimi se **ky port natyror përfaqësonte ndoshta një nga pikat më të rëndësishme detare antike** në lundrimin përgjatë bregdetit tonë. E vetmja pikë e dobët e gjirit të Valdanos është hyrja nga erërat perëndimore dhe jugperëndimore (punenta dhe lebiq), të cilat mund të shkaktojnë det shumë të trazuar dhe kështu të vështirësojnë manovrimin, hyrjen ose ankorimin e sigurt.

Ekzistenca e **mbetjeve të një vile antike të vonë (villa rustica) në Kruçë** paraqet dëshmi të rëndësishme arkeologjike që mbështesin supozimet e deklaruara më parë. Analizat e këtyre gjetjeve arkeologjike tregojnë se ato janë mbetje të arkitekturës së një ndërtese, e cila, edhe pse vetëm pjesërisht e eksploruar, ndoshta i përket një kompleksi më të madh në vendndodhjen

Kodra.<sup>26</sup> Për më tepër, gjetjet e përmendura janë të lidhura me mbetjet antike në ishullin Ulqini i Vjetër, ndër të tjera, ndoshta një specula (far - kullë?), duke sugjeruar mundësinë e ekzistencës së disa bërthamave antike në një zonë më të gjerë.<sup>27</sup>

Kjo konfirmohet edhe nga **gjetjet e amforave** të shumta në koleksionet private që u nxorën nga nën detin i gjirit të Valdanos. Nga grupi i gjetjeve bien në sy amforat e tipit Lamboglia 2 dhe Dressel 6A, si dhe tipa kronologjikisht më të rinj, ndoshta Forlimpopoli D, së bashku me gjetjet e tapave të amforave dhe peshave për rrjetat e peshkimit. Padyshim që **materiali arkeologjik i mbledhur konfirmon vazhdimësinë në shfrytëzimin e gjirit të Valdanos**. Nga ana tjetër, kjo ngre pyetjen e kontekstit arkeologjik të portit të mundshme antike dhe marrëdhënies së tij me vilat aty pranë në bregdet dhe në brendësi. Pozicioni i gjirit të Valdanos në rrugën antike të lundrimit, përgjatë bregut lindor të Adriatikut, duket veçanërisht i rëndësishëm si një port ndihmës. Porti i Ulqinit është veçanërisht i ekspozuar ndaj erërave të kuadrantit jugor, i cili paraqet rrezik në lundrimin e anijeve me vela, prandaj nuk është për t'u habitur që gjiri i Valdanosit është shënuar posaçërisht në portolanet mesjetare dhe në harta të tjera.

Vërejtja e Vincenzo Coronelli-t se Valdanos (Valle di Noce) është i përshtatshëm për pranimin e anijeve më të mëdha duhet të citohet në mbështetje të kësaj teze. Theksohet veçanërisht rëndësia e tij lundruese në kushte të ndryshme të motit në det, pra vëzhgimi se gjiri nuk është i përshtatshëm për hyrje në erërat perëndimore dhe jugperëndimore.<sup>28</sup> Një përshkrim i ngjashëm nga i njëjti autor i referohet portit të Trashtës (Trasto Porto), i cili është i përshtatshëm për shërbimin e anijeve më të vogla.<sup>29</sup>

Organizimi i një **portit të mundshme antike**, pavarësisht nga madhësia e tij, nënkupton sigurimin e kushteve minimale për pritjen dhe servisimin e anijeve. Prandaj, ekziston mundësia që mbetjet e instalimeve antike të portit ose të paktën mbetjet e të ashtuquajturave ankorimeve, të cilat vërtetohen deri diku nga "vendet e amforave". Pamundësia e dukshme dhe njohjes së menjëhershme të tyre është rezultat i proceseve të vazhdueshme dhe afatgjata gjeologjike dhe detare, si dhe proceseve të transgresionit së tokës. Gjegjësisht, në fillim të epokës së re, u shënuar një rritje progresive e nivelit të detit si pasojë e transgresionit të vonë tokësore. Ky fenomen ka si pasojë që disa objekte portuale, si dhe objekte pranë ish-bregut, në zonën e Mesdheut janë tashmë nën det.

Në lidhje me gjetjet antike, por edhe supozimet për ekzistencën e portit, më së miri lidhen **sipërfaqet më të mëdha të organizuara me kultivimin e ullirit në territorin e Malit të Zi, e ashtuquajtura Ullishta** që është e vendosur në veriperëndim të Ulqinit. Zonat agrare për rritjen e ullirit janë të organizuara në parcela me tarraca dhe përfaqësojnë një nga veçoritë më të rëndësishme të zonës kulturore në zonat karstike të Adriatikut lindor. Morfologjia e tyre kushtëzohet drejtpërdrejt nga pjerrësia e terrenit. Kështu, forma të ngushta dhe të zgjatura të parcelimit hasen në terrene më të pjerrëta, duke iu përshtatur topografisë lokale. Intervali për ndryshimin e njësive hapësinore (parcelave) do të rritet sipas rritjes së pjerrësisë së terrenit, pra zvogëlimit dhe rritjes së sipërfaqes, duke ulur pjerrësinë. Parcelat janë pothuajse si rregull të përcaktuara në hapësinorë me të ashtuquajturat kufij (megja) të cilët përveç rolit të rëndësishëm ndërtimor paraqesin edhe vijën në të cilën shtrihet e drejta e pronarit mbi pronën.

Ndonëse nuk kemi dëshmi të mjaftueshme konkrete për kultivimin e organizuar të ullirit dhe hardhisë në periudhën antike në bregdetin e Malit të Zi, ka të dhëna të caktuara për ekzistencën e këtyre praktikave. Moshë e ullishtave në zonën e Ullishtës për një kohë të gjatë vlerësohej përafërsisht. Rezultatet e fundit të datimit të pemëve individuale të ullirit tregojnë pa mëdyshje kompleksitetin e jashtëzakonshëm kronologjik të Ullishtës, duke treguar për moshën më të madhe të kësaj zone kulturore.

Funksionit, origjinës dhe moshës së këtij organizimi agrarë të veçantë hapësinor, shpesh nuk iu kushtua rëndësi e mjaftueshme. Analizat dhe interpretimet e rralla sugjerojnë se procesi i shpyllëzimit ka luajtur një rol kyç në formimin e një organizimi të ri hapësinor, d.m.th. në krijimin

26 Të mirat kulturore Kruç – lokaliteti arkeologjik në Ulqin i vendosur nën mbrojtje më aktvendim e Entit për Mbrojtjen e Monumenteve NR MZ, Cetinë, numër 02-602/1 datë 02.04.1984.

27 Në shtator të vitit 2023, pas punës në teren për nevojat e këtij studimi, erdhëm deri te informacione ende të pakonfirmuara, se në zonën e ish pushimroes ushtarake ndodhen mbetjet e një vile të lashtë.

28 Valle di Noce capace di grossi vascilli buono per tutti venti eccetto Ponente Garbino.

29 Trasto Porto per piccioli vascilli.



e të ashtuquajturit. "kultura e tarracave mesdhetare", dhe kjo mund të kishte ndodhur tashmë pas pushtimit romak të këtyre zonave. Një nga sfidat në studimin e strukturave me tarraca qëndron në mungesën e treguesve të qartë kronologjikë që do të konfirmonin edhe moshën relative të tyre. Pa këtë informacion, datimi i një organizimi të tillë hapësinor bëhet i vështirë, dhe rrjedhimisht edhe kuptimi i evoluimit të tyre me kalimin e kohës.

Megjithatë, **hulumtimi i fundit mbi moshën e ullinjve** në zonën e Tivarit dhe Ulqinit ofron të dhënat e para relevante për moshën e plantacioneve të ullirit në këtë zonë (Köse dhe Güner 2015). Këto të dhëna mund të ofrojnë informacion kyç që do të ndihmojë për të kuptuar më mirë kornizën kohore të shfaqjes së tarracave agrare. Kështu, shembujt më të vjetër të ullinjve në territorin e komunës, të datuara me metodën dendrokronologjike, i përkasin **shekujve II dhe III**, gjë që **përkon pjesërisht me gjetjet e sipërpërmendura nga nëndeti i gjirit**.



Harta horizontale e shpërndarjes së pemëve të datuara nga: Köse, N. dhe Güner, T. (2015). Identifikimi i moshës së mostrave të ullirit në Mal të Zi për regjistrim, në kuadër të projektit: 130269 - "Forcimi i konkurrencës së SME-ve lokale në Mal të Zi përmes zhvillimit të klasterëve".

**Datimi i plantacioneve të ullirit mund të luajë një rol kyç në përcaktimin e moshës së tarracave** ku ndodhen këto pemë. Ky proces ofron një pasqyrë të vlefshme në kontekstin historik dhe zhvillimin e zonave agrare që janë formuar me kalimin e kohës. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se kjo është një detyrë komplekse, shpesh e penguar nga numri i kufizuar i mostrave në dispozicion. Megjithatë datimi i plantacioneve të ullirit lejon përcaktimin indirekt të moshës së tarracave, lidhja e drejtpërdrejtë e datave të mbjelljes me datat e ndërtimit të tarracave mund të jetë problematike. Arsyet për këtë janë të shumta, duke përfshirë mungesën e të dhënave të sakta, regjistrimeve arkivore apo informacioneve të tjera relevante që mund të shërbejnë për të zbuluar kornizat kohore dhe sinkronizimin e tyre. Prandaj, në situatën aktuale, është e rëndësishme t'i qasemi kësaj detyre me kujdes dhe vetëdije për kufizimet e mundshme.

Së fundi, **nëse kultivimi i ullinjve mund të lidhet me periudhën antike**, është logjike të **supozohet se transporti i mallrave, në këtë rast ullirit apo vajit i ullirit, ndoshta ka shkuar nga deti**. Valdanosi, me konfigurimin e tij natyror, **mund të luante një rol kyç në atë logjistike**, duke shërbyer si një **port natyror** ose **qendër për tregti** që lehtësonte transportin e produkteve në Adriatikun jugor. Duke marrë parasysh **produktivitetin e lartë të zonës dhe afërsinë**

**e saj me rrugën kryesore rrugore Naronë - Scodra, ekziston një supozim i justifikuar për ekzistencën e një porti të organizuar në periudhën antike**. Prandaj, Valdanosi mund të **përfaqësojë një qendër kyçe për shpërndarjen e produkteve dhe mallrave në Adriatikun jugor**.

Mbetjet e arkitekturës sakrale të mundshme mesjetare u gjetën në anën veriore të gadishullit Mendra, ku mbetjet e një kishe me përmasa të vogla janë të dukshme pikërisht në breg të detit. **Materiali arkeologjik mesjetar dominon në shtratin e detit**, si dhe në **koleksionet private, duke treguar vazhdimësinë e rëndësisë së gjirit të Valdanos në epokë të ndryshme historike**. Gjiri i Valdanosit padyshim nuk e ka humbur rëndësinë e tij me kalimin e kohës, gjë që mund të konkludohet nga bollëku i materialit arkeologjik që i përket periudhave të ndryshme. Edhe pse mbetjet e kishës janë të rëndësishme, materiali arkeologjik në shtratin e detit thekson në mënyrë shtesë frekuencën e gjirit dhe në përgjithësi shtrirjen e aktiviteteve detare në këtë zonë.

### 5.3. Valdanosi dhe Ullishta nga mesjeta deri në shekullin e 20-të

#### 5.3.1. Gjiri i Valdanosit

Duke pasur parasysh karakteristikat natyrore, gjirit të Valdanosit, nëpër periudha të ndryshme historike, ishte *"vend i preferuar për ankorim... Ajo që është Gruzhi për Dubrovnik, Valdanosi është për Ulqin."*<sup>30</sup> Trashëgimia kulturore nënujore dëshmon për përdorimin shekullor të këtij gjiri për nevoja ankorimi. *"Bollëku i burimeve materiale arkeologjike dhe historike tregojnë për rëndësinë e jashtëzakonshme të këtij lokaliteti, veçanërisht në periudhën nga shekulli XIV deri në shekullin XVII."*<sup>31</sup>

Gjithashtu, konfirmimi i rëndësisë së gjirit të Valdanos si port i rëndësishëm në bregun lindor të Adriatikut gjendet në hartat detare, ku **Valdanos shfaqet si një vend i rëndësishëm që nga viti 1318**, vazhdimisht deri në shekullin e 18-të, si dhe më vonë gjatë shekullit të 19-të dhe shekujt e 20-të.

Skicë e prerjes tëthore të rrugës

### Segmentet e rrugës kryesore për në gjirin e Valdanosit

Rruga kryesore për në gjirin e Valdanosit shtrihet përgjatë pjesës jugore të Ullishtës, midis Bashbylykut, Çivlakut dhe Mendrës, mbi përroin e rrëmujshtëm të gjirit të Valdanosit. Rruga e re e asfaltuar nga Ulqini në gjirin e Valdanosit është ndërtuar në pjesën e sipërme të trasesë, ndërsa **rruga është ruajtur në pjesën e poshtme**, nga hyrja e dikurshme në pushimoren ushtarake deri në gjirin e Valdanosit.

Ky segment i rrugës, si dhe pjesa më e madhe e të tjerëve, që kohëve e fundit u zgjeruan, u shkatërruan segmente të rëndësishme të kalldrëmit dhe nënmureve të tarracave. Megjithatë, në disa vende janë ruajtur mbetje kalldrëmsh.

Në pjesën e poshtme të luginës së Valdanosit janë ruajtur në disa vende **mbetje kalldrëmsh** me gjerësi nga 80 cm deri në 130 cm. Aty, në anën e sipërme të rrugës drejt shpateve të Mendrës, ka nënmure tarracash. Rruga ngjitet pak përgjatë gjithë trasesë, por segmente kalldrëmsh janë ruajtur në zona me pjerrësi më të madhe.





Mbetjet e kalldrëmit në luginën e Valdanosit

Në pjesën e sipërme të rrugës kryesore të ruajtur, në zonën mbi burimin e përroit të rrëmujshëm të Valdanosit dhe pranë hyrjes së ish pushimores ushtarake, rruga kapërcen një diferencë më të madhe lartësie dhe ngjitet në formën e serpentine në qafë. Dhe në atë pjesë ku segmenti i rrugës rrafshohet në izohipsën e terrenit, është ruajtur një segment me kalldrëm, i cili është në pjerrësi, dhe ka shkallë të buta me ndalesa të bëra nga pllaka të ngushta guri. Mbetjet e kalldrëmeve në këtë rrugë kryesore historike për në Gjirin e Valdanosit **duhet të ruhen**.



Fotografia dhe skica e prerjes tërthorë të rrugës me mbetjet e kalldrëmit me shkallë të ulta


### Shtegu i Bashbylykut

Një nga shtigjet që nuk kalon nga pjesa qendrore e Ullishtës, por është shumë e rëndësishme, është shtegu rreth Bashbylykut. Shtegu është makadam dhe Kroi në Bashbylyk përfaqëson tiparin më të rëndësishëm kulturor dhe mjedisor. Përgjatë shtegut do të hasni shkallë të dallueshme, të ndërtuara me gurë më të gjatë se ai që përdorej për të ndërtuar nënmuret e tarracave. Nga njëra anë, kufizohet me mure tarracash, të cilat janë me lartësi të ndryshme, relativisht të larta - nga një deri në tre metra. Rruga është e përdorshme edhe për makina. Ka zona të shënuara ku gurët kufitarë janë rreshtuar në njërin anë të rrugës, ndërsa nënmuret e tarracave (sofat) të shtrira në anën tjetër.

Rrugë karakteristike mund të jetë deri në 310 cm e gjerë. Nga njëra anë gjendet një gur kufiri me gjerësi rreth 25 cm, i cili kufizon shtegun nga tarraca me gjerësi 150 cm, e cila zbret gradualisht poshtë terrenit kodrinor, ndërsa në anën e kundërt ka një mur të thepisur me lartësi rreth 160 cm. Muret e tillë buzë rrugës mund të arrijnë një lartësi prej rreth 310 cm.



Segmente nga shtegu i Bashbylykut



Baza dhe prerja tërthorë e pjesës së shtegut rreth Bashbylykut

### 6.1.6. Shtigjet anësore


Së bashku me rrugët kryesore në Ullishtë, ka një numër të madh të shtigjeve dytësore më të shkurtra, të cilat zakonisht janë tërthore, pingul me izohipsat e terrenit. Këto shtigje ndahen nga rrugët kryesore dhe lidhin pjesë të mëtejshme të ullishtës. Traset e tyre mund të jenë më të rregullta ose më amorfe / pak të dredhuara.

Këto shtigje janë të përcaktuara në të dy anët, të kufizuara nga anët e tarracave, të cilat mund të arrijnë një lartësi prej 120 cm ose më shumë. Gjerësia e shtigjeve ndryshon dhe mund të jetë nga 80 në 130 cm. Edhe këto shtigje mund të jenë me kalldrëm, ndonëse nuk është gjithmonë kështu. Në disa raste, ngjitja që kapërcehet nga këto shtigje zgjidhet në formën e shkallëve të cekëta dhe të gjera.






Shembuj të shtigjeve anësore



Skica të karakteristikave të shtigjeve anësore

Në disa vende këto shtigje anësore shtrihen midis dy rrugëve kryesore gjatësore, dhe në disa raste ato janë vetëm segmente të shkurtra që ofrojnë akses në tarraca. Në shembullin e paraqitur në skicë, aksesit është në formë shkalle, hyrja ka një gjerësi rreth 160 cm dhe ngushtohet në 90 cm. Shkallët arrijnë nga 120-130 cm deri në 180 cm, dhe lartësia e tyre varion nga 15 në 20 cm.




Shembull i aksesit në tarraca

### 6.1.7. Kanalet kulluese

Sistemi i kullimit është një segment shumë i rëndësishëm i peizazheve me tarraca, i rëndësishëm për funksionimin e ullishtave. Edhe pse janë të thata për pjesën më të madhe të vitit, përrrenjtë rrjedhin nëpër to gjatë periudhave të reshjeve të mëdha. Kanalet kulluese që kullojnë ujin nga zonat e sipërme në ato të poshtme shtrihen në të gjithë ullishtën.

Kanalet shtrihen pingul me izohipsën e terrenit dhe me nënmuret e tarracave. Në fakt, ato shpesh përfaqësojnë një vijë ndarëse midis tarracave fqinje. Kanalet e kullimit mund të jenë me mure guri, por në shumë raste nuk janë. Gjithashtu, ka shembuj ku shtigjet e tërthore mund të shërbejnë njëkohësisht si kanale kullimi.



Kanali në periudhën kur ka ujë, afër Kronit të Begut







Kanale që nuk janë të rrethuara me mure



Kanal me mure, Rrugë anësore që mund të shërbejë edhe si kanal kullimi në të njëjtën kohë

Ka mënyra specifike për trajtimin e kalimit të ujit mbi rrugët kryesore gjatësore. Një shembull i tillë mund të gjendet në zonën pranë Kronit të Begut, ku në kalldrëm është krijuar një kanal i vogël kullues, përmes të cilit uji rrjedh drejt zonës në pjesën e poshtme të Ullishtës. Dimensionet e këtij kanali kullues janë 30 cm të gjera dhe 25 cm të thella.



Prerja tëthore e kanalit kullues dhe skica e bazës

Gjatë zgjerimit të rrugës drejt kronit të Vakfit, u zbulua një kanal i vjetër, i cili ndodhet rreth një metër nën sipërfaqen e tokës, i veshur me gurë, me prerje trapezoidale.



Zbulohet kanali i vjetër që shkon nën nivelin e tokës

### 6.1.8. Krojet

Krojet paraqesin segment shumë domethënës të trashëgimisë arkitekturore të Ullishtës. Këto janë ndërtime me tipare të theksuara arkitekturore dhe dekorative që formojnë një pjesë veçanërisht të vlefshme të peizazhit të përgjithshëm kulturor në të cilin ndërthuren trashëgimia arkitekturore dhe natyra.

Kompozicioni i peizazhit kulturor të ullishtës plotësohet me elementet urbane-arkitektonike që paraqet kroi si strukturë arkitektonike dhe peizazhi rrethues i tij si ambient arkitekturor, me elemente të theksuara funksionale, dekorative dhe ambientale.

Se këto ndërtime kishin një rëndësi të veçantë për komunitetin, tregon edhe numri i madh i krojeve që gjendet në komunën e Ulqinit, konkretisht 229 kroje dhe burime. Treguesi bazë që flet për vlerën dhe rëndësinë e krojeve është mënyra e ndërtimit të tyre, forma e tyre, pamja karakteristike, detajet arkitekturore, të cilat i japin krojeve vlera të konsiderueshme estetike dhe arkitekturore. Këto kroje mund të konsiderohen si një trashëgimi arkitekturore që paraqet një segment jashtëzakonisht domethënës të peizazhit kulturor. Përveç kësaj, krojet kanë një komponent jashtëzakonisht të rëndësishëm funksional dhe të dobishëm. Gjithashtu, ato janë të lidhura ngushtë me karakteristikat natyrore të Ullishtës dhe mënyrën e rregullimit të rrjedhës së ujit, dhe ndodhen kryesisht në rrugët e përrrenjve të rrëmuar kryesor.

Kështu, krojet si elemente urbanistike dhe arkitekturore në ullishtën e Ulqinit plotësojnë vlerën e saj të spikatur historike, natyrore dhe kulturore.





Lokacionet e krojeve në kuadër të Ullishtës në Google map

Nga gjithsej 16 kroje, të cilat thuhet në burimet se ekzistojnë në Ullishtë, 11<sup>68</sup> janë identifikuar, dhe ato:

1. Kroni i Doçes
2. Kroni i Thatë
3. Kroni i Begut
4. Kroni i Mustafajt
5. Kroni i Sal Kikes
6. Kroni i Vakfit
7. Kroni i Detarëve
8. Kroni i Bashbylykut
9. Kroni i Gogve
10. Kroni i Buçilit
11. Kroni i Çinarit

Supozohet se Kroni i Çinarit është njësoj si Kroni i Ultimit që përmendet në burime, si dhe Kroni i Doçes është i njëjtë me kronin e Ali Shahut që përmendet në burime. Për Kronin e Zanave, që përmendet në burime, vendndodhja nuk është identifikuar, sepse ndodhet në një pjesë të Ullishtës që aktualisht është e mbuluar me bimësi dhe e paarrtshme.

### **Kroni i Doçes**

Kroni i Doçes ndodhet në pjesën urbane të vendbanimit të quajtur Mëhalla e Re, e cila përbëhet nga ndërtesa të ulëta të banimit, dhe paraqet një lloj hyrje në Ullishtë. Vendndodhja e kronit është në rrugën anësore të mëhallës, ku kryqëzohen rrugët e vendbanimit. Pikërisht në këtë kryqëzim ka një krua që është në përdorim publik dhe një pus rreth 9 metra larg tij që është në përdorim privat familjar.

Në murin më shumë se dy metra të lartë, që shënon zonën e kryqëzimit, është ndërtuar kroni i mëhallës. Një tipar veçanërisht interesant i kronit është njëhësimi i murit të tij me murin që e


rrethon, si një monument që del nga muri. Kroni i Doçes ka elemente të thjeshta arkitekturore. Gjerësia e përgjithshme e kronit është rreth 250 cm, dhe lartësia rreth 202 cm. Kroni karakterizohet nga një kamare e prerë e qemeruar me një hark gjysmërrethor dykatësh dhe një qoshe fundore që del paksa nga rrafshi i murit. Në pjesën qendrore nën kurorën e harkut ka një panel që është i dëmtuar. Lugu përballë shatërvanit është në nivelin e rrugës.

Pusi, i cili ndodhet në rrethinën e afërt dhe është pjesë e kompleksit të kronit, ka vlerë funksionale dhe ambinetale dhe e bën këtë pjesë të vendbanimit, së bashku me kronin, tërheqës. Pusi është i ndërtuar me gurë, rezervuari i brendshëm i ujit është i harkuar, ndërsa qafa/kurora e pusit është rrethore.

Kroni i Doçes është në gjendje të mirë. Elementet strukturore nuk mungojnë. Bie në sy se është suvatuar, ndaj dëmtimi i kësaj fasade është një defekt estetik në paraqitjen arkitekturore të kronit. Kërcënimi për strukturën e kronit është një fik që ndodhet në oborrin sipër tij, pasi siç duket rrënjët e fikut po e dëmtojnë gradualisht strukturën e kronit.



Kroni i Doçes



Vizatimi arkitekturor i Kronit të Doçes (pamja, prerja tërthore dhe baza)





Fotografia dhe prerja tërthore nëpër pus

### Kroni i Thatë

Kroni i Thatë ndodhet përgjatë rrugës në anën e malit, e cila çon në pjesën më të lartë të Ullishtës, nën shpatet e Malit të Bardhë. Ndodhet në pjesën e sipërme të rrugës, brenda një tarrace/sofe të një ullishte. Kroni është i vendosur prapa në raport me vijën rrugore, por perceptohet si pjesë e nënmurit të tarracës. Kroni ka një përbërje të thjeshtë hapësinore. Është punuar me gurë të latuar me përmasa të ndryshme në radhitje të çrregullt, në teknikën e murit të thatë, pa llaç lidhës. Në mes të kronit ka një hapje drejtkëndëshe nëpër të cilën dikur kalonte uji. Tani kroni është jashtë funksionit dhe i lënë pas dore.



Fotografia dhe skica Kroni i Thatë

### Kroni i Begut

Kroni i Begut ose Kroni i Beqir begut nga familja Resulbegu<sup>69</sup> është një nga krojet më reprezentative të Ullishtës. Në vitin 2020, Drejtoria për mbrojtjen e pasurisë kulturore pranoi iniciativën për të mbrojtur Kronin e Begut dhe dy krojet të tjera në Komunë të Ulqinit, përfshirë Kronin e Çinarit, i cili është gjithashtu i vendosur në Ullishtë<sup>70</sup>

Kroni i Begut ndodhet në trasenë e rrugës së vjetër Rruga për Bisht që kalon në pjesën qendrore të Ullishtës. Mund të arrihet nga një pjesë më e shkurtër e kalldrëmuar e shtegut që lidhet me rrugën e asfaltuar. Lokacioni i ngushtë i kronit përfaqëson një njësi ambientale karakteristike të përbërë nga muret me kalldrëm të tarracave të ullishtës në të cilat është ndërtuar kroni, me stola guri pranë kronit; kanal kullues për një rrjedhje më të madhe të ndërprerë uji nga ana perëndi-

69 Çitaku 2022, f. 125

70 Lënda: Iniciativa për vendosjen e mbrojtjes për pasuritë Kroni i Begut, Kroni i Çinarit dhe Kroni Ujk në Ulqin UP/I 02-206/2020 od 06.07.2020.

more e kronit; shtrati nga guri i kronit dhe zona e zbukuruar me kalldrëm përballë tij, si dhe një lloj pellgu i cekët për ujitjen e bagëtive përpara.

“Struktura monumentale përbëhet nga një masë muri, me përmasa 2,70 x 3,0 m dhe një lug në bazën e tij, me zbehtë. 1,7 x 0,75 m. Nga ana e përparme Kroni i Begut është i ndërtuar me blloqe guri të latuar imët me përshtatje të rregullt dhe me fuga të vogla prej llaçi gëlqereje. Është përforcuar me pilastra të ndërtuar me gurë të shtypur. Sfondi i shatërvanit është gjithashtu dukshëm më modest në punimet me gurë. Nisha, e vendosur në qendër, është e harkuar me një hark gjysmërrethor të profilit të cekët me një rreze prej 0,75 m. Janë specifike dy kamare të vogla (dim. 0,25x0,45 m) të renditura në mënyrë simetrike në raport me boshtin e masës së murit, të cilat janë të mbaruara me hark trefësh. Tubi prej guri i kronit nuk është ruajtur dhe në një periudhë të panjohur është zëvendësuar nga një tub me profil të thjeshtë.<sup>71</sup> Në qendër, në pjesën e sipërme të shatërvanit, në një kamare të cekët, gjendet një pllakë me mbishkrim, ndoshta në gjuhën arabe, e cila deri më tani nuk është interpretuar.

Kroni i Begut ka vlera të jashtëzakonshme estetike dhe arkitekturore dhe ana e saj funksionale dhe shpirtërore, e ngulitur në mjedis, krijon një harmoni kompozicionale të ndërtimit dhe natyrës. E gjithë kjo e bën Kronin e Begut të familjes Resulbegu përfaqësues të trashëgimisë arkitekturore mijëvjeçare të Ullishtës së Ulqinit.

Kroni i Begut është paraqet kua me karakteristikat më të spikatura arkitekturore dhe funksionale. Pamja e tij karakteristike dhe elementet dekorative e bëjnë këtë kua tërheqës dhe simbol të të gjitha krojeve të tjera në komunën e Ulqinit. Simetria e saktë dhe mjeshtëria e madhe e ndërtuesve të tij flasin për rëndësinë dhe vlerën që ka pasur ky kua në të kaluarën.

Kroni është në funksion dhe ka ujë periodikisht. Pjesa e sipërme e kronit është shembur dhe në boshtin e tij duket një çarje. Blloqet e gurëve në pjesën e sipërme të kronit janë të paqëndrueshme dhe ekziston rreziku i shembjes së tyre. Gjithashtu është shembur një pjesë e madhe e nënmurit në anën e majtë të kronit. Duke pasur parasysh sa më sipër, do të ishte e nevojshme që të kryeshin ndërhyrje konservuese në kronin dhe rrethinat e tij, por me projektin dhe mbikëqyrjen e ekspertëve të arkitektëve konservatorë.




Kroni i Begut dhe rrethina e tij e afërtë

71 Rezultatet e hulumtimit të pasurisë Kroni i Begut Kroni i Çinarit dhe Kroni Ujk në Ulqin (2020) f. 6





Pllaka guri me mbishkrim të pasinterpretuar



Vizatim arkitektuar i Kronit të Begut (pamje, prerje tërthore dhe baza)

### **Kroni i Mustafajt**

Kroni i Mustafajt ndodhet pranë rrugës kryesore të asfaltuar që të çon nga Ulqini në gjirin e Valadanosit. Ndodhet brenda terraces në pjesën e sipërme të rrugës. Muri mbi të cilin ndodhet kroni është 3,1 m i gjerë dhe është i vendosur 6,2 m nga rruga në formën e një xhepi të thellë, pak trapezoid, që zgjerohet pak drejt rrugës. Terreni përballë kronit është pak i pjerrët, pra është në nivelin e rrugës.

Kroni i Mustafajt është i formës së thjeshtë dhe nuk ka veçori të veçanta arkitektonike dhe estetike. Shihet vija ndarëse ndërmjet strukturës së kronit dhe strukturës së nënmurit, pjesë përbërëse e së cilës është kroni. Nënmuiri fillimisht ishte bërë me mur të thatë, kështu që më pas u suvatua. Pjesa e nënmurit në anën e djathtë ka fuga më të thella, ndërsa në anën e majtë fugat


janë të mbushura plotësisht me suva më të re.

Gjerësia e kronit është 120 cm, dhe lartësia 153 cm. Në pjesën e sipërme është përfunduar me një hark të lehtë, i cili ngrihet pak mbi nivelin e mureve anësore. Përballë kronit ndodhet një lug guri 31 cm i thellë, i cili është ulur në raport me nivelin aktual të tokës.

Gjendja e strukturës së kronit është e mirë, por zona rreth lugut nuk tregon ndonjë mirëmbajtje të veçantë.



Kroni i Mustafajt, lokacioni dhe pamja



Vizatimi arkitektonik i kronit (pamja, seksioni dhe bazamenti) dhe vendndodhja e tij (baza dhe prerja tërthore)

### **Kroni i Sal Kikes**

Në fund të rrugës për në Kepin Bisht në drejtim të Valdanos, në anën e sipërme të rrugës ndodhet Kroni i Sal Kikës. Kroni tani është i vështirë për t'u parë, sepse është i pamirëmbajtur dhe i mbushur plot me bimësi. Vetëm një tabelë me mbishkrim dygjuhësh (në shqip dhe malazeza) tregon ekzistencën e tij. Nëpër vegjetacion dallohen dy blloqe guri të vendosur horizontalisht, mes të cilëve dallohet një zgavër, që tregon se aty dikur ka rrjedhur uji.





Fotografitë e Kronit të Sal Kikës

### Kroni i Vakfit

Kroni i Vakfit ndodhet në trasenë e rrugës historike për në Kepin Bisht, e cila së fundmi është zgjeruar. Kroni ndodhet në pjesën e sipërme të rrugës, në gjendje shumë të keqe. Është mjaft i shembur dhe i mbingarkuar me bimësi. Megjithatë, disa elemente arkitekturore që tregojnë strukturën e tij kompozicionale janë ende të ruajtura dhe të dukshme në Kronin e Vakfit. Është ruajtur këndi i djathtë i kronit, prej guri të latuar dhe të rregulluar imët. Gjithashtu, shihet struktura e një kamareje të zhytur të përfunduar me një hark gjysmërrethor, por është ruajtur vetëm një pllakë guri që ka formuar atë hark, në këndin e poshtëm të djathtë të tij. Në qendër të kronit gjendet një vrimë nga e cila rridhte uji, para së cilës është ruajtur një tub prej guri me konsol. Ky kua i thatë është shënuar me një tabelë në dy gjuhë - shqip dhe malazeze.



Fotografia dhe skica e Kronit të Vakfit



### Kroni i Detarëve

Kroni i Detarëve, i cila quhet ndryshe edhe Primorka ose Borova Çesma, ndodhet në gjirin e Valdanosit, në fund të plazhit, pak metra mbi nivelin e detit. Në të dhënat historike gjejmë informacionin se kronin e ka ndërtuar Boro Gjurashkoviç, ushtrues detyre i oficerit të portit në Valdanos dhe se populli e ka quajtur "Borova Çesma" <sup>72</sup>. Ky emër gjendet edhe në hartën topografike të vitit 1974. Mirëpo, ka shumë mundësi që më parë në këtë vend të ketë pasur një kua.

Kronit i qaset me shkallë, të cilat të çojnë në një pllakë betoni nën kua. Kroni është i një forme të thjeshtë drejtkëndëshe, i bërë me blloqe guri të gdhendura imët dhe të renditura siç duhet.

72 Franetoviç 1960, f.326

Përfundon me një kornizë guri të profilizuar horizontal. Hapja nga dilte uji ka një tub guri me një profil specifik që është ruajtur. Përballë kronit ndodhet një lug i cekët i vendosur në mënyrë asimetrike për ujin, në nivelin e pllato të betonit. Në pjesën e sipërme qendrore të kronit, nën kornizë, gjendet një pllakë prej guri tjetër me mbishkrim cirilik të gdhendur:

"Primorka" ndërtuar nga

Boro Gjurashkoviç


Pilot i atëhershëm 1893

Për shëndet deri sa të jetë gjallë, e pas vdekjes për shpirt

Kroni është mbajtur në gjendje të mirë dhe nga ai herë pas here rrjedh ujë.



Fotografia dhe skica Kroni i Detarëve



Pllokka me mbishkrim

### Kroni i Bashbylykut

Kroni ndodhet në lokalitetin Bashbylykut, në shpatin juglindor të tij përballë detit. Kroni është i rrethuar nga të gjitha anët me ullishtë me tarraca. Një shteg makadami të çon te kroni.

Kroni në Bashbylyk ka veçori të thjeshta arkitekturore. Është ndërtuar në një vend të pjerrët dhe lidhet me nënmuret e tarracave rreth tij. Duket qartë vija ndarëse ndërmjet strukturës së shatërvanit dhe mureve rreth tij, të cilat ndryshojnë në llojin e teknikës së gurit dhe muraturës, si dhe në kohën e ndërtimit. Nën-muri në anën e majtë, perëndimore të kronit është një ndërtim muri të thatë prej guri të lokalitetit, karakteristik për të gjithë zonën e Bashbylykut. Nën-muri në anën e djathtë, lindore është sigurisht më i ri, i punuar me gur gëlqeror të latuar afërsisht në llaç çimentoje. Vetë kroni është ndërtuar me blloqe guri të latuar imët, në llaç gëlqereje.

Kroni në Bashbylyk ka karakteristika arkitekturore shumë të dallueshme dhe të thjeshta. Gjerësia e përgjithshme e shatërvanit është 290 cm, dhe lartësia 180 cm. Brenda formës drejtkëndëshe të kronit gjendet një kamare e cekët e zhytur me një hark të vetëm gjysmërrethor. Konfigurimi arkitektonik hapësinor është simetrik - me dy kamare drejtkëndëshe më të vogla në anët dhe një pllakë me një mbishkrim në mes midis tyre. Në pjatë është shkruar në arabisht "Sahibir hajrat




*Osmanag Manola, tahmin Hasan Lazoja*<sup>73</sup>, përkthyer si "për nder të Osmanag Manola, ndërton Hasan Lazoja" Sipërfaqja e brendshme e kamares të prerë është e mbuluar me bojë të bardhë, ndërsa pllaka me mbishkrimi është e veshur me bojë blu-jeshile. Përballë kronit, në gjerësinë e kamares, ka një lug për ujin.

Është me rëndësi që kroni në Bashbylyk është ruajtur në formën e tij autentike, gjendja e tij është e mirë dhe padyshim është mirëmbajtur.



Fotografitë e Kronit të Bashbylykut




Pamje arkitekturore e kronit të Bashbylykut (baza, prerja tërthore dhe pamja)

### **Kroni i Gogve**

Kroni i familjes Goga ndodhet përgjatë njëres nga dy rrugët kryesore që të çonin nga Ulqini në Ullishtë dhe Valdanos dhe që kalonin rreth kodrës së Meterizit, mbi gjirin e Limanit. Kjo rrugë së fundi u zgjerua pa kujdes dhe me atë rast kroni u mbush kryesisht me dhe. Pra, momentalisht kroni është në gjendje shumë të keqe, sepse është i mbuluar me dhe dhe i tejmbushur me bimësi. Në anën lindore, ngjitur me kronin, ndodhet një mur guri në kënd të drejtë, funksioni i të cilit duhet të hulumtohet.

Kroni është i ndërtuar me gurë të latuar shumë imët, blloqe të rregullta, me llaç gëlqereje, me fuga të ngushta. Pjesa qendrore e kronit përbëhet nga një kamare e cekët e zhytur që është e harkuar me një hark të thyer. Harku i thyer dhe i varur është specifika e këtij kroni. Të gjitha krojet e tjerë në zonën e Ullishtës kanë një hark gjysmërrethor. Brenda sipërfaqes qendrore të kronit gjenden edhe dy kamare më të vogla e më të thella të vendosura në mënyrë asimetrike. Kamarja e sipërme është katërkëndore, dhe ajo e poshtme ka një përfundim trekëndor.

Kroni dhe kompleksi brenda të cilit ndodhet janë shumë interesante, ndaj e gjithë zona duhet pastruar me kujdes, të ruhet nga shembja e mëtejshme dhe të hulumtohet në detaje.



Fotografitë e kronit nga viti 2021. dhe 2023.; Skica e kronit

### **Kroni i Buçilit**

Në të njëjtën pllajë ku ndodhet Kroni i Gogve, gjendet edhe një krua tjetër - Kroni i Buçilit. Ky krua është ndërtuar si pjesë e nënmurit të tarracës që ndodhet në anën lindore të Kronit të Gogve. Kroni është i ndërtuar thjesht, ashtu si edhe nënmuri i tarracës. Ka një lug guri me një hulli përpara. Aktualisht është në gjendje të keqe i mbuluar nga bimësia.

Kroni i Buçilit dhe Gogve janë pjesë e një tërësie ambientale që ka rëndësi kulturore dhe natyrore.






Fotografia e Kronit të Buçilit

### Kroni i Çinarit

Supozohet se Kroni i Çinarit të jetë i njëjti me Kronin e Ultimit të përmendur në burime.

Kroni i Çinarit ndodhet pranë përroit të rrëmbyeshëm që shkon ndërmjet kodrave të Meterizit dhe Gllavicës drejt gjirit të Limanit. Kroni ndodhet përgjatë njëres nga dy rrugët kryesore që të çonin nga Ulqini në Ullishtë dhe Valdanos dhe që kalonin rreth kodrës së Meterizit, mbi gjirin e Limanit. Rruga dhe shatërvani janë paraqitur në hartë nga viti 1718. Kjo vërteton se një krua ka ekzistuar tashmë në këtë vend në fillim të shekullit të 18-të.

Kroni i Çinarit ndodhet në një burim të madh, domethënë në një ujëmbledhës të madh dhe të vjetër. "Sipas kujtimeve të banorëve lokal, në Çinar kishte shumë cisterna ku mblidheshin ujërat e shiut, të cilat u shërbenin banorëve të qytetit në rast të rrethimit të tij. Uji nga Çinari është përdorur në kronin kryesor, të qytetit të vjetër (Kroni Kalasë) që nga viti 1750, jo vetëm gjatë sundimit osman, por edhe shumë më herët, në mesjetë dhe periudhën antike."<sup>74</sup>



Harta nga viti 1718 në të cilën paraqiten kroni (Fontaine); Pjesë e tërësisë ambientale: lugu nga guri, pusi dhe pema e Çinarit.

Mikrotoponimi në të cilin ndodhet kroni quhet Te Çinari. Ajo u krijua me kalimin e kohës për shkak të një peme njëqindveçare të rrapit, e cila ndodhet në atë vend dhe quhet çinar në gjuhën vendase. Perimetri i kësaj peme karakteristike që dominon hapësirën është rreth 7.5

74 Rezultatet e hulumtimit të pasurisë Kroni i Begut, Kroni i Çinarit dhe Kroni Ujk në Ulqin (2020) f.10

metra. Pesëmbëdhjetë metra larg tij ndodhet kroni me emrin e tij. Elementë të tjerë urbanë që përbëjnë këtë tërësi ambientale janë mbetjet e një ure të vjetër guri, një kanal kullimi, një pus dhe një lug guri.

Gjerësia e përgjithshme e kronit është rreth 230 cm, dhe lartësia rreth 204 cm. Elementi kryesor arkitektonik i kronit është një kamare e cekët e harkuar me një hark gjysmërrethor. Në pjesën qendrore ka dy kamare më të vogla dhe më të thella, të pozicionuara njëra mbi tjetrën. Ato i japin kronit një estetikë karakteristike dhe interesante.

Përveç dëmtimeve të dukshme në zonën e sipërme të kronit, gjendja e tij aktuale është e kënaqshme. Megjithatë, ndërhyrjet e fundit brenda kësaj njësie: zgjerimi i papërshtatshëm i rrugës ekzistuese, ndërtimi i një muri të sheshtë guri me llaç çimentoje rreth përroit të rrëmujshëm ekzistues, i cili ka patur linjën natyrore të lëvizjes, kanë dëmtuar shumë vlerat e kësaj njësie mjedisore. Gjithashtu, një kërcënim i drejtpërdrejtë për kronin është rruga e ndërtuar pikërisht pranë tij, e cila mbart rrezik të mundshëm të dëmtimit dhe shkatërrimit gradual të tij.


Në vitin 2020, së bashku me Kronin e Begut edhe Kroni i Çinarit u pranua në kuadër të nismës nga Drejtoria për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore për ta mbrojtur ato si pasuri kulturore.<sup>75</sup>



Fotografite e Kronit të Çinarit

75 Lënda: Iniciativa për vendosjen e mbrojtjes kulturore të Kronit të Begut, Kronit të Çinarit dhe Kroni Ujk UP/I 02-206/2020 datë 06.07.2020.






Inçizimi arkitekturor i kronit të Çinarit (pamja, prerja tëthore dhe baza)

### 6.1.9. Pushimorja ushtarake "Valdanosi" i viteve shtatëdhjetë të shekullit të 20-të

Në fund të gjirit të Valdanosit gjenden mbetjet e pushimores ushtarake "Valdanosi", i cili është i braktisur dhe jo në funksion. Pushimorja ushtarake u krijua në fund të viteve shtatëdhjetë, fillimi i viteve tetëdhjetë të shekullit të 20-të. Në vitin 1977, Sekretariati Federal për Mbrojtjen Kombëtare të RSFJ-së nxori Vendim me interes të përgjithshëm për ndërtimin e objekteve ushtarake në lokacionin "Ullishta e Valdanos", në bazë të të cilit në vitin **1978** u shpronësuan 937.739 m<sup>2</sup> me 17.825 ullinj.

Pushimorja ushtarake mbulonte një sipërfaqe prej rreth **8700 m<sup>2</sup>**. "Pushimorja kishte rreth 150 rimorkio për kamping me tre shtretër, 78 shtëpiza montuese, 29 bungalot me katër shtretër dhe disa vila ekskluzive. Përveç restorantit me një tarracë të madhe dhe pamje nga i gjithë plazhi dhe Kepin Mendra me fënerin, të ftuarit kishin në dispozicion një fushë për futboll, basketboll, volejball, tenis, minigolf dhe një pishinë të vogël për fëmijë".



Kartolinë e vjetër me pamje të Pushimores Ushtarake; Harta e kompleksit të Pushimores Ushatake në tabelën e dëmtuar informative.

Përveç pjesës të vogël që përdorej në funksion të kompleksit të pushimores, pjesa më e madhe e ullishtës, e cila ndodhej në brendësi të këtij kompleksi, nuk është kultivuar që nga shpronësimi në vitin 1978.

Pushimorja ushtarak pushoi së ekzistuari në maj 2008. Pas iniciativave të popullsisë lokale, në vitin 2021, Kuvendi i Malit të Zi miratoi Ligjin për eliminimin e pasojave të konfiskimit të pronës në Gjirin e Valdanos (Fletorja Zyrtare e Malit të Zi, nr. 68), në bazë të cilit toka iu kthye pronarëve të vjetër, të cilët më pas filluan punën për rivitalizimin e ullishteve.

Gjatë procesit të hartimit të këtij Studimi, nuk mundëm të merrnim informacion të saktë për projektin dhe ndërtimin e Pushimores Ushtarake. Supozohet se projekti për nevojat e Ushtrisë së RSFJ-së është krijuar pas vitit 1978 dhe se punimet kanë përfunduar në vitin 1981. Në kuadër të kompleksit, në zonën me objekte qendrore, është vendosur pllaka me mbishkrimin "Lavçeviq



1981". Ajo tregon se punët me siguri i ka kryer *Ndërmarrja për ndërtim, turizëm dhe hoteleri "Ivan Luçiq Lavçević"* nga Spliti, e cila është formuar në vitin 1948, ndërsa në vitin 1982 për nevojat e ish-APJ-së ka ndërtuar edhe kompleksin hotelierik "Zagrebi".



Recepioni i kompleksit; Kuzhina e përbashkët në kuadër të auto kampit



Shtëpizat montuese të integruara në ullishtë; tabela me emrin e kontraktorit të punëve

Edhe pse është ndërtuar përmes një procesi problematik të shpronësimit të tokës dhe në zonën e ullishtës, Pushimorja Ushtarake nga pikëpamja arkitektonike dhe urbanistike është një shembull i suksesshëm i përshtatjes së një kompleksi turistik në mjedisin natyror, nëpërmjet konceptit të përmbajtje të shpërndara, hapësira të mëdha të hapura dhe ndërtesa me volum minimal dhe formë të qartë. Arkitektura e fundit të viteve shtatëdhjetë të shekullit të 20-të është funksionale dhe e reduktuar. E gjithë kjo përfaqëson cilësi që duhet të jenë model gjatë projektimit të komplekseve turistike. Ky kompleks duhet patjetër të hulumtohet më hollësisht, të gjendet projekti dhe të propozohen segmente që duhet të ruhen si shembull i arkitekturës së shekullit të 20-të.

#### 6.1.10. Karantini (lazareti) i rrënuar, ndërtesa e doganës dhe portit

Në gjirin e Valdanosit, pranë vetë plazhit, në mes të tij, në vendin ku derdhej rrjedha e rrëmbeshme në det, ndodhej një ndërtesë që nga burimet historike dimë se ka qenë lazaret/karantinë në periudhën turke.

"Në fund të gjirit, dhe në mes të bregdetit, tani ka **mbetjet e mureve të ish-karantinës turke**. Turqit i mbajtën në karantinë në Valdanos anijet e infektuara ulqinake dhe anijet e infektuara qëvinin në Ulqin dhe Tivar. Objekti i përmendur është ndërtuar për këtë qëllim."<sup>76</sup>


"Turqit kishin, me sa duket, për territorin e tyre, vetëm **lazaret** në Valdanos"<sup>77</sup>

76 Franetoviq 1960, f. 324  
77 Milosheviq 2008, f. 290

Në periudhën pas kësaj, ndërtesa u përdor si doganë dhe si godinë portuale ku banonte ushtruesi i detyrës së oficerit të portit. Në hartat e viteve 1878 dhe 1883, një ndërtesë në gji është shënuar si **Dogana**, që është **dogana** në italisht. Në hartën e vitit 1903, objekti është shënuar si **Sanitat**.

"Për të monitoruar anijet e ankoruara, sidomos kur shfaqeshin sëmundjet infektive, ishte gjithmonë një zyrtar që vepronte si oficer porti. Ai jetonte në një shtëpi që ndodhej në mes të plazhit"<sup>78</sup>.

"Kur vapori i Loyd-it hyri natën në gjirin e Valdanosit, në dritaren e mesit të katit të parë të godinës së portit, e cili ndodhej në mes të bregdetit, u shfaq një fener i kuq, me qëllim të rrafshimit avullor-en gjatë ankorimit."<sup>79</sup>




Objekt shënuar në hartat nga viti 1883 dhe 1903

Ndërtesa ka ekzistuar edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, por ka qenë në gjendje të rrënuar, pa çati, siç shihet në një fotografi ajrore të vitit 1942. Ndërtesa shfaqet edhe në hartën topografike të vitit 1983 dhe me sa duket është rrënuar pas kësaj.

78 Franetoviq 1960, f. 121  
79 Franetoviq 1960, f. 398





Detaje e një fotografie ajrore të vitit 1942 që tregon objektin, burimi: L'Istituto geografico militare (IGM) Firenze – Italia Regia Aeronautica

### 6.1.11. Porti / mandraqi

Në pjesën juglindore të gjirit Valdanos, pranë vetë plazhit, ka një port të vogël, për ankorim të anijeve dhe strehë për varkat - Mandraqi. Një port në këtë pjesë të gjirit përmendet në burimet historike të shekullit të 19-të, por supozohet se në atë vend ka ekzistuar edhe më herët. Është gjithashtu i dukshëm në fotografitë ajrore të vitit 1942.

*“Në cepin juglindor të gjirit ndodhej një port ku ishte ankoruar skafi i Autoritetit Portual, me të cilin nëpunësi i portit mbikëqyrte dokumentet e anijeve në ankorim.”<sup>80</sup>*

Ky mandraq përdoret edhe sot nga peshkatarët ulqinak, kurse pontoni për not.



Mandraq, 2023.

80 Franetoviq 1960, f.121

### 6.1.12. Mbetjet e kishës në gjirin e Valdanosit

Në gjirin e Valdanosit, në Kepin Mendra, në gjysmë të rrugës midis plazhit dhe fënerit, përgjatë bregut, gjenden mbetjet e një kishë të vogël. *“Në një kep të vogël, në anën jugore të gjirit, në mes të pjesës së gjirit ku ankorohen zakonisht anijet, gjenden mbetjet e një kishë të vogël, 5,5 m larg detit. Njerëzit thonë se kjo kishë është ndërtuar nga grekët në kohët e lashta.”<sup>81</sup>*

*“Në Valdanos ka mbetje kishash dhe objektesh të tjera që shqiptarët i quajnë Dit-kisha, pra gjiri i kishës, midis tij dhe Ulqinit dhe në vende të tjera në rrethinën e tij. Por të gjitha këto janë vetëm themelet e ndërtesave dhe për më tepër me përmasa mjaft të parëndësishme.”<sup>82</sup>*

Në hartat e vjetra të identifikuar, kjo kishë nuk është e shënuar.

Në Studimin për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore thuhet se lokaliteti njihet me emrin “crkvica (kishë-za)” dhe jepet përshkrimi i gjendjes: *Muri jugor i kishës është i ruajtur në gjatësi rreth 4 m, lartësi rreth 1.2 m, ndërsa mbetjet e absidës dhe të murit verior janë të fshehura, të mbuluar me bimë të dendur.*<sup>83</sup>



Mbetjet e murit të kishës, burimi: Studimi i mbrojtjes së pasurive kulturore për qëllime të përgatitjes së PHU-së së komunës së Ulqinit

### 6.1.13. Fëneri në Kepin e Mendrës

Në Kepin Mendra ekziston fëneri që është ende në funksion. Kompleksi përbëhet nga një far tetëkëndësh i lidhur me shtëpinë e rojtarit të fënerit dhe një ndërtesë ndihmëse. Fëneri ekzistues është ndërtuar në vitin 1886, por ka informacione se në atë vend ka pasur një far që nga periudha turke: *“Në Kepin e Mendrës, në anën jugore të hyrjes së portit, që nga koha turke, kishte një far të vogël. Në kep ishte fëneri i vogël dhe shtëpiza për rojtarin e dritës. Mali i Zi e kishte riparuar këtë dritë dhe e kishte mbajtur në gjendje të mirë.”<sup>84</sup>*

Në pjesën në hyrje, që lidh fënerin me shtëpinë e fënerit, gjendet një tabelë me një mbishkrim që vërteton se fëneri ekzistues është ngritur në vitin 1886: *“Për të shënuar njëqindvjetorin e fënerit të Mendrës / kjo tabelë është vendosur në vitin 1986 nga Plovput”*



Fotografitë e fënerit, 2023.

81 Franetoviq 1960, f. 326

82 Rovinski 1994, f. 479

83 Studimi i mbrojtjes së pasurive kulturore përgatitur për nevojat e hartimit të Planit Hapësinor-Urbanistik të Komunës së Ulqinit, 2016

84 Franetoviq 1960, f. 327



Në Glas Crnogorca, si njoftim, marinarëve iu dha lajmi se më 25 maj 1886, në hyrjen jugore të "lìmanit Valdinoqa", në Kepin e Mendrës, u ngrit një "fëner" i përkohshëm - fëneri, "për të treguar anijet që hynin në atë port". Fëneri është vendosur 147 m larg nga deti, dhe mbi një direk 10 m të lartë, drita natyrale e të cilit mund të shihet në një distancë prej 5 miljesh. Edhe atëherë ishte planifikuar të zëvendësohej shpejt me një tjetër, "me xham të lyer me dritë të kuqe", gjë që u bë më 24 nëntor 1886, e cila mund të shihet në 6 milje.<sup>85</sup>



Ekstrakt nga Glas Crnogorca, 1886.

Në hartën e vitit 1878, fëneri u vizatua, por më pas në të kuqe dhe të verdhë, si të gjithë farët e tjerë në të njëjtën hartë. Harta e vitit 1883 tregon rrënojat e ndërtesës, ndërsa harta e vitit 1903 tregon fënerin.



Hartat nga viti 1878.. dhe 1903.

85 Glas Crnogorca 22, 3. qershor 1886. dhe Glas Crnogorca 23, 10. qershor 1886.

## 6.2. Trashëgimia kulturore jomateriale

### 6.2.1. Ullishtaria në traditën ulqinake

Qyteti më jugor i bregetiti të Malit të Zi është Ulqini. Duke pasë klimë shumë të volitshme dhe mbi 218 ditë<sup>86</sup> me diell ka bërë që këtu të jenë të suksesshme shumë kultura bimore. Përveç kësaj, Ulqini si një ndër qytetet më të vjetra të bazenit të Detit Adriatik ofron një begati të madhe të trashëgimisë kulturo-historike si të asaj materiale ashtu edhe asaj jomateriale. Gjurmët më të vjetra të jetës në Kalanë e Ulqinit çojnë deri në periudhën e neolitit e këtë e vërteton gjetja e figurinës *Magna mater*<sup>87</sup> që i takon kësaj periudhe kohore kurse e vërtetojnë edhe gjetjet e *çekiçit të gurit*<sup>88</sup> nga fshati Krythë andaj mund të pajtohem se kemi të bëjmë me gjurmë që nga koha parailire<sup>89</sup> dhe se këto gjetje, Ulqinin, e vendosin në hartën e ashtuquajtur neoliti i Adriatikut.

Banorët e Ulqinit përveç detarisë dhe shfrytëzimit të të mirave që ofron deti janë marrë edhe me aktivitete tjera që kanë të bëjnë me tokën. Në Ulqin është një shprehje e cila thotë: *Nëse don me ja pa hajrin pareve të ndenjura, blej ullishtë*.<sup>90</sup> Pra, investimi në ullishtë gjithmonë ka nënkuptuar fitesë të sigurtë andaj edhe ulliri është pema që më së shumti gjendet në Ulqin.

Plantacioni më i madhi dhe më i njohuri është ai që ndodhet mes Malit të Bardhë, Mavrianit dhe detit. Kështu prej Ullishtës së Ali Shahit, e cila ndodhet në fillim të Mëhallës së Re, e deri te Kroni i Zanave në një distancë prej 7km gjenden afro 80000 rrënjë ullinj vjetërsie të ndryshme duke filluar prej atij me mesataren 1892 vjeç (ndodhet në Bisht)<sup>91</sup> e deri në ata që janë disa qindra vjet të vjetër. Në pjesën e Krruçit, Salçit dhe Braticës gjenden afro 10000 rrënj ullinj po të të njëjtës moshë.<sup>92</sup>

Ulliri është pemë e bekuar. Së bashku me fikun përmenden edhe në librat e shenjta: Bibël dhe Kur'an.<sup>93</sup> Në Bibël përmendet shumë herë kurse në Kur'an përmes sures 95:1 "Pasha fikun e ullirin".<sup>94</sup> Babai i mjeksisë Hipokrati vajin e ullirit e preferon si ilaç për më shumë se 60 sëmundje<sup>95</sup> kurse mjeksia moderne njih veçoritë e veprimit antibiotik me anë të të cilit 126 mikroorganizma patologjik nuk mundën me i ba ballë kombinimeve me ekstraktin nga gjethi i ullirit andaj edhe është lista shumë e gjatë e sëmundjeve që mundën me u shëru me këto preparate madje për disa sish ka edhe fakte të forta shkencore.<sup>96</sup>

Ripi bregdetar prej Budvës e deri në Ulqin ka ullishtën më të vjetër në Mal të Zi. Kur e themi këtë e vërtetojmë edhe me vjetërsinë e ullinjve më të vjetër të këtij rajoni siç janë: Ulliri në Mirovicë (Tivar) 2245 vjet<sup>97</sup>, ulliri në Valdanos (Ulqin) 1892 vjet<sup>98</sup>, ulliri në Ivanoviq (Budvë) afro 2000 vjet<sup>99</sup>. Duke mos pasur metodë të saktë për përcaktimin e vjetërsisë dhe duke u bazuar në moshën mesatare vijmë në përfundim se këta munden me qenë edhe më të vjetër se mosha që u nënshkruhet. Por, kohës së fundit, sipas një studimi të bërë në vitin 2015 nga ana e Universitetit të Pyltarisë nga Stambolli, ku marrin pesëdhjetë kampione nga trungjet e vjetra të ullinjve (25 në Ulqin dhe 25 në Tivar) konstatojmë se në Ulqin kemi dy ullinj shumë të vjetër: mosha mesatare e njërit shkon 1892 vjet dhe ndodhet në Valdanos (1450-2250), si dhe një tjetër i vjetër në Krruç që mosha mesatare i shkon 1713 vjet (1519-2035 vjet) dhe është pronë e Gjevana Vukmarkoviqit.

86 [https://sq.wikipedia.org/wiki/Komuna\\_e\\_Ulqinit](https://sq.wikipedia.org/wiki/Komuna_e_Ulqinit)  
 87 Pavle Mijović, *Umjetničko blago Crne Gore, Jugoslovenska revija, Beograd 1980, fq. 27.*  
 88 Banesa Popullore e Anës së Malit, Ulqin, 2016, fq. 24  
 89 Aleksandar Stipčević, *Ilirët, Rilindja, Prishtinë 1990, fq. 430.*  
 90 Dr Bahri Brisku, *Ullishtaria dhe mullinjëtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, Botim II, Asociacioni Ulqini, Ulqin 2016, fq.20.*  
 91 Gazmend Çitaku, *Busulla e artë, Diti&Oli, Ulqin 2022, fq. 124.* (hulumtimi është bërë në vitin 2015)  
 92 Dr Bahri Brisku, *Ullishtaria dhe mullinjëtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, Botim i dytë, Asociacioni Ulqini, Ulqin 2016, fq.7.*  
 93 Sami Mishërri, *Pasha fikun e ullinin, BKSHMZ, Ulqin 2017, fq.21*  
 94 Po aty, 21.  
 95 Po aty, fq. 21  
 96 Miranoviq, 2021, f. 5  
 97 Maslinada, nr.1, *Časopis za maslinarstvo i kulturu života s maslinom, Društvo maslinara Bar, Bar 2021. fq. 5.*  
 98 Gazmend Çitaku, *Busulla e artë, Diti&Oli, Ulqin 2022, fq. 124.*  
 99 <https://budva.travel/attraction/2> (konsultuar më 10.10.2023)



Trungje të ullinjve të vjetër kanë edhe Edin Buzuku 1314 vjet, Agim Dragovoja 1291, Xhaudet Cakuli 942 etj.<sup>100</sup> Pra, *Ullishta e Ulqinit* qenka shumë e vjetër. Meqë këto troje kanë qenë të banuara me fiset ilire atëherë logjikisht i bie se, popullsia lokale, pra, **ilirët janë të parët që i sollën, i mbollën, i punuan dhe u kujdesën për këto fruta të bekuara duke filluar që nga shek.V p.e.re.**<sup>101</sup> Shumica e këtyre trungjeve të ullinjve janë **kazana**<sup>102</sup> (tre e më shumë trungje në një rrënjë) të **llojit të verdhë (zhutica)**.

Në përtrirjen e ullishtës dhe shtimin e numrit të trungjeve të ullinjve kanë marrë pjesë edhe pushtuesit e ndryshëm të këtyre territoreve duke filluar nga romakët, venedikasit, osmanët dhe deri në ditët e sotme. Një varietete tjetër karakteristike për Ulqinin janë ullinjtë që vendasit i quajnë **shatorra** e të cilët kanë një kurorë të bukur në formë dardhe dhe lartësi 4-5m. Kjo varietete i nënshkruhet vendikasve të cilët kanë sunduar Ulqinin në periudha të ndryshme kohore por më së gjati dhe pa ndërprerje nga viti 1421-1571.<sup>103</sup>

Edhe gjatë periudhës së sundimit osman (1571-1880) kujdes i veçantë është kushtuar kultivimit të ullirit dhe në këtë periudhë me siguri e bartur si traditë nga më heret thuhet se: *nëse një djalë ka dashtë me u martu, ka qenë i obliguar të mbjellë një bylyk me ullinj*. Kjo edhe mund të mos qëndrojë si e vërtetë mirëpo vetë fakti se sot kemi një numër të konsiderueshëm të ullinjve me një diapazon vjetërsie duke filluar prej disa mijëra e deri në disa qindra vjet të jep një bindje të fortë se duhet të ketë qenë e vërtetë.

Sipas madhësisë dallojmë këto lloje trungjesh: kazana, fishkulla, shatorra. Kurse sipas prejardhjes dhe llojit të frutit: ullastra, të verdhë, italian, vlonjat, frank dhe të egjër.

### 6.2.2. Praktikrat në mbjelljen dhe mirëmbajtjen e ullinit

**Mbjellja e ullinjve** bëhet me ndarjen e filizave të rinj nga trungjet e kazanave. Këto filiza që priteshin ishin të një madhësie deri në 2,5m. Ata mbilleshin në gropa të thella 80cm dhe të gjëra deri 1m. Shpesh janë përdorë edhe degë të vjetra të ullirit të cilat era apo ndonjë aksident i ka thyer. Ato përgatiteshin me latushë para se të futeshin në gropë. Mbjellja bëhet gjatë vjeshtes ose në fillim të pranverës gjer në gjysmën e marsit gjithmonë duke pasur kujdes që hëna të jetë e plotë. Kur hëna është e re besohet se nuk zënë rrënjët.

Nëse dikush dëshiron të formojë një bylyk të ri ai së pari i formon sofat, çon muret e thata dhe pastaj në distanca prej 5m hap gropat ku duhet me i mbjell ullinjtë. Brenda gropave të hapura vendosen 3-4 gurë në mënyrë që verës të mbajnë rrënjët freskët si dhe fidani të marrë kahje të drejtë.<sup>104</sup>

Ullinjtë që nuk prodhonin rregullisht, ullishtarët e vyeshëm i **shartonin**. Shartimi bëhet në dy mënyra: në trung ose në bulë. **Shartimi në trung** është metodë më e vjetër dhe praktikohet më shpesh kryesisht në muajin mars. **Shartimi në bulë** është proces më preciz andaj këtë lloj e praktikojnë vetëm ata që e konsideronin veten ekspertë dhe kryhet në muajin maj<sup>105</sup>

Shpesh gjatë mbjelljes pronarët e ri pranë rrënjëve të ullirit kanë vendosur gjëra të vlefshme e më së shpeshti monedha të kohës. Kjo është përcjellur me një ceremoni gjatë së cilës në formë rituali pronari e fal ullirin në mënyrë që ai t'ia kthej me frute në të ardhmen. Kohë më parë, gjatë periudhës së Covid-it në vitin 2021 H.Ç., pasi që kishte vendosur t'i mifë vetë ullinjtë, ai në shtatë rrënjë të ndryshme kishte gjetur shtatë monedha prej të cilave dy janë identifikuar si **"2 solda"** të periudhës veneciane çka përafërsisht edhe mund të hamendësojmë vjetërsinë e atyre dy rrënjëve, e që shkon në shek.XV. **Pra, ajo që të parët tanë thonin se gjatë mbjelljes kanë lënë gjëra të vlefshme kjo edhe qëndron sepse është vërtetuar me gjetjet e viti 2021.**

100 Gazmend Çitaku, Busulla e artë, Diti&Oli, Ulqin 2022, fq. 124-125.

101 Dr Bahri Brisku, Ullishtaria dhe mullinjtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, Botim i dytë, Asociacioni Ulqini, Ulqin 2016, fq.10

102 Kazan/i m., *ullishtari*, lloj trungu ulliri i cili përbëhet prej dy ose më shumë trungjeve.

103 Dr Bahri Brisku, Ullishtaria dhe mullinjtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, Botim i dytë, Asociacioni Ulqini, Ulqin 2016, fq.10.

104 Dr Bahri Brisku, Ullishtaria dhe mullinjtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, Botim i dytë, Asociacioni Ulqini, Ulqin 2016, fq.27.

105 Po aty, fq. 30.



Paratë e periudhës veneziane të gjetura në ullishtën e H. Ç. Në vitin 2021.

Deri para disa vitesh ulqinakët kanë pasë edhe një zakon që ka qenë i lidhur me bestytini magjike. Për të pasë një prodhim më të madh ullishta, ulqinakët, në ditën e Shëngjergjit shkonin në ullishtë pa lindur dielli. Me vete ata merrnin nga një kaçile (shportë) me petulla dhe një sëpatë. Kur mbrinin në bylyk shkonin pranë çdo trungu ulliri e sidomos pranë atyre që nuk kishin kokrra. Ndaleshin para tyre dhe bënin një ritual që kishte këtë ecuri: Më i riu çonte sëpatën me qëllim që ta presë ullirin dhe pyeste **"A ta pres"**?, kurse tjetri i përgjigjej **"Mos e prej se vjetes tjetër ka me ba kokrra. Lene edhe simjet"**. Pastaj e vendosnin nga një petull pranë trungut duke thënë: "Hajt me bereqet të ri Shën Gjergjit tjetër".<sup>106</sup>

### 6.2.3. Pronësia e Ullishtës

Ata të cilët kishin ullishtë zakonisht konsideroheshin njerëz të pasur. Shpesh bylyqet nuk i kishin në të njëjtin vend por të shpërndara në vende të ndryshme të ullishtës. Bylyqe të mëdha konsideroheshin ato që kishin mbi 100 rrënjë ullinj. Kishte pronarë që kishin edhe deri në 10 bylyqe e më shumë. Të njohura ishin ullishta e Ali Pashë Kasmit 2000 rrënjë ullinj<sup>107</sup>, pastaj deri në 1000 rrënjë ishin ullishtat e: Ali Shahit, Gjergj Gjylit, Salë Ficit, Can Briskut, Pjetrushit i Jakut, Beqir Pasha, Jonuz Milla, Duli i Haxhimollës, Nuti i Adem Manit, Erif Bilali, Mulla Beqiri dhe Lito Begu.<sup>108</sup>

Përveç ullishtes private, bylyqe ullinjsh kanë pasur edhe Vakfi, Kooperativa bujqësore, xhamiat, kisha katolike dhe ajo ortodokse. Vakfi kishte rreth 2000 rrënjë ullinj, kooperativa bujqësore 4500 rrënjë, gjashtë xhami nga 80-150 rrënjë, kurse tri kisha (dy katolike dhe një ortodokse) gjithsej kanë 260 rrënjë ullinj.<sup>109</sup>

Pronën e Vakfit e kanë themeluar dy motra nga Kalaja. Këto dy jetime kanë pasë në trashëgim 1000 rrënjë ullinj e të cilat meqë kishin mbetur pa u martuar ato ullishtën e vet ia dhurojnë xhamisë si Vakëf, me dedikim që një pjesë e fitesës nga kjo ullishtë të drejtohet në ndihmë vajzave të varfra dhe jetime për kompletimin e pajës, pastaj për varrosjen e personave "të shkretë", mirëmbajtjen e xhamive etj.<sup>110</sup>

106 Po aty, fq. 63,

107 Bahri Brisku, Gjurmë shqiptare, Labia, Tiranë 1994, fq. 51.

108 Po aty, fq. 51.

109 Dr Bahri Brisku, Ullishtaria dhe mullinjtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, Botim i dytë, Asociacioni Ulqini, Ulqin 2016, fq.22-23.

110 Po aty, fq. 23.



### Disa mikrotoponime të Ullishtës

Ullishta zakonisht është identifikuar përmes bylyqeve të pronarëve andaj edhe dallojmë këto toponime nga ullishta: **Limani, Mëhalla e Re, Ana e Malit (nën Malin e Bardhë), Bashbylyku, Ke të Cankës, Lugu i Xhemiles, Dheu i Kuq, Kodra e Qershis, Kasolla e karrxhive, Luk Çalyqe, Mendra, Hija e Mendres, Kroni i Thatë, Kroni i Begut, Qafa, Bishti, Valdanoi, Rruga kryq, Mavriani, Kodra e Zyfit, Kroni i Vakfit, Ullishta e Ali Shahit, Ullinjt e Begut, Ullinjt e Pashës, Bylyku i Pjetrushit Mrikes, Haxhi Mollës, Mollabeqirit, Vakfit, Efendisë, Shaletës, Marë Zenjines, Kroni i Detarve, Kroni i Sal Kikes, Faqja e shullanit, Rrafshi i Sutës etj.**<sup>111</sup>

### Krojet në Ullishtë

Në të kaluarën rrugët që kalonin nëpër Ullishtë kanë qenë pothuajse gjatë gjithë trases të kall-dramuara dhe në distanca respektive ekzistonin kroje të ndryshme të cilat ulqinakët e pasur i kishin ndërtuar si e mirë publike – **vakyf**. Ulqinakët e pasur kanë pasë zakon që të ndajnë mjete për kall-dramimin e rrugëve, ndërtimin e krojeve si në qytet ashtu edhe në ullishtë. Por, ulqinakët kanë ndarë mjete edhe për ndërtimin e të mirave tjera kolektive në mënyrë që emri i tyre të kujtohet edhe pas vdekjes. Ulqinakët këtij veprimi i kanë thënë **hajrat** por edhe **vakëf**. Kështu përmes kësaj bamirësie në Ulqin e rrethinë dikur kanë ekzistuar 229 kroje<sup>112</sup>, kurse vetëm në ullishtën e Ulqinit 16 kroje<sup>113</sup> të mëdha e të vogla. Në ullishtë sot mund të identifikohen vetëm 11 kroje prej të cilëve vetëm disa janë në funksion: **Kroni i Doçes, Kroni i Thatë, Kroni i Begut, Kroni i Mustafajt, Kroni i Sal Kikes, Kroni i Vakfit, Kroni i Zanave, Kroni i Detarëve, Kroni i Bashbylykut, Kroni i Çinarit, Kroni i Buçilit, Kroni i Ultimit.**<sup>114</sup>

### 6.2.4. Puna në Ullishtë

Puna në ullishtë nuk është punë e lehtë, ajo kërkon angazhim gjatë gjithë vitit. Përveç mbledhjes së ullinjve për bluarje ose regjie ullinjtë së paku një herë në vit duhet mihur rreth e rrotull trungut të ullirit, afër rrënjëve si dhe duhet plehrosur. Ullinjtë kanë nevojë të pastrohen nga bari dhe fieri, nga degët e thata, e gjithashtu duhet rralluar edhe nga mjollat e reja. Së paku një herë në tri vjet duhet krastitur prandaj edhe ulqinakët për të gjitha punët rreth ullishtarisë kanë një thënie e cila thotë: "Ullini e ullishta, me të ra karrabishtja".<sup>115</sup>

Siç u tha më lartë, pa marrë parasysh se a ka fryte a jo, për çdo vit ullishta duhet pastruar nga bimët tjera invazive. Këtë proces të pastrimit në Ulqin e quajnë **shkallitje**<sup>116</sup> dhe këtë proces ulqinakët e kanë konsideruar si një punë të vështirë prandaj edhe kanë një thënie: "Para shkallitet, e mas teje rritet".<sup>117</sup> Për me qenë një bylyk<sup>118</sup> në gjendje të mirë duhet që në fillim të verës të shkallitet dhe të menjanohet e gjithë bimësia, pastaj të shkallitet përsëri në fillim të vjeshtës në mënyrë që sofat<sup>119</sup> të jenë të gatëshme për mbledhjen e ullinjve. Procesi i shkallitjes bëhet përmes këtyre veglave: kmesa<sup>120</sup>, capa<sup>121</sup>, shati, rreshqeli<sup>122</sup>, fturku, dikella<sup>123</sup> dhe sopata

111 Maksut Haxhibrahimi, Toponomia e Ulqinit dhe rrethinës, Ulqini, Ulqin 2001, fq.45-46.

112 Gazmend Çitaku, Busulla e artë, Diti&Oli, Ulqin 2022, fq. 119.

113 Po aty, fq. 119.

114 Gazmend Çitaku, Busulla e artë, Diti&Oli, Ulqin 2022, fq. 130.

115 Sami Mishherri, Pasha fikun e ullinin, BKSHMZ, Ulqin 2017, fq.26

116 Shkallitje, -a, f., me këtë proces nënkuptojmë pastrimin e bylyqeve të ullinjve nga bimësia e parëndësishme.

117 Sami Mishherri, Pasha fikun e ullinin, BKSHMZ, Ulqin 2017, fq.27

118 Bylyk, -u m., një bylyk ullinj – një pronë, një kompleks toke i mbjellë me ullinj.

119 Sof/ë, -a f., 1. rrip toke në ullishtë; majere; brezare

120 Kmes/ë, -a f., lloj kize me bisht të gjatë; përdoret për të shkallitur, për të prerë degë, për të prerë ferra.

121 Cap/ë, -a f. Kazmë.

122 Rreshqel -i m. Grabujë

123 Dikell/ë -a f. Kazmë me dy dhëmbë, shërben për mihje me qëllim që të mos lëndoj rrënjët e ullirit.

### Krastitja

Krastitja zakonisht bëhet prej janarit deri në fund të marsit gjegjësisht pas vjeljes së fruteve. Edhe pse një pronar ka pasë shumë bylyqe me trungje ulliri ai prapë se prapë ka angazhu krastaçin për krastitje. Deri vonë ullinjtë e Ulqinit janë prerë vetëm poshtë duke mos e prekur kurorën kështu që ullinjtë janë rritur shumë duke shkuar në lartësi të mëdha duke mos u dhënë mundësi pronarëve t'i mbledhin nga poshtë. Për krastitjen e ullinjve krastaçi përdorë tri lloje të sëpatave: të vogël, të mesme dhe të rëndë. Sëpata e vogël është përdorë për menjanimin e degëve të vogla dhe filizave. Sëpata e mesme ka shërby për krastitje dhe ka qenë e tillë që krastaçi të mundet të punojë me te me një dorë sepse kur është ngjitur në ulli është dashtë me u mbajt me një dorë. Sëpata e madhe ka qenë e rëndë dhe me te është punuar me të dy duart dhe ka shërbyer për t'i prerë trungjet e mëdha. Gjatë procesit të krastitjes pronari nuk ka qenë prezent sepse atij i është dhimbsur prerja e degëve. Për këtë proces ulqinakët kanë shprehjen: "Shtjer armikun me ta pre fikun, fiku e ullini janë vëllëzër".<sup>124</sup>

Krastitja është procesi i prerjes së degëve të tepërta, atyre që marrin formë të parregullt si dhe atyre të thata. Zakonisht këtë punë e ka bërë **krastaçi**<sup>125</sup>

Gjatë krastitjes, përveç sëpatës (sakicës) përdoret edhe kosë (kmesa), e rrallë herë edhe sharra. Një mjet interesant për pastrimin e ullinjve nga degëzat është **ganxamari**.<sup>126</sup> Ka formën e një drapëri, vetëm me një dorezë shumë të gjatë që arrin deri në 6 metra. Para fillimit të krastitjes, pronari i ullishtës konsultohet me **stimaçin**,<sup>127</sup> detyrë e të cilit është të bëjë vlerësimin se sa dru mund të dalin nga krastitja. Gjithashtu sitmaçi i mirë ka ditë të vlerësojë se sa kuintal ullinj mund të dalin nga një bylyk.

Deri në vitin 1935 ullishta është krastitur duke ia prerë degët poshtë mirëpo me rastin e vizitës së një delegacioni ekspertësh nga Dalmacia dhe Italia sipas propozimeve të tyre krastitja që nga ajo kohë ka filluar të bëhet duke prerë degët e larta në mënyrë që kurora të vijë në formë të konit. Kështu sot dallojmë tri lloje krastitjesh: të rëndë, të mesme dhe dlijrje nga krundet. Krastitja e rëndë nënkupton prerjen e së paku gjysmës së degëve kurse gjysmën tjetër pas 3-4 vitesh. Krastitja e mesme bëhet kur ullinjtë janë të shëndoshë dhe japin rendimente të shumta kurse dlijrja e degëve bëhet çdo vit duke hequr filizat e tepërt.<sup>128</sup>

124 Sami Mishherri, Pasha fikun e ullinin, BKSHMZ, Ulqin 2017, fq.34.

125 Krastaç -i m., Njeri i cili bën krastitjen

126 Ganxhamar. -i m., (ganxhamar), në ullishtari - lloj drapëri me dorezë të gjatë; përdoret për pastrimin e ferrave, prerjen e degëve etj.

127 Stimaç, -i m., (stimaç) njeri që dinte të vlerësonte se sa dru do të binte pas krastitjes së ullinjve, dinte të vlerësonte edhe sa fruta ulliri do të jepni ullinjt.

128 Dr Bahri Brisku, Ullishtaria dhe mullinjtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, Botim i dytë, Asociacioni Ulqini, Ulqin 2016, fq.29.





Pamje nga kursi i ekspertëve nga Dalmacia dhe Italia për krastitjen e ullinjve në Ulqin (1935)

### Mihja

Mihja e ullishtes bëhet gjatë muajve prillë dhe maj në mënyrë që të mos dalë bari i cili ia merr ushqimin ullirit. Për mihjen e ullinjve përdoret **dikella**. Kjo lloj vegle ka formë e kazmës së dyfishtë. Pra, ka dy maje të mprehta në mënyrë që të mos dëmtojë rrënjët e ullirit të cilat janë cektë në tokë. Puna me dikellë është puna më e rënda rreth ullishtarisë. Përveç dikellës përdoret edhe capa, fturku.

### Mbledhja dhe vjelja

Ullishtat që i rreh ajri i detit dhe gjenden në shullá<sup>129</sup> dielli japin më shumë vaj. Në periudhën e dimrit nëse rastis që të bie borë rendimentet janë më të larta. Kokrrat e para të ullirit fillojnë të piqen në fund të shtatorit.<sup>130</sup> Para se të fillohet mbledhja, së pari pastrohen e shkalliten sofat dhe pastaj nëse në ndërkohë nuk ka erë të fortë dhe shi, ullinjtë duhet shkundur. Shkundja e ullinjve dikur është bërë me shtaga të gjata që kanë arritur gjatësinë deri në 6m. Këto shtajaga të gjata janë quajtur **brena**<sup>131</sup> dhe zakonisht kanë qenë ose nga druri i gështenjes ose nga frashëri.<sup>132</sup> Përveç anëtarve të familjes, mbledhtaret zakonisht kanë qenë nuse, vajza të reja para martesë por janë angazhuar edhe mbledhtare nga fshatrat rreth Ulqinit, e më të mirat kanë qenë ato nga Kraja. Një mbledhtare e mirë për një ditë ka mundur të mbledh deri 100kg ullinj.

Për këtë punë në të kaluarën janë paguar me nga një kg vaj kurse për mbledhtaret e mira paga shkonte edhe një kg e gjysmë. Zakonisht burrat nuk kanë mbledh ullinj mirëpo ata i kanë bajtë prej bylykut e deri në mulli. Nëse gjatë ditës janë mbledhur shumë ullinj atëherë është marrë


129 Shulla, -ja, f., vend i ngrohtë të cilin e zë dielli gjatë gjithë ditës dhe nuk e rrahin erërat; *shullani, shullëri*.

130 Dr Bahri Brisku, Ullishtaria dhe mullinjtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, Botim i dytë, Asociacioni Ulqini, Ulqin 2016, fq.32.

131 Bren/ë, -a f., dru i gjatë, përdoret për të shkundur ullinj, arra etj.

132 Dr Bahri Brisku, Ullishtaria dhe mullinjtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, Botim i dytë, Asociacioni Ulqini, Ulqin 2016, fq.33.

qiraxhija i cili në **shtanca**<sup>133</sup> ka bartë ullinjtë deri në mulli me kuaj, gomarë apo mushka. Ky shërbim gjithashtu është paguar me vaj.<sup>134</sup>



Mbledhtarja e ullinjve (burimi Dr Bahri Brisku, Ullishtaria dhe mullinjtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, 2016, str.39)

Mbledhtaret për të kaluar kohën sa më lehtë ato edhe kanë kënduar këngë të ndryshme. Ka ndodhë që shpesh të qesin edhe këngë me të cilat i kanë shpotitur pronarët e vet. Një të tillë në vitet e 70-ta të shekullit të kaluar e ka shënuar dr Bahri Brisku kurse e ka kënduar Neçe Lika.<sup>135</sup>

133 Shtanc/ë, -a, f., kafshë për bartje; kryesisht gomari ose mushku

134 Sami Mishërri, Pasha fikun e ullinin, BKSHMZ, Ulqin 2017, fq.48.

135 Dr Bahri Brisku, Lirika popullore në trekëndëshin Ulqin-Shestan-Bregu i Bunës, BKSHMZ, Ulqin 2006, fq.54.



*Hajde-hajt, more Hashim-aga,  
Na bjer tirit ere ceraga,  
Si dygeç rri perditë.  
Ferrat në sofa pa shkallit.  
Me na nap ti nga një okë,  
Nuk të lam kokërr në tokë,  
Hashim aga rri mbi prru,  
Tuj u kref, tuj u pispillu...*

Ullinjt janë mbledh edhe për mot me shi dhe atëherë mbledhtaret kanë punuar të mbuluara me një mushama të lyer me dyll të cilat nuk kanë lëshuar shiun.<sup>136</sup> Në momentin kur mbledhtaret kanë hy në bylyk ato automatikisht kanë qenë nën mbrojtjen e pronarit të bylykut kështu që askush nuk ka guxë t'i ngucë apo siç thohet ulqinakçe **me i gerga**.

Në ditët e sotme mbledhtaret paguhen me të holla e më rrallë me vaj por shpesh praktikohet edhe bylyku të jepet përgjysmë.

Kur mbaronte mbledhja e ullishtes zakonisht pronarët e mëdhenj përgatisnin ahengje të ndryshme në qytet. Këtu ftoheshin bejtexhinjtë, muzikantët dhe këngëtarët e qytetit për të festuar përfundimin e mbledhjes së ullishtës. Me këtë rast bejtexhinjtë bënin hoka, këndoheshin këngë pune si të ullishtes ashtu edhe të gjellërave. Kësisoj gjellbërësit përgatisnin pilaf, peshk, hallvë e ushqime tjera kurse të tjerët u këndonin këtyre ushqimeve. Kur gjellbërësja piqte hallven zakonisht i këndohej kjo këngë:

*O kazan, kazan-o!*

*Lëshoje, lëshoje hallvën-o!*

*Ruje, ruje, mos na e diq,*

*Se sonte na vinë do miq.*

*Lëshoje, lëshoje hallvën-o!*

*Se e lëshoj Isa Aga të shoqën-o!*<sup>137</sup>

### 6.2.5. Praktika e ruatjes së Ullishtës

#### Kallxoret<sup>138</sup> dhe karrxhija<sup>139</sup>

Mbas **stajës**<sup>140</sup> së fundit gjithmonë ka qenë zakon me u lëshu ullishta për **kallxore**. Nëpërmes karrxhis së ullishtës është bërë me dije se ullishta është lëshu dhe atëherë ullishtën ka mundur me e mbledhë çdokush. Pas këtij lajmi i zoti i bylykut nuk e ka ndalu askend me mbledhë llinj. Me lëshimin e ullishtës karrxhija<sup>141</sup> nuk e ka rrujtë më ullishtën për mbledhjen e ullirit.<sup>142</sup> Zakonisht lëshimi i ullishtës është bërë në muajin mars dhe kjo gjithmonë është mvarë se sa ullinj kanë mbetë në degë. Nganjëherë lëshohet më heret e nganjëherë më vonë.

136 Sami Mishëri, Pasha fikun e ullinin, BKSHMZ, Ulqin 2017, fq. 46.

137 Brisku 2006, f. 56

138 Kallxor/e, -ja, (kallzore) f. persona që nuk kanë ullinj, që pas "lëshimit zyrtar të ullishtës për vjelje të lirë" lejohen të hynin lirish në ullishtë dhe të mbledhnin ullinj për vete. Pronarët nuk i ndalonin pas kësaj date.

139 Karrxhi, -u, (karrxi-ja) m., person i ngarkuar me ruajtjen e ullishtës. Ata i njoftonin pronarët për çdo ndryshim në ullishte dhe pronarët i njoftonin ata për ullishtat e tyre.

140 Staj/ë, -a f. një turrë e mbledhjes, vjeljes së ullinjve, i thonë edhe *sira*

141 Rreth kësaj fjale ka dilema. Dr Bahri Brisku në studimin e tij lidhur me ullishtën regjistron nga populli variantin **karrxhi** kurse në variantet më të reja Dr Maksut Haxhibrahimi dhe Sami Mishëri na sjellin variantin **kallxhi**, sipas mendimit të autorit të këtij teksti të drejtë ka Bahri Brisku.

142 Sami Mishëri, Pasha fikun e ullinin, BKSHMZ, Ulqin 2017, fq. 42.

Karrxhija ka qenë personi i cili e ka ruajtë Ullishtën. Ai më së miri i ka ditë kufijt e secilit bylyk dhe pronarët gjithmonë e kanë informuar për çdo ndryshim apo aktivitet në ullishtë.<sup>143</sup> Edhe pse pothuaj kurrë nuk ka ndodhur ndonjë keqkuptim, vjedhje apo dëmtim në ullishtë karrxhija ka qenë ai i cili ka njoftu pronarët e bylykut lidhur me çdo gjë. Për këtë punë, sipas një rregulli të pashkruar, ai në fund të sezonës së ullishtës është shpërblyer nga të gjithë pronarët me një sasi vaji. Karrxhija i fundit i Ulqinit ka qenë Tahir Nikeziqi.<sup>144</sup>

### 6.2.6. Ullishta pa objekte

Edhe pse si toponim në ullishtën e Ulqinit ekziston termi **Kasolla e karrxhive ulqinakët asnjëherë nuk kanë ndërtuar kurrfar kasollje në ullishtë**. Ekziston shpjegimi që sipas bestytisë ulqinakët nuk i ka zënë kurrë, ose shumë rrallë herë, nata në ullishtë. Kanë besuar se aty kanë qëndruar zanat andaj edhe **nuk kanë ndërtuar shtëpi banimi por në ullishtë kanë qëndruar vetëm për punë dhe ate vetëm gjatë ditës**. Veglat e punës ose janë marrë me vete ose shpesh janë msheh brenda trungut të ullirit. Gjithashtu ullishta kurrë nuk ka qenë e rrethuar dhe gjithmonë është ditë se deri ku është e kujt. Nëse ka ndodhë që degët e ullirit të njërit pronarë kanë rënë në tokën e tjetrit të drejten për mbledhjen e kokrrave e ka pasë pronari i ullirit. Nëse degët e dy ullinjëve fqinjë janë përzier dhe ullinjt bien në të njëjten sofë, atëherë një stajë e ka mbledh njëri kurse stajën tjetër tjetri. Askush kurrë nuk i ka mbledh ullinjt e huaj sepse ka qenë marre e madhe, e për hajni në ullishtë as që bëhet fjalë.

### 6.2.7. Mullinjtë jashtë Ullishtës

Mënyra më e vjetër e përfitimit të vajit të ullirit është ajo me thes. Mbushet thesi plot me ullinj, vendoset në magje druri dhe shkilet me këmbë zbathur. Thesi shkilet deri sa të formohet brumi dhe gjatë gjithë kohës laget me ujë të ngrohtë. Nga përzierja e fituar ndahet uji e kuqila nga vaji. Vaji i fituar në këtë mënyrë është vaji më i mirë dhe quhet *Vaj magje* i thesit.<sup>145</sup>

Deri në vitin 1914, në Ulqin kishte afro 100 mullinjt me një ose me dy gurë. Të gjitha pjesët që viheshin në lëvizje ishin prej drurit: boshti, sirenat<sup>146</sup>, lopatat e brendshme dhe të jashtme, kularët dhe çdo send tjetër. Më së shumti mullinjt kishte në Mëhallë të Re kurse deri në shek. XIX kishte tre mullinjt edhe në Kala.<sup>147</sup>

Pas vitit 1920 shumë ulqinak sollën nga Dalmacia dhe Italia presa të ndryshme. Deri në fillim të Luftës II Botërore kishte mbi 15 mullinjt të tillë e që për kohën paraqitnin fazë të lartë modernizimi. Këso mullinjsh kishin: **Nuti i Adem Manit, Hysnia i Myrtezajt, Caf Mavriqi, Meti i Muharremit, Januzi i Muharremit, Alo Kasmi, Duli i Haxhimollës, Mani i Mehmet Fatimes, Daut Katana, Daut Mavriqi, Latifi i Haxhibrahimit, Halil Milla, Janus Milla, Dalip Myrtoja, Janus Myrtoja, Caf Fici, Nuro Kollari, Bim Canka, Cafo Çapunja, Cufo Bozhina, Lit Qyrkoja, Hysejn Brisku, Shevqet Cungu, Bet Byzyku, Ali Kaceni**. Në **Krruç** mullinjt në këtë periudhë kishin: **Januz Milla, Oso Milla, Fadil Milla, Mehmet Milla, Pala i Pjetrushit Andrisë, Tula i fazlos, Januz Myrtoja, Pjetri i Ndrekes** (në Braticë) etj.<sup>148</sup>

143 Po aty, fq.42.

144 Dr Bahri Brisku, Ullishtaria dhe mullinjtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, Botim i dytë, Asociacioni Ulqini, Ulqin 2016, fq.105.

145 Dr Bahri Brisku, Ullishtaria dhe mullinjtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, Botim i dytë, Asociacioni Ulqini, Ulqin 2016, fq. 40.

146 Sirenat – janë mërkë (qepra) të drejtë, të cilët shtërngohen me boshtin kryesor (vertikal) dhe boshtit horizontal me të cilin është shtërnguar vetë guri i mullirit.

147 Dr Bahri Brisku, Ullishtaria dhe mullinjtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, Botim i dytë, Asociacioni Ulqini, Ulqin 2016, fq. 41

148 Po aty, fq. 55



Në mulli zakonisht kanë punuar 5-6 vetë varësisht prej sasisë së ullinjve dhe kapacitetit. Mjeshtri kryesor ose udhëheqësi i punës zakonisht ishte pronari i mullirit. Puna në mulli fillon në mëngjes dhe mbaron me mbarimin e ullinjve. Di të shkojë deri në tri turne.<sup>149</sup>

Mulliri i parë modern, të cilin edhe e kanë quajtu fabrika e vajit, është ndërtuar nga **Anton Pogu**, pasanik i kohës. Ky mulli është vënë në funksion në vitin 1942, kishte tre gurë dhe tri presa të cilat viheshin në punë nga motorët.<sup>150</sup>

### Mjeshtrat për ndërtimin e mullirit

Mjeshtra për ndërtimin e mullinjve, sipas studimit të Bahri Briskut nga viti 1974, ishin: **Demë Brahimi, Omer Sula** (nga Krruçi), **Sylo Brisku, Simë Pëggjoni, Rizo Hoxha** etj. Për ndërtimin e mullirit këta përdornin këto vegla: çekani, dalta, pergjeli (përdorej për të bërë vija të rrumbullakta), qeseri, zdrukthi, latusha, turjela, metra, sharra etj.<sup>151</sup>

*Skica e mullinjve me një ose dy gurë të cilat fillimisht lëvizeshin nga punëtorët e mullirit dhe më vonë për këtë punë u përdorën kuajt (burimi: Dr Bahri Brisku, Ullishtaria dhe mullinjtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, 2016, str. 41 i str. 45)*

### 6.2.8. Prodhimet nga ulliri

Frutat e ullirit janë shumë të shijshme. Më parë përgatiteshin në dy mënyra: të bardha dhe të zeza. Ullinjtë e bardhë (jeshile) fillimisht rrihen me çekiqç druri ose gur dhe më pas mbahen për dhjetë ditë në ujë që ndërrohet çdo ditë. Pas kësaj vendosen në ujë të kripur, ruhen dhe përdoren.

Ullinjtë e zinj janë në fakt ullinj të pjekur që marrin një ngjyrë të kuqe të errët kaltërosh. Ullinjtë e pjekur dhe të rrudhur ruhen vetëm me kripë. I fusin në një thes dhe i shtypin me një gur të madh e të rëndë dhe i mbajnë kështu për ca kohë derisa të rrjedhë 'uji' – lëngjet e ullinjve dhe bashkë me to gjithë hidhësia. Më pas janë gati për përdorim. Kohët e fundit, ullinjtë ruhen me turshi.

### Vaji i ullirit

Vaji i ullirit dallon nga varieteteja e ullirit, mënyra e bluarjes si dhe kryesorja është aciditeti sa më i vogël aqë më kualitativ është vaji. *Vaji i thesit* është vaji më i mirë dhe më kualitativ me aciditetin më të vogël dhe quhet **vaj magje i thesit**. Pastaj dallojmë vajin e mullirit të gurit ku edhe këtu dallojmë vajin më të mirë që del i pari e që e quajmë **vaj magje** dhe është i mirë për ilaç. Pas tij vjen vaji tjetër i përfituar përmes presave. Ky vaj pastaj është i kualitetit më të ulët. Sot në kohë moderne vaji i ullirit përfitohet përmes makinave moderne me centrifuga ku pas mbledhjes së fruteve nga dega dhe sipas standardeve moderne aciditeti mund të ulet edhe nën 2.0% dhe ky vaj quhet *Virgin oil* por ka edhe asi që aciditeti ulet nën 0,8% atëherë kemi të bëjmë me *Extra virgin oil*.

**Gjethi i ullirit** gjithashtu përdoret për çaj. Ky çaj me gjethe ulliri përdoret për rregullimin e tensionit të gjakut, përmirësimin e ritmit të zemrës, pastrimin e mushkrive dhe pshnetkës. Gjithashtu përdoret edhe kundër gripës, kollit dhe përmirësimit të oreksit.<sup>152</sup>

Në të vërtetë prej ullirit nuk hidhet asgjë.

**Druri i ullirit** është lëndë djegëse me cilësi shumë të mirë. Druri i ullirit, përpos aromës së veçantë, shumë karakteristike dhe të këndshme, ka edhe kalori shumë të fuqishme për ngrohje. Sot druri i ullirit përdoret për dekorimin e çardaqeve (dysHEMEVE), tavaneve, mobiljeve dhe për prodhimin e sendeve artistike. Lëndë djegëse është edhe **bërsija**<sup>153</sup> e cila gjithashtu ka shumë kalori, sepse përmban yndyrën e vajit.

149 Po aty, fq. 66

150 Po aty, fq. 43

151 Po aty, fq. 58.

152 Po aty, fq. 87.

153 Bërsi, -ja f., mbeturinat e kokrrave të shtypura të ullinjve (bërthama, lëkura) pas bluarjes në mulli.

**Kuqlla**<sup>154</sup> gjithashtu është përdorur për larjen e: tinave, butave, qypave, gaviçave, arkave të gurit dhe të gjitha enëve ku isht mbajtë dhe rujtë vaji i ullirit.

**Saponi** - Vaji i ullirit nuk është hedhë kurrë. Edhe në qoftë se ka qenë shumë i fortë, prej atij vaji është bërë saponi për me u la (pastru). Ulqinakët deri vonë për lamje nuk kanë përdor sapon tjetër përveç atij të fituar prej vajit të fortë të ullirit ose prej baltës se vajit. Dallojmë dy lloje saponi të shtëpisë: **Saponi budallë** dhe **saponi krekc**.

Saponi është zier në çdo shtëpi. Edhe ata që nuk ka pasë ullishtë vajin e fortë ose baltën e vajit për sapon e kanë blerë ke mullisi. Vaji ose balta e vajit për sapon e ka qenë i lirë sepse ka qenë vaj i fortë, me shumë acid dhe nuk është përdor për ushqim. Gjyshet e prindërit tanë janë larë vetëm me sapon shtëpije.

Saponi prej vajit të ullirit bëhet fare thjeshtë. Në kazan, ku zihet saponi, duhet me qitë:

- pesë (5) kilogram vaj të ullirit ose baltë, një (1) kilogram sodë kaustike dhe shtatë (7) litra ujë. Sami Misherri, avokat nga Ulqini tregon: "Në shpinë tonë zakonisht është zi sasia prej 15 kilogram vaj ullinit ose baltë, 3 kilogram sodë kaustike dhe 21 litër ujë. Kja ka qenë sasija e nevojshme s'pakut për dy vjet, në kushtet kur caponin e shpisë e kajnë përdorur të gjithë antart e shpisë"<sup>155</sup>

### Shportat

Shportat janë dy llojesh: të *dendura* - punoheshin prej *zhukes* dhe të *rralla* që punoheshin prej *xungës*. Më vonë shportat janë punuar nga liri apo kërpi. Nga ajo kohë mjeshtra për punimin e shportave kanë qenë: Muho Katana, Bet Kallari, Caf Milla, Osman Kroma, Fadil Milla, Salë Hoxha, Hasan Guçi.<sup>156</sup>



*Dybek guri (lok. Dybek) (burimi: Dr Bahri Brisku, Ullishtaria dhe mullinjtë e ullirit në Ulqin me rrethinë, Botim i dytë, 2016, str. 67)*

### Ruajtja e vajit të ullirit

Vaji më së miri ruhet në **dybek guri**<sup>157</sup>, **qypa dheu** dhe **saranxha vaji**.<sup>158</sup>

Dybeku i gurit ka zënë deri në 500 kilogram, qypat e dheut deri 300 kurse saranxha deri në 1000 kilogram vaj ulliri. Dybekët dhe saranxhat zakonisht ishin prej guri (në kohë më te re edhe nga çimentoja) dhe gjendeshin në oborr pranë mullirit. Në këtë mënyrë vaji ruhej për një kohë të gjatë dhe mullisi i mundësonte pronarit të vajit të vinte kur të kishte dëshirë për ta marrë vajin. Kësisoj mullisi kishte hapsirë për të bërë tregti me vaj.

154 Kuq/ël, -la, (kuqlla) ž. lëngu i kuq që rrjedh gjatë mbuarjes të ullinjve, ai bashkë me ujin ndahet nga vaji duke u hedhur si l parërdorshëm

155 Dija, Revista e shkencës, artit dhe kulturës, 2016, f. 177-18

156 Gazmend Çitaku, Busulla e artë, Diti&Oli, Ulqin 2022, fq. 129.

157 Dybe/k. -u m. (turc.) enë e kohëve të moçme në formë të govatës, i skalitur në gurë, për përdorim shtëpiak, kryesisht për ujë te pusët por edhe për ullinj, vaj etj.

158 Saranxh/ë, -a f. Depo e gërmuar në tokë, ose e ndërtuar me mure, për të mbledhur dhe për të ruajtur ujin e shiut, në vendet ku nuk ka burime uji.



**Qypat** e vajit të ullirit janë zakonisht qypa dheu dhe kishin madhësi të ndryshme. Vaji që përdorej për shtëpi vendosej nëpër qypa më të vegjël kurse ai që përgatitej për tu shitur, pronarët i vendosnin nëpër qypa më të mëdhenj. Në këta qypa vaji mund të qëndronte një kohë të gjatë dhe me kalimin e kohës edhe fitonte në cilësi dhe nuk prishej.

### 6.2.9. Disa legjenda që lidhen me Ullishtën

#### **Legjenda e Xhemiles<sup>159</sup>**

Ka qenë një vajzë shumë e bukur. Ajo duke u rrit e duke u zbukuru ma shumë. Ajo dashurohet me një djal jo te pasur por babai i saj vendos tja japë një detari. Ata martohen e detari gjithmonë në lundrime. Ai nuk qëllon as kur i vdesin prindërit. Heren e fundit që shkon në detë Xhemiles i thotë që për çdo gjë që ka nevojë të blejë mund t'i thotë hoxhës që ai t'i blej për te. Një ditë hoxha e sheh Xhemilen dhe fillon me i ba lajka. Ditë pas dite edhe asaj i pelqejn lajkat dhe e lejon hoxhen të hyj brenda. Pas asaj dite hoxha e viziton shpesh Xhemilen e në shtëpinë e vet arsyetohej se shkonte për mejlyte e për raste vdekjeje në fshatrat përreth. Një ditë Xhemiles fillon me i dal barku dhe disi duhej me e mshef marren. Hoxha kurdis vrasjen e Xhemiles duke paguar dy fshatar që ta vrasin. Në krim merr pjesë edhe teza e vajzës e cila e therrret dhe i thotë se i ka mbririt i shoqi në Valdanos dhe ka kerku qe ajo me shku atje. Ajo del e niset ullishtes prej kalaje e per në Vardanas. Sa kalojn Kronin e Mustafajt përpara Lugut "Balës" dhe Mendres janë

ul teposhtë te deti. Ja kan var një gur në qafë dhe e kan hedh në det. Nga ajo kohe aty ka mbet emri Lugu i Xhemiles. Përcjellsja e vajzës më vonë kishte thënë se Xhemiles ia kishte ni zemra ë diçka nuk shkonte andaj ka mbet e shënuar kënga:

*Pse me ka xan burri maras  
Qi me kerkan ne Vardanas,  
Mori teze?!*

*Kur më nisen kejt Mendra  
Se ç'më fillaj mu dridh zemra  
Mori teze?!*

*Kur më nisen kejt ullishta  
Se ç'fillaj me mu dridh kmisha  
Mori teze?!*

*Kur më ulën nëpër prru...  
Qyqja ç'doni me m'ba mu  
Mori teze?!*

*Kur fillun me mi myll sytë  
E dita se donin me m'mytë  
Mori teze...*

#### **Legjenda e Kronit të Zanave<sup>160</sup>**

*Dikur motit ka qenë një arvudë<sup>161</sup> e njohur. I kanë thanë Hake Lajkja. Ajo ka shku dhe ka pritë femi gjithkund. Një natë të vonshme i kanë takllu në derë da gra. Ka dal plaka. Ata i kanë kallxu që kanë nevojë për te. Hakja pa vanu niset menjëherë me ta. Kur e ka pa se po e çojnë nëpër ullishtë i ka thanë atyre që janë dukë si gra:*

159 Brisku 1994, f. 49

160 Brisku 1994, f. 59

161 Arvud/ë, -a f. Mami, grua që ndihmon në lindje.

*Qyqja unë moj, ku po më çoni?*

*Këto jan kan kthy:*

*Hec e mas ban za shumë.*

*Haken e kanë zanë të rrëqethmet. Hajt e hajt, kanë mbririt ke Kroni i Zanave në fund të ullishtes. Kur atje e shtijn në një shpell. Shpella vlonte nga hengu dhe kenget. E çuen Haken ke lehona dhe fillon kjo punen e saj. Ajo ka kallxu se acaherë e ka ni kangen:*

*Ne na baft lehona djale  
Lum arvude çka ke me marr-e  
Ne na baft lehona vajz-e  
Zeza arvude çka ka me hjek-e  
Hajde, hajde djale  
Na shena neve tanve...*

Leu djali ere shenuen tanë xhindit, por femija virte shumë. Bje mi pajtue e mi ngarrit por prep si hynte gjuha n goj.

Hajt shkoni e ndrojeni - thotë njina prej xhindve. Lene kyt e merrni djalin e filanit në kala. Nuk kaloj shumë dhe e bijn djalin e huej. Hakja qillan aty dhe "fik" e therr femin me një gjylpan. Ere ky fillan me virr ma shumë se tjetri. Shkoni e bini prep at tonin se ky virrka ma shumë i joni.

Çohet Hakja me ik dhe ato e percjellin deri te hyrja e shpelles të gjitha. Ato ia hedhin një varg në qafë. Hakja rruges i hedh ka një kokerr. Ka mendu se janë hudra se i ka ardhe erë e keqe. Deri sa mbrin në shtëpi ajo i hedh të gjitha. Kur shkan me ra me fjet, krring i bijnë në çardak dy floring. Çohet natje hejret ere shkan rruges së ullishtës kejt ka ardh, por nuk gjen asnjë flori tjetër. Ere thotë me vete: "I pasken mledh te xhindet" qe sigurisht i kanë shkuar mbrapa.

#### **Kazani plotë floring<sup>162</sup>**

Te Kroni i Zanave ekzistonte një rrasë e madhe, mbi të cilën mbledhëtarët vinin e shtronin drekën, por kur erdhën në mëngjes, vërejten se rrasa ishte shkukur nga vendi dhe aty kishin mbetur vetëm dy rrëfana të kazanit dhe një qese e vogël lëkure, plot me lira. Se kush i mori këto thesare, legjenda na jep dy shpjegime. Kazanin me flori erdhën dhe e morën detarët nga një vend ku ishin shpërngulur nga Ulqini.

Pasardhësit e tyre të pasur ia kishin lënë atyre një hartë se ku gjendej thesari i fshehur i familjes së tyre. Syzheu i dytë për marrjen e floririt te Kroni i Zanave është thurur në mënyrë të flijimit të kurbaneve. Një detar kthehet natën nga lundrimi në Valdanos dhe kur shkoi të pijë ujë te Kroni i Zanave, dëgjoji një zë: "O njeri i zotit, nën atë rrasë ku pive ujë është një kazan me flori, por për ta marrë këtë pasuri të madhe, ti duhet t'i flijosh tre mëzetër (kurban) të cilët duhet sjellur nga përtejdeti. Ky e vari mirë në vesh këtë dëshmi dhe shkoi menjëherë me barkë në Misir (Egjypt). Atje bleu tre mëzetër dhe erdhi aty dhe i preu. Atëherë iu çue ajo rrasë dhe ai mori kazanin me flori, kurse rrëfanat e atij kazanit i ranë aty së bashku me disa qeska floriri.


162 Brisku1990



## 7. Karakterizimi i peizazhit

**Modeli për vlerësimin e karakterit dhe cilësisë së peizazhit** u zbatua në zonën e Ullishtës dhe gjirit të Valdanosit si kornizë integrale që unifikon të gjitha njohuritë e mbledhura dhe analizuar më parë nga ky studim për elementët natyrorë dhe antropogjenë të peizazhit.

Zonat e peizazhit u ndanë në bazë të **kritereve** të mëposhtme: (1) format e mikrorelievit (gjiret, plazhet, shkëmbinjte, anët bregdetare, pjesët e luginave, faqet e kodrave etj.), (2) veçoritë gjeologjike (gëlqerore, flishore), (3) mënyra e përdorimit dhe mbulimit (ullishta aktive dhe të lënë pas dore, mbulesa natyrore, lëndina, ndërtimi). Çdo zonë e ndarë është emëruar përmes koncepteve të zonës së peizazhit dhe llojit të peizazhit. **Zonë peizazhi** është zonë e përcaktuar gjeografikisht, kështu që emri i saj caktohet në bazë të toponimeve, ndërsa **lloji i peizazhit** është i përgjithshëm në natyrë dhe mund të shfaqet në disa vende, dhe emri i tij, ndryshe nga një zonë peizazhi, mbart informacion për karakterin e tij. U identifikuan gjithsej **26 zona peizazhi**.



Zonat dhe llojet e identifikuara të peizazhit:

- Pjesa e poshtme e luginës së Valdanosit (fusha të kufizuara me tarraca nën kullota dhe bimësi më të lartë)
- Pjesa e sipërme e luginës së Valdanosit (ullishte të braktisura me tarraca me disa plantacione të ripërtrira)
- Ullishta brenda pushimores ushtarake (ullishte me tarrace brenda pushimores ushtarake)
- Pjesa e sipërme e shpatit jugor të Luginës së Valdanosit (ullinj të braktisur me tarracë me disa plantacione të rivendosura)
- Pjesa qendrore e ullishtes (ullishta aktive me tarraca me ndertim te pjesshem)
- Shpati verior i Mendrës (shpatet nën shkurre)
- Shpati jugor i Mavrianit (shpatet e kreshtës nën bimësi të pakët natyrore)
- Shpatet jugore të Malit të Bardhë (shpatet kurrizore nën shkurre)
- Kreshta Mendra (kreshta nën shkurre)
- Lugu Xhemiles (lugu nën shkurre)
- Kodra Çivlaku (kodër nën shkurre)
- Lugu Opalike (lugu nën shkurre)
- Kodra Bashbylyk (një kodër nën ullishte aktive me tarraca)
- Lugu Bashbylyk (lugu nën shkurre dhe pjesërisht me ullishte)
- Kodra Glavica (kodër nën gëmusha dhe ullishte aktive)
- Lugu Liman (lugu nën ndërtime dhe pjesërisht me ullishtë)
- Ana bregdetare e Limanit (ana e ndërtuar e bregdetit)
- Ullishta në Mëhallë të Re (ullishtë aktive me tarraca pranë zonës së ndërtuar)
- Plazhi i Valdanosit (plazh natyror me guralecë, pjesërisht i modifikuar antropogjenikisht)
- Bregdeti nën pushimoren ushtarake (bregdeti shkëmbor i modifikuar pjesërisht antropogjenikisht)
- Bregdeti te FKK plazhi (bregdeti natyror shkëmbor me zhavorr)
- Shkëmbi i gjirit të Valdanosit - Shkëmbi (shkëmb bregdetar)
- Përmbi FKK plazhin (ana bregdetare nën shkurre)
- Pjesa e bregdetit me portin/mandraqin (bregdeti shkëmbor i modifikuar antropogjenikisht)
- Bregdeti i shpatit verior të Mendrës (bregdet natyror i pyllëzuar deri në shkëmbor)
- Bregdeti jugor i Mendrës (bregdet shkëmbor natyror)

**Karakter** i çdo zone peizazhi përshkruhet duke interpretuar sesi kombinimi i veçorive natyrore, kulturore dhe vizualisht të eksperiencës krijon një hapësirë me identitet dhe veçori unike. Për më tepër, për secilën zonë janë vlerësuar: **cilësia natyrore, cilësia kulturore, cilësia vizuale, cilësia e përgjithshme (harta e cilësisë së përbërë) dhe presionet**. Gjithashtu, **fotot dhe hartat** janë bashkangjitur për secilën zonë.

**Cilësitë natyrore:** natyraliteti (i paprishur, e paprekur), karakteristikat e veçanta të vegjetacionit, uji, relievi etj.

**Cilësitë kulturore:** rëndësia historike, ruajtja dhe dallueshmëria e modelit të përdorimit të tokës, simbolika kulturore, praktikat lokale, etj.

**Cilësitë vizuale:** plotësia dhe kuptueshmëria vizuale, kompleksiteti, identiteti hapësinor, koherenca, përfaqësimi, veçoritë vizuale (të spikatura dhe të degraduara), intensiteti i ekspozimit pamor, etj.

**Cilësia e përgjithshme:** vlera mesatare e të tre cilësive.


**Presionet:** presionet ekzistuese dhe të planifikuara mbi karakterin e peizazhit.

Së fundi, janë bashkangjitur gjashtë **hartat**: (1) harta e zonave të peizazhit, (2) harta e cilësive natyrore, (3) harta e cilësive kulturore, (4) harta e cilësive vizuale, (5) harta kompozite e vlerave, (6) harta e presioneve.



## 7.1. Katalogu i zonave të peizazhit

Numër	1
Tipi	Fushat e kufizuara me tarracë nën lëndina dhe bimësi të lartë
Zona	<b>Pjesa e poshtme e luginës së Valdanosit</b>
Përshkrimi	<p>Është pjesa më e ulët dhe më e gjerë e luginës së Valdanosit. Në seksion është pak në formë hinke, me pjerrësi të lehtë drejt detit rreth 3%. Një shtresë më e thellë e tokës së lirshme është grumbulluar në fund të luginës dhe një rrjedhë e përkohshme kalon nëpër qendër. Edhe pse nuk ka të dhëna të mjaftueshme, mund të supozohet se kjo zonë, për shkak të konfigurimit të favorshëm të terrenit, pranisë së një shtrese më të thellë dheu, një rrjedhje të përkohshme dhe pabarazisë së dukshme, historikisht ka qenë një tokë bujqësore me vlerë - më shumë në forma e kulturave të përziera të arave (kopshtet e perimeve, kulturat arë etj.). Sot nëpër zonë kalon një përrua i përkohshëm i kanalizuar dhe supozohet se ka pasur edhe kanale anësore që kullonin ujin e tepërt nga shpatet përreth. Prania e sasive më të mëdha të ujit tregohet nga prania e bimësisë natyrore hidrofile.</p> <p>Gjatë funksionimit të kompleksit ushtarak (pushimores), zona fiton përdorime dhe organizim të ri; janë ndërtuar objekte (restorant, recepsion, terrene sportive, ...) dhe një pjesë e mirë e parcelave kufizohet me selvi (qëllimi i parcelave të kufizuara me selvi është i panjohur për autorët).</p> <p>Për shkak të veçorive të saj natyrore, zona është në kontrast të madh me zonat e pjerrëta përreth. Sot zona dominohet nga zona të gjelbra të lënë pas dore, ndërsa në një zonë pak më të gjerë të brendësisë së plazhit ka një parking prej dheu. Kjo pjesë ka karakterin e një nyje komunikimi që lidh plazhin dhe përmbajtjen e shpateve përballë (Mendrës dhe Mavrianit). Kjo hapësirë është në të njëjtën kohë momenti gravitacional i perceptimit pamor, në ndryshim nga ai i padukshëm dhe i pakalueshëm i mësipërm. Hapësira vizualisht dominohet nga selvitë e larta, të cilat në të njëjtën kohë përbëjnë bazën e artikullimit të hapësirës.</p>
Cilësitë kulturore	4 kompleksi ushtarak, kanale, pjesë e rrugës historike, lokacioni i lazaretit të rrënuar nga periudha turke dhe një godinë doganore/porti e shekullit XIX
Cilësitë natyrore	3 tokë, rrjedhë
Cilësitë vizuale	3 rregullimi i paartikulluar i zonës së hyrjes, ndërtesat e braktisura dhe zonat e gjelbra
Presionet	3 Çrregullim, braktisje, në Planin Hapësinor-Urbanistik të Komunës së Ulqinit, zona e destinuar për ndërtim – si zonë sportive dhe rekreative (sipërfaqja e objekteve të mbyllura sportive 6000 m <sup>2</sup> )





Numër	2	
Tipi	Ullishta të braktisura me tarraca me plantacione pjesërisht të restauruara	
Zona	<b>Pjesa e sipërme e luginës së Valdanosit</b>	
Përshkrimi	Në këtë pjesë të majës, lugina e Valdanosit ngushtohet, dhe pjerrësia e terrenit rritet (zbret drejt detit përafërsisht 15%, dhe rënie anësore rreth 30%). Ashtu si rrëza e luginës, kjo zonë është e pasur me ujë dhe tokë të akumuluar natyrshtëm. Në këtë pjesë grumbullohen përrenj anësorë dhe krijojnë një rrjedhë të përkohshme që rrjedh drejt detit. Mbetjet e tarracave tregojnë një funksion bujqësor gjatë historisë. Për sa i përket mbulesës, zona përcaktohet nga një raport i barabartë i ullinjve të braktisur dhe vegjetacionit natyror. Nëpër zonë kalon rruga kryesore historike, e karakterizuar nga mbetjet e kalldrëmeve, të cilat ruhen shumë mirë në pjesën e sipërme. Pavarësisht komunikimit, zona është kryesisht e mbipopulluar me bimësi dhe për këtë arsye e paarritshme. Ka pamje të pjesshme nga rruga kryesore mbi zonën.	
Cilësitë kulturore	4	tarraca, ullinj, rrugë me mbetje kalldrëmësh, tarraca përgjatë një përroi të rrëmbyeshëm
Cilësitë natyrore	4	toka, bimësia natyrore, përrenjtë
Cilësitë vizuale	2	pakuptueshmëri, monotoni
Presionet	3	bujqësia e lënë pas dore, rrugë të reja të shtruara në mënyrë të pamjaftueshme



Pamje nga pjesa e sipërme e luginës dhe rruga e re e asfaltuar

Ullishtë të lënë pas dore rreth rrugës historike



Pjesa e sipërme e rrugës historike me segmente të ruajtura me kalldrëm

Pamje nga pjesa e sipërme drejt gjirit të Valdanosit



Pjesa e sipërme e luginës së Valdanosit bazuar në satelitin Google 1:10.000



Numër	3	
Tipi	Ullishtë me tarraca brenda Pushimores Ushtarake	
Zona	<b>Ullishta në kuadër të Pushimores Ushtarake</b>	
Përshkrimi	<p>Bëhet në shpatet jugore të luginës së flishit të Valdanosit, me një pjerrësi mesatare prej 20%. Duke pasur parasysh substratin e flishit dhe orientimin e përshatshëm, ullinjtë janë rritur këtu gjatë gjithë historisë. Megjithatë, për këtë zonë është karakteristikë fakti se një pjesë e kompleksit turistik ushtarak është ndërtuar si pjesë e ullishtës në vitet 1970. Ai përbëhet nga një restorant, shtëpi montuese për akomodim, një autokamp, një zonë për kamp rimorkiot,... Edhe pse krijimi i pushimores ushtarake në kontekstin e Ullishtës mund të flitet si një rrethanë negative (riposedimi i pronësisë dhe pengimi i aksesit të ullishtat), është e nevojshme të përmenden edhe aspektet pozitive, rrethanat, që janë se projekti i pushimores ka marrë parasysh karakteristikat e hasura hapësinore; Zonimi kushtëzohej nga karakteristikat e terrenit, arkitektura ishte e integruar në mjedis dhe terren, rregullimi i jashtëm u frymëzua nga struktura e ullishteve duke ruajtur (për aq sa ishte e mundur) ullinjtë historikë. Ullinjtë që ruheshin u ruajtën në një koncept të ri, por jo për kultivim por si kulturë parku. Shumë nën-mure janë bërë me material lidhës, por sërish duke ndjekur konfigurimin e terrenit. Kjo mënyrë e integritit të një qëllimi të ri në ullishte është një mënyrë që mund të jetë një mësim për ndërtimin e sotëm dhe mund të supozohet se prania e Pushimores Ushtarake e shpëtoi menjëherë ullishtën nga urbanizimi modern deri diku.</p> <p>Përshtypja vizuale e hapësirës së përgjithshme nuk është unike; po ndryshojnë ambientet e neglizhencës, nëpërmjet ambienteve të rregullimit të ullishteve të sapo rinovuara, por edhe të pazakontës në kuptimin e ndërthurjes së qëllimeve të ullishtave dhe pushimores ushtarake.</p>	
Cilësitë kulturore	5	ullinj të vjetër, por edhe një dëshmi e proceseve të fundit shoqërore me një marrëdhënie relativisht të mirë midis shtresës historike të ullinjve dhe pushimores ushtarake.
Cilësitë natyrore	2	toka, vegjetacioni natyror
Cilësitë vizuale	3	ullishta të braktisura, ndërtesa të rrënuara
Presionet	3	përkeqësim të objekteve ushtarake, ullinj të dëmtuar



Pjesë e pushimores me zonën për rimorkiot e kampimit



Pjesë e pushimores me shtëpiza montuese për akomodim



Pjesë e pushimores ushtarake me zonë për rimorkiot e kampimit



Shtëpi të braktisura montuese për strehim brenda ullishtes



Zona **Ullishta në kuadër të Pushimores Ushtarake** në Google satelit bazë, 1:10.000



Numër	4	
Tipi	Ullishta të braktisura me tarraca me plantacione pjesërisht të restauruara	
Zona	<b>Pjesa e sipërme e shpatit jugor të luginës së Valdanosit</b>	
Përshkrimi	<p>Pjesët më të larta, me pamje nga jugu, ende flishore të luginës së Valdanosit me një pjerrësi mesatare rreth 30%. Në kryqëzimin e ultësirës së Mavrianit dhe Malit të Bardhë është formuar një fushë përmbytjeje dhe në këtë zonë gjenden dy kroje, Kroni i Vakfit dhe Kroni Sal Kikës. Nga kjo pjesë e Ullishtës kalon shtegu i rrugës së vjetër për në Kepin e Bishtit (Rruga për Bisht). I përshtatshëm për bujqësi, gjatë historisë shpati ka qenë tërësisht i tarracuar - deri në kufirin e sipërm të flishit, pra në fillim të gurit gëlqeror. Duke qenë se edhe kjo zonë ishte nën kontrollin e ushtrisë dhe nuk u fut në funksione të reja, sot bëhet fjalë kryesisht për ullishta të braktisura dhe një pjesë të madhe të bimësisë natyrore shkurre bregdetare. Me rikthimin e fundit të pronësisë tek pronarët fillestarë, nis restaurimi i ullishteve, për shkak të të cilit rrugët e vjetra ekzistuese zgjerohen ose hapen rrugë të reja me zhavorr. Gjatë zgjerimit të rrugëve të vjetra u shkatërruan shumë segmente të kalldrëmeve autentike që ruheshin në rrugë, si dhe nënmuret e tarracave.</p> <p>Për shkak të neglizhencës, hapësira është kryesisht e paekzaminuar dhe e paarritshme. Vizualisht bien në sy disa plantacione të restauruara.</p>	
Cilësitë kulturore	3	ullinj, tarraca, dy kroje, shtegu i rrugës së vjetër për në Kepin e Bishtit (Rruga për Bisht)
Cilësitë natyrore	4	krojet, toka, një pjesë e madhe e bimësisë natyrore
Cilësitë vizuale	4	imazh monoton, por vizualisht i rëndësishëm ullishte pjesërisht të riaktivizuara, mbyllje vizuale e luginës
Presionet	2	rrugë me zhavorr, neglizhencë



